16941

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 16941 Akt

Tirane, me Shkurt 1997

VENDIM
PER REGJISTRIM PERSONI JURIDIK

Sot, me date 12 Shkurt 1997, une [illegible] gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe dokumentet e tjera te paraqitura nga Ortaku dhe administratori i shoqerise "MEDIA 6" sh.p.k., z. Aleksander Frangaj, per regjistrimin e saj si person juridik ne Regjistrin Tregtar,

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "MEDIA 6" Sh.p.k. eshte themeluar me date 11 Shkurt 1997 nga ortaket: 1.Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, i datelindjes 1968, banues ne Lezhe. 2.Julien Roche, shtetas francez, i datelindjes 1954, banues ne Paris, Avenue Mozart dhe 3. Marsel Skendo shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, i datelindjes 1949, banues ne Tirane.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke dhe eshte i ndare ne 100 pjese te barabarta me vlere nominale 1000 leke secila, te shlyera nga ortaket perkatesisht, Aleksander Frangaj 50% te pjeseve, Marsel Skendo 25% te pjeseve dhe Julien Roche 25 % te pjeseve te kapitalit.

Administrator i Shoqerise eshte ortaku Aleksander Frangaj;

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rruga "Myslym Shyri", N.8/1

Kohezgjatja e shoqerise do te jete 10 (dhjete)vjet;

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte botimi i revistave, gazetave, librave, tregtimi i tyre, ne menyre te vecante duke filluar me botimin e revistes se emertuar "KLAN", importi-eksporti i mallrave e materialeve qe i sherbejne aktivitetit prodhues, shperndares dhe tregtues te botimeve te mesiperme, aktivitet ne fushen e mediave elektronike ne baze te dispozitave ligjore qe do te rregullojne keto lloj veprimtarish.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligjin "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne ligjin "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" dhe, si e tille, duhet pranuar

PER KETE ARSYE

ne mbeshtetje te ligjit 7638, date 19 Nentor 1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe te Ligjit Nr.7667, 28 Janar 1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

Regjistrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MEDIA 6" sh.p.k. themeluar nga ortaket 1.Aleksander Frangaj, 2. Z.Julien Roche dhe 3. z.Marsel Skendo, si person juridik ne Regjistrin Tregtar,me kapital themeltar 100.000 (njeqindmije) leke te ndare ne 100 pjese me vlere nominale 1000 leke secila, te shlyer nga ortaket perkatesisht, Aleksander Frangaj 50% te pjeseve, Marsel Skendo 25% te pjeseve dhe Julien Roche 25 % te pjeseve te kapitalit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete botimi i revistave, gazetave, librave, tregtimi i tyre, ne menyre te vecante duke filluar me botimin e revistes se emertuar "KLAN", importi-eksporti i mallrave e materialeve qe i sherbejne aktivitetit prodhues, shperndares dhe tregtues te botimeve te mesiperme, veprimtari ne fushen e mediave elektronike ne baze te dispozitave ligjore qe do te rregullojne keto lloj veprimtarish.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 10 (dhjete)vjet

Administrator i Vetem i Shoqerise eshte ortaku Aleksander Frangaj;

Selia e shoqerise eshte ne Tirane Rruga "Myslym Shyri", N.8/1.

Ky vendim eshte i ankimueshem ne Gjykaten e Apelit.

Gjyqtare



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 1691/1 **rregj.**
1568

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 31.03. 2000, ne Gjykaten e Rrethit Tirane, une Gjyqtarja Lauila Coja mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Shoqeria " Media 6" Sh.p.k, e perfaqesuar nga Z. Aleksander Frangaj, Administrator, per depozitimin e verbalit te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve te dates 21.03.2000, ne te cilen eshte vendosur shtesa e objektit te aktivitetit te Shoqerise me aktivitetin "Prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografise" dhe pasqyrimi i kesaj shtese ne nenin perkates te statutit dhe:

KONSTATOVA:

Se me date 21.03. 2000 u mbajt Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "MEDIA 6" Sh.p.k me kete rend dite:

1. Shtese ne objektin e aktivitetit te Shoqerise dhe reflektimi i saj ne nenin perkates te Statutit;
2. Te ndryshme.

Ortaku dhe Admisitratori i shoqerise Z. Aleksander Frangaj pasi konstatoi se ne kete mbledhje perfaqesohej i tere kapitali social i shoqerise dhe e konsideroi mbledhjen te thirur ne menyre te vlefshme e te rregullt parashtroi:

1. Propozimin per te shtuar ne objektin e aktivitetit te Shoqerise: "Prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografise"
2. Propozimin per reflektimin e kesaj shtese ne nenin perkates te Statutit te Shoqerise.

Me votim te gjithe kapitalit social u vendos te aprovohet:

1. *Shtesa e objektit te aktivitetit te Shoqerise:"Prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografise";*
2. *Reflektimi i shteses se aprovuar ne nenin 6 te Statutit te Shoqerise duke shtuar, ne fund te paragrafit te pare te tij, fjaline: "si dhe prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografise".*

PER KETO ARSYE

Si gjyqtare e vetme ne baze te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare " dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per Rregjistrin Tregtar "

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses se mesiperme.

- Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise te dates 21.03.2000 ne te cilin eshte aprovuar:

1. Shtesa e objektit te aktivitetit te Shoqerise me aktivitetin:"Prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografise";
2. Reflektimi i shteses se aprovuar ne nenin 6 te Statutit te Shoqerise duke shtuar, ne fund te paragrafit te pare te tij, fjaline: "si dhe prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografise".

- Urdherimin e Zyres se Rregjistrit Tregtar te reflektoje ne Rregjister ndryshimin e mesiperm..

- Ndarjen me vize te kuqe per ndryshimet e bera.

U shpall sot me daten 31. 03. 2000

GJYQTARE

Dinila Cafo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr ...16.941.2

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot më datë 5.4. 2000 unë, Altina Xhoxhaj, gjyqtare e vetme e Gjykatës së Rrethit Tiranë morra në shqyrtim kërkesën e kërkuesit Aleksandër Frangaj administrator i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Media 6" sh.p.k. për ndryshimin e formës së kësaj shoqërie dhe caktimin e ekspertit kontabël të autorizuar. Pasi shqyrtova kërkesën e tij

K O N S T A T O V A

Shoqëria "Media 6" Sh.p.k. është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me nr. 16941 datë 12 Shkurt 1997. Administrator i kësaj shoqërie është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 10 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave radiotelevizive etj. Ortakë të shoqërisë së mësipërme janë:

- Julien Roche zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Marsel Skende zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Aleksandër Frangaj zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Në datën 28.03.2000 është mbajtur Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë. Në këtë mbledhje ishin prezentë të tre ortakët e kësaj shoqërie. Asamblenë e Ortakëve e drejtoi Aleksandër Frangaj. Ai pasi konstatoi pjesëmarrjen e të gjithë ortakëve të shoqërisë e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat kishin marrë më parë njoftim ortakët si më poshtë: .

1. Ndryshimi i formës së shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime;
2. Paraqitja e kërkesës pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për caktimin e një eksperti kontabël të mitaruar për të pwrgatitur aktet përkatëse.

Pas një diskutimi të hollësishëm në lidhje me pikat e rendit të ditës. Asambleja e jashtëzakonshme e ortakëve ka vendosur me unanimitet:

1. **Ndryshimin e formës së shoqërisë "Media 6" nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.**

2. **Ti drejtohen gjykatës me kërkesë për caktimin e Z. Ilirijan Hozha në cilësinë e ekspertit kontabël i cili do të përgatisë raportin përkatës për gjendjen e shoqërisë pasurinë e saj, dhe kontributin e ortakëve në këtë shoqëri, për rritjen e kapitalit, duke respektuar kërkesat e nenit 168, 169 të ligjit "Për shoqëritë tregetare".**

Kërkuesi kërkon me anë të kërkesës paraqitur pranë kësaj gjykate depozitimin e vendimit të Asamblesës së Ortakëve dhe të kërkesës pranë Zyrës së Rregjistrit Tregëtar.

Pasi shqyrtova kërkesën e tij cmova se ajo është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Dhe në bazë të ligjit 7638 datë 19.11. 1992 "Për shoqëritë tregetare", ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per rregjistrin tregetare", si dhe ligjit nr. 8410 datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë"

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës;
- Depozitimin në rregjistrin tregtar të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të Shoqërisë "Media 6" SHPK datë 28.03.2000;
- Emërimin e Z Ilirjan Hoxha si ekspert për pergatitjen e akteve te duhura;
- Urdhërimin e zyrës së rregjistrit tregëtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr rendor në kollonën duke bërë vijëzimet me bojë të kuqe.

GJYQTARE

Altina Xhoxhaj

Tiranë më 5.4. *2000*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr 16941/3

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot më datë 10. 5. 2000 unë, Altina Xhoxhaj, gjyqtare e vetme e Gjykatës së Rrethit Tiranë morra në shqyrtim kërkesën e kërkuesit Aleksandër Frangaj administrator i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Media 6" sh.p.k. për ndryshimin e formës së kësaj shoqërie miratimin e raportit te ekspertit kontabel etj. Pasi shqyrtova kërkesën e tij

K O N S T A T O V A

Shoqeria "Media 6" Shpk është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane me nr. 16941 date 12 Shkurt 1997. Administrator i kësaj shoqërie është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 10 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave. Ortakët e shoqërisë së mësipërme janë:

- Julien Roche zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Marsel Skëndaj zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Aleksandër Frangaj zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Ne daten 04.2000 u mbajt mbledhja e Asamblese se Ortakeve te shoqerise nete cilen merrnin pjese te tre ortaket. Mbledhja u drejtuar nga A.Frangaj i cili pasi pasi konstatoi se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat kishin marre me parë njoftim ortakët: Rendi i dites ishte si me poshte

1. Deklarimin e shdërrimit të formës së Shoqërisë;
2. Miratim i raportit të ekspertit për kontributet në shoqëri për shdërrimin e saj nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime;
3. Emetimi i aksioneve të reja, nënshkrimi dhe pagimi i tyre
4. Diskutimi dhe miratimi i statutit të ri të shoqërisë;

1. DEKLARIMI I SHDËRRIMIT TË FORMËS SË SHOQËRISË

Z. Aleksanndër Frangaj deklaroi se sic edhe ishin ne dijeni ortakët me daljen e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë". Shoqëria "Media 6" e cila ka si objekt të saj të veprimtarisë ekskluzivisht atë të mediave duhej të ndryshonte formën e saj në bazë të kërkesave të nenit 20 të këtij ligji. Në bazë të vendimit të asamblesë së datës 28.3.2000 ishte vendosur edhe eksperti per kontributet në shoqëri. Ai u kërkoi ortakëve të deklaronin shdërrimin e shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.

2. MIRATIM I RAPORTIT TË EKSPERTIT PËR KONTRIBUTET NË SHOQËRI PËR SHDËRRIMIN E SAJ NGA SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NË SHOQËRI ANONIME;

Z. Aleksander Frangaj vuri në dijeni ortakët e tjerë se në vijim të mbledhjes së asamblesë së ortakëve datë 28.3.2000 shoqëria ka proceduar me fazën e parë të shdërrimit të saj në shoqëri anonime. Me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, datë 5.4.2000 nr. 16941/2 është miratuar caktimi i ekspertit për kontributet. Në vijim eksperti ka përpiluar dhe depozituar pranë shoqërisë aktin e ekspertimit i cili i është vënë në dispozicion të pranishmëve në asamble që në datën 21.04.2000. Në këtë raport eksperti ka paraqitur tre variante për transformimin në shoqëri anonime dhe rritjen e kapitalit të shoqërisë: variantin minimal, atë optimal dhe atë maksimal. Z. Frangaj vuri në dijeni se eksperti ka përcaktuarin kufirin minimal dhe maksimal dhe se është në të drejtën e ortakëve të caktojnë breda këtyre kufijve se sa do të jetë kapitali i shoqërisë.

Pas një diskutimi të hollësishëm të pranishmit me unanimitet vendosën:

Rritjen e kapitalit të shoqërisë në 12,000,000 dymbëdhjetë milionë lekë duke i shtuar kapitalit aktual prej 100,000 shumën prej 11,900,000 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqindmijë) lekë.

3. EMETIMI I AKSIONEVE TË REJA, NËNSHKRIMI DHE PAGIMI I TYRE.

Z. Frangaj i propozoi Asamblesë që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 11,9000 aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila dhe i ftoi ata të deklaronin numrin e aksioneve që do të nënshkuanin paguanin secili.

Pas në diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimet vendosën që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 11,9000 aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila. Dhe deklaruan se do të nënshkruanin përkatësisht këto aksione:

Z. Julien Roche do të nëshkruajë 3975 aksione me një vlerë prej 3,975,000 lekë;
Z. Marsel Skënde do të nëshkruajë 3975 aksione me një vlerë prej 3,975,000 lekë;
Z. Aleksander Frangaj do te nenshkruaje 3950 aksione me nje vlere prej 3,950,000 lekë.

Pagesa e aksioneve u be menjehere duke ulur proporcionalisht detyrimet e shoqërisë ndaj otakeve dhe më hollësisht:
Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Julien Roche u ulën me 3,975,000 lekë;
Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Marsel Skendaj u ulën me 3,975,000 lekë;
Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Aleksandër Frangaj u ulën me 3,950,000 lekë.

Që nga ky moment struktura e shoqërisë është si më poshtë

- Julien Roche zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë);
- Marsel Skëndaj zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë);
- Aleksandër Frangaj zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë).

4. DISKUTIMI DHE MIRATIMI I STATUTIT TË RI TË SHOQËRISË

Z. Frangaj shpjegoi se për shkak të ndryshimit të formës së shoqërisë duhej të kryeshin një sërë ndryshimesh në statutin e saj për pa bërë atë konform me ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqëritë tregetare"dhe ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për Radion dhe televizionin në Republikën e Shqipërisë. Kështu duhej të ndryshoheshin objekti, kapitali, oganet drejtuese, mënyra e funksionimit dhe marrjes së vendimeve të shoqërisë, si dhe kontrolli ekonomik i saj. Për këtë arsye është hartuar një version i statutit të shoqërisë në të cilin janë pasqyruar të tëra ndryshimet e kërkuara nga ligji dhe propozime të tjera të ortakëve. Variantin përfundimtar të statutit Z. Frangaj e lexoi me zë të lartë në asamble.

Pas një diskutimi të hollësishëm dhe të gjatë ortakët vendosën me unanimitet miratimin e statutit të ri të shoqërisë në formën që i bashkëngjitet këtij dokumenti. Z Frangaj u ngarkua të kryente të tëra procedurat e nevojshme pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për shdërrimin e formës së shoqërisë dhe depozitimin e statutit të ri.

Pasi shqyrtova kërkesën e tij emova se ajo është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Dhe në bazë të ligjit 7638 datë 19.11. 1992 "Për shoqëritë tregetare", ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per rregjistrin tregetare", si dhe ligjit nr. 8410 datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë"

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës;
- Depozitimin në rregjistrin tregtar të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të Shoqërisë "Media 6" SHPK datë 04.2000;
- Aktin e ekspertimit te ekspertit Z Ilirjan Iloxha per rritjen e kapitalit
- Statuti i ndryshuar i shoqerise
- Urdhërimin e zyrës së rregjistrit tregëtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr rendor 2 në kollonën 4,6 duke bërë vijëzimet me bojë të kuqe.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
Nr 16941/4

V E N D I M
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datë 16.6. 2000 unë, Enkela Bajo, gjyqtare e vetme e Gjykatës së Rrethit Tiranë morra në shqyrtim kërkesën e kërkuesit Aleksandër Frangaj me cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë "Media 6" Sh.A. për rritjen e kapitalit në këtë shoqëri. Pasi shqyrtova kërkesën e tij

K O N S T A T O V A

Shoqëria "Media 6" Sh.A. është rregjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tiranë me nr. 16941 datë 12 Shkurt 1997. Drejtor i shoqërisë është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 40 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave televizive. Shoqëria ka si aksionerë tre persona të cilët zotërojnë aksionet si më poshtë:

- Julien Roche zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë;
- Marsel Skëndaj zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë;
- Aleksandër Frangaj zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë.

Në datën 25.05.2000 u mbajt Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë me pjesëmarrejen e të tërë aksionerëve. Në këtë mbledhje u vendos me unanimitet emërimi i Z. Ilirjan Hoxha si eksperti për kontributet për të vlerësuar kontributet e ortakëve në shoqëri.

Në datën 31.5.2000 i mbajt mbledhja e Aamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë me pjesëmarrejen e të tre aksionërëve për të vendosur në lidhje me këtë rend dite:

1 Miratimin i raportit të ekspertit për rritjen e kapitalit të shoqërisë dhe përcaktimi i kontributit të secilit ortak në këtë kapital;
1. Emetimin e aksioneve të reja, nënshkrimi dhe pagimi i tyre;
2. Ndryshimi i paragrafit të parë të nenit 5 të Statutit të Shoqëisë i cili bën fjalë për kapitalin e shoqërisë;

1 MIRATIM I RAPORTIT TË EKSPERTIT PËR RRITJEN E KAPITALIT TË SHOQËRISË NËPËRMJET KONTRIBUTEVE NË NATYRË

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës pas një diskutimi të hollësishëm aksionerët me unanimitet vendosën:

Miratimin e raportit të ekspertit për kontributet dhe rritjen e kapitalit nga 12,000,000 lek në 180,000,000 (njëqind e tetëdhjetëmilionë) lekë.

3. EMETIMI I AKSIONEVE TË REJA, NËNSHKRIMI DHE PAGIMI I TYRE.

Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës Z. Frangaj i propozoi Asamblesë që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 168,000 (njëqindegjashtëdhjetëetetë mijë) aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila dhe i ftoi ata të deklaronin dhe nënshkuanin secili numrin aksionve që u takonin të paguara prej tyre .

Pas në diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimet vendosën që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 168,000 (njëqindegjashtëdhjetëmijë) aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila. Dhe deklaruan se nënshkruanin përkatësisht këto aksione:

- Z. Julien Roche nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë;
- Z. Marsel Skënde nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë;
- Z. Aleksandër Frangaj nënshkruan 56,000 (tridhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë.

Aksionet u nënshkruan dhe u kontribuan në natyrë nga aksionerët

Që nga ky moment struktura e shoqërisë është si më poshtë

- Julien Roche zotëron 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) lekë;
- Marsel Skëndaj zotëron 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) lekë;
- Aleksandër Frangaj zotëron 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) lekë.

3 NDRYSHIMI I PARAGRAFIT TË PARË TË NENIT 5 TË STATUTIT

Aksionerët vendosin në mënyrë unanime ndryshimin e paragrafit të parë të nenit 5 të Statutit si më poshtë vijon:

"5.1. Kapitalit themeltar i Shoqërisë është caktuar 180,000,000 (njëqind e tetëdhejtëmilionë) lekë i ndarë në 180,000 (njëqindëtetëdhjetëmijë) aksione nominative dhe të regjistruara me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lek secila. Kapitali i Shoqërisë formohet nga kontributet mëposhtme në para dhe në natyrë të Ortakëve Themelues:

a. *Z. Julien Roche, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek;*
b. *Z. Marsel Skënde, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek;*
c. *Z. Aleksandër Frangaj, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek."*

Drejtori kërkoi depozitimin e akteve të mësipërme pranë Zyrës së rregjistrit tregëtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Pasi shqyrtova kërkesën e tij cmova se ajo është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Dhe në bazë të ligjit 7638 datë 19.11. 1992 "Për shoqëritë tregëtare", ligjit 7667 datë 28.1.1993 "Për rregjistrin tregëtar", si dhe ligjit nr. 8410 datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë"

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës;
- Depozitimin në rregjistrin tregtar të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionereve të Shoqërisë "Media 6" Sh.A. datë 25.5.2000;
- Depozitimin në rregjistrin tregtar të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionereve të Shoqërisë "Media 6" Sh.A. datë 31.5.2000;
- Aktin e ekspertimit të ekspertit Z Ilirjan Hoxha për rritjen e kapitalit
- Urdhërimin e zyrës së rregjistrit tregëtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr rendor në kollonën duke bërë vijëzimet me të kuqe.

GJYQTARE

Enkeka Bajo

Tiranë më 16.6. ***2000***

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË
Nr. i Vendimit 16941/5

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, më datë 17.07.2006, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Majlinda Dogga, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Media 6" sh.a,

KONSTATOVA

Shoqeria Media 6 sh.a eshte nje person juridik i regjistruar ne regjistrin e shoqerive tregtare te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me vendim nr.16941, datë 12.2.1997. Me pas jane bere nje sere ndryshimesh ne aktet e shoqerise. Keshtu eshte ndryshuar forma e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime, eshte zgjeruar aktiviteti etj. Sipas akteve te depozituara rezulton se: shoqeria ushtron aktivitetin e transmetimeve televizive, kapitali i saj eshte 180,000,000 (njeqind e tetedhjete milion) leke, dhe se aksionere te shoqerise jane Z. Aleksander Frngaj, Z. Marsel Skende dhe Z. Julien Roche. Keshilli Mbikqyres perbehet nga Marsel Skedaj (kryetar), Julien Roche (anetar) dhe Alba Gina (anetare). Drejtor i shoqerise eshte Aleksander Frangaj.

Me date 11.05.2006, u mbajt Asambleja e Jashtëzakonshme e Shoqërisë Media 6 sh.a në selinë e shoqërisë e ku ka qënë të pranishëm të gjithë aksioenrët që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë:

- Z. Aleksandër Frangaj zotërues i 1/3 të kapitalit aksioner të shoqërisë;
- Z. Marsel Skëndo zotërues i 1/3 të kapitalit aksioner të shoqërise;
- Z. Julien Roche zotërues i 1/3 të kapitalit aksioner të shoqërisë.

Gjithashtu në mbledhjen e Asamblesë ishin ftuar si të pranishëm Znj. Alba Gina dhe Z. Ervin Gjikola.

Asambleja e aksionereve ka marre disa vendime ne lidhje me aktivitetin e shoqerise dhe nder te tjera ka marre eshte vendimet si më poshtë vijon:

1. Miratimin e transferimit të 60,000 (gjashtedhjetemije) aksioneve që aksioneri Z. Marsel Skëndaj zotëron në kapitalin e shoqërisë Media 6 Sh.A. tek personat e mëposhtëm:

   - Z. Aleksandër Frangaj, 6,000 (gjashtë mijë) aksione;
   - Znj. Alba Gina, 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) aksione;
   - Z. Ervin Gjikola, 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) aksione.

2. Miratimi i transferimit të 60,000 (gjashtedhjetemije) aksioneve që aksioneri Z. Julien Roche zotëron në kapitalin e shoqërisë Media 6 Sh.A tek personat e mëposhtëm

- Z. Aleksandër Frangaj, 6,000 (gjashtë mijë) aksione;
- Znj. Alba Gina, 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) aksione;
- Z. Ervin Gjikola, 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) aksione.

Si rjedhojë e transferimeve të mësipërme struktura aksionere e shoqërise do të rezultojë si më poshtë:

- Aleksandër Frangaj do te zotëroje 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) aksioneve te barabarta me 40% te kapitalit aksioner te shoqerise;
- Alba Gina do te zotëroje 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) aksione te barabarta me 40% te kapitalit aksioner te shoqerise;
- Z. Ervin Gjikola do te zoteroje 36.000 (tridhjete e gjashtë mijë) aksione te barabarta me 20% te kapitalit aksioner te shoqerise.

Në vijim u lidhën të gjitha kontratat e transferimit të aksioneve e konkretisht

- Kontratë për shkembimin e aksioneve dhe kuotave nr.rep. 2942, nr.kol 1138, date 11.5.2006, ndërmjet Marsel Skëndajt, Aleksandër Frangaj, dhe Julien Roche;
- Kontratë për Transferimin e Aksioneve nr.rep. 2945, nr.kol 1141, date 11.5.2006, ndërmjet Marsel Skëndajt dhe Alba Gines;
- Kontratë për Transferimin e Aksioneve nr.rep. 2946, nr.kol 1142, date 11.5.2006, ndërmjet Julien Roche dhe Alba Gines;
- Kontratë për Transferimin e Aksioneve nr. rep. 2943, nr. kol 1130, date 11.5.2006, ndërmjet Marsel Skëndajt dhe Z. Ervin Gjikoles;
- Kontratë për Transferimin e Aksioneve nr.rep. 2944, nr.kol 1140, date 11.5.2006, ndërmjet Julien Roche dhe Ervin Gjikoles.

Meqënëse Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Z. Marsel Skëndo dhe Z. Julien Roche kanë dhënë dorëheqjen, personat e mëposhtëm emërohen anëtarë të Këshillit Mbikqyrës me një mandat 3 vjecar:

- Znj. Alba Gina, e bija e Agimit dhe Afërditës, lindur më 14.4.1977, në Lushnjë, banuese në Tiranë, rr. Dervish Hima, nr. 1, pas. nr. Z1019362;
- Z. Sotiraq Bicka, i biri i Kocos, lindur më 31.1.1973, në Korcë, banues në Tiranë, rr. Rreshat Petrela, pall. 12 kate pranë arkivës së shtetit, pas. nr. 0012178;
- Z. Pal Toma, i biri i Prendit, lindur më 5.4.1959, në Kallmet, Lezhë, banues në Tiranë, Rr. Komuna e Parisit, nr. 77, pas. nr 324543.

Keshilli mbikqyres me mbledhjen e tij te pare morri vendimin per emerimin ne cilesine e kryetares se keshillit mbikqyres Alba Ginen.

Drejtori i shoqerise ka paraqtiru kerkese per depozitimin e akteve te mesiperme ne regjistrin tregtar prane gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane

PËR KËTO ARSYE:

Meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentat e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuara në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 19 nëntor 1992, "Për Shoqëritë Tregtare"

dhe Ligjin Nr. 7632, datë 4 nëntor 1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", dhe ligjit 7667, date 28.1.1993, "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës;
- Depozitimin e ne regjstrin tregtar te akteve te meposhtme:
- Vendimin e Asamblese se Aksionereve te shoqerise Media 6 sh.a nr. kol. 2940, nr. rep.1136 date11.5.2006,
- Kontratë për shkembimin e aksioneve dhe kuotave nr.rep. 2942, nr.kol 1138, date 11.5.2006, ndërmjet Marsel Skëndajt, Aleksandër Frangaj, dhe Julien Roche;
- Kontratë për Transferimin e Aksioneve nr.rep. 2945, nr.kol 1141, date 11.5.2006, ndërmjet Marsel Skëndajt dhe Alba Gines;
- Kontratë për Transferimin e Aksioneve nr.rep. 2946, nr.kol 1142, date 11.5.2006, ndërmjet Julien Roche dhe Alba Gines;
- Kontratë për Transferimin e Aksioneve nr. rep. 2943, nr. kol 1130, date 11.5.2006, ndërmjet Marsel Skëndajt dhe Ervin Gjikoles;
- Kontratë për Transferimin e Aksioneve nr.rep. 2944, nr.kol 1140, date 11.5.2006, ndërmjet Julien Roche dhe Ervin Gjikoles;
- Vendimin e Keshillit Mbikqyres date 12.5.006, per emerimin ne detyren e kryetares se Keshillit Mbikqyres te Alba Gines.

- Të urdhëroj ndryshimet përkatëse në kolonën nr....., dhe nr. rendor ..... të Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj Gjykate, duke u ndarë këto shënime me vizë të kuqe nga njëri-tjetri.

Tiranë, më datë 17.07.2006.

GJYQTARE
MALLINDA DOGGA

8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

Nr 252 Akti

VENDIM
PER SIGURIM PADIE

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere prej .

Gjyqtare:Blerina MUÇA

Me sekretare Berzana Çobo, ne Tirane date 22/12/2005 mori ne shqyrtim kerkesen:

KERKUES: Aleksander Frangaj, biri i Vasil dhe Gjyste, dtl 1968, lindur ne Lezhe, banues ne Tirane, me adrese Rr "D.Hima" nr. 1.

KUNDER: **"Media 6"** sh. a, regjistruar me vendim gjykate nr 16941, date 12/02/1997, me seli ne Rr."D.Hima"nr. 1, Tirane (ne mungese).
Marsel Skendo, dtl 1949, lindur ne Tepelene, banues ne Rr "D.Hima", Nr 1, Tirane (ne mungese).
Julien Roche, lindur me 02/07/1954 ne Bour En Bresse, banues ne Rr "D.Hima", Nr1, Tirane (ne mungese) .

OBJEKTI : Marrja e mases provizore te sigurimit te padise duke vendosur pezullimin e depozitimeve ne Regjistrin tregetare per shoqerine "Media 6" sh. a.

BAZA LIGJORE : Neni 202 e vijues te K.Pr.C, neni 73, 77, 132 e vijues i ligjit "Per shoqerite tregetare" .

Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen ne mungese te pales se interesuar

ortaket ne nje kohe qe keto investime duhet te jene te specifikuara dhe per vleresimin e tyre do te duhej te caktohej nje ekspert vleresues.
Ne keto kushte, kur kerkuesi me cilesine e nje prej ortakeve te shoqerise, aktualisht aksioner i saj pretendon se shlyerja efektive e aksioneve te emetuara ne momentin e shnderrimit nuk eshte realizuar per kete shkak ai do te paraqese padi ne gjykate me objekt "Deklarim pavlefshmerie i shnderrimit te shoqerise" (kopje te ciles e ka paraqitur ne kete Gjykate) Gjykata cmon se vendimet e mepasshme te Asamblese se Aksionereve mund te cenojne interesat e kerkuesit dhe ne baze te nenit 202 e vijues te K. Pr. C. vendos te pranoj kerkesen dhe te pezulloj veprimet e metejshme ne regjistrin tregetare per shoqerine "Media 6 " sh. a deri ne perfundim te shqyrtimit te padise se paditesit A. Frangaj, e cila ne baze te nenit 204 te K. Pr. C. duhet te paraqitet ne Gjykate brenda 15 diteve nga data e vendimit te sigurimit te saj .

PER KETO ARSYE
Konform nenit 202 e vijues te K.Pr.C.

V E N D O S I

-Pranimin e kerkeses se kerkuesit Aleksander Frangaj.
-Marrjen e mases provizore te pezulllimit te veprimeve ne praktiken e shoqerise "Media 6 " sh. a me nr. 16941, date 12/02/1997 prane Regjistrit Tregetar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane.
-Detyrimin e kerkuesit A.Frangaj te paraqese ne Gjykate per shqyrtim padine e themelit brenda 15 diteve.
-Te depozitohet nje kopje vendimi ne Regjistrin Tregetar.
-Kunder vendimit mund te behet ankim brenda afatit ligjor ne Gjykaten e Apelit Tirane.
Afati fillon nga marrja dijeni per palen e interesuar.
Tirane me 22/12/2005

SEKRETARE
Berzana ÇOBO

GJYQTARE
Blerina MUÇA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR-TIRANE

NR. 2470 Aktit **Nr. 2852 Vendimit**

V E N D I M

" MBI PUSHIMIN E GJYKIMIT "

Sot me dt. **18.05.2006**, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit gjyqesor Tirane ,Majlinda Dogga, thirra per veprime pergatitore palet :

PADITËS: **Aleksander Frangaj**, i biri i Vasilit dhe Gjystes, dtl. 04.10.1968, lindur ne Lezhe, banues ne Tirane

TE PADITUR **1.Marsel Skendaj**, lindur ne Tepelene me 06.11.1949, banues ne Tirane , Rr Dervish Hima " nr. 1 perfaqsuar me prokure te posacme nr. 620 rep, 234 kol, dt, 03.02.2006 nga avokat Sokol Elmazaj .
2.Julien Roche, lindur ne Bour En Bresse, me dt. 02.07.1954, banues ne Tirane, Rr" Dervish Hima " , prane gazetes " Korieri " .
3. Media 6 Sh. A Person juridik shqiptar , i regjistruar me vendimi nr. 19641,me seli -Rr" Dervish Hima nr. 1 Tirane .

OBJEKTI: Deklarimi absolutisht i pavlefshem i shndrrimit te shoqerise nga forma shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime .
Deklarimi absolutisht i pavlefshem i vendimeve te asamblese se ortakeve , dt. 25.04.2000 dhe 30.05.2000, prishja me nenvizim e depozitimit te ketyre vendimeve nga regjistri tregtar , marrja e mases provizore per pezullimin e ekzekutimit te vendimeve dt. 25.04 2000 dhe 30.05.2000 te Asamblese se Aksionereve depozituar ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimet e depozitimit 1641/3 dhe 1641/4 .

SHENIM: Vertetohet se ky vendim ka marrë formë te prere me dt 04.06.2006 per paditesin ne mungese me dt 23.05.2006 per anen e paditur

Tiranë me dt 05.06.2006

K/SEKRETARE

Mimoza LULAJ

KANCELARI

Hir. SAULI

PULLE TAKSE

100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Tirakër mjeristimi

NR : 16941

1

2 a- "Media 6" Shpk

b- Rr. "Myslym Shyri" Nr 8/1 Tiranë

c- veprimtari botuese revistash, gazetash, librash, fregatim i syrë botimi i revistës Klan. ....

ë. 100 000 lekë
- Julien Roche - 25.
- Marcel Sundo - 25.
- Aleksandri Frangaj - 50.

3. Adm: Aleksandri Frangaj dt. 1968 bonus lekë D. "Besiidhja" p. 154

4- 10 vjet
Ak- 3 flete + 1 M.
St- 6 flete

5. 11-2-97
12-2-97

Mjedy

Akt- depozitim Nr 2 dt. 11-2-97.
noteri M. Sadushi

KONTRATE
PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE "MEDIA 6" Sh.p.k.

Personat e meposhtem:

1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja ''Beslidhja'', Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935;

2. Julien Roche, shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne Paris, Avenue ''Mozart'', me pasaporte nr.03/97;

3. Marsel Skendo, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne rrugen ''Fadil Rada'', Pallati 11, Ap.11, Tirane, me pasaporte nr.0165026

te quajtur me poshte "ortake", rane dakord te krijojne nje shoqeri tregtare te se Drejtes Shqiptare, ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", duke percaktuar kushtet e meposhtme:

Neni 1. Forma dhe emertimi

Shoqeria e sapo krijuar eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar dhe emertohet "Media 6" Sh.p.k.

Neni 2. Selia e shoqerise:

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne Rrugen "Myslym Shyri" N. 8/1. Ajo mund te transferohet ne nje vend tjeter me vendim te shumices absolute te Asamblese se Ortakeve.

Neni 3. Kohezgjatja:

Aktiviteti i kesaj shoqerie do te zgjase per nje periudhe kohe prej 10 vjetesh. Ortaket mund ta zgjasin kete afat ose mund te vendosin qe ta prishin shoqerine perpara ketij afati.

Neni 4. Statusi

Shoqeria fiton statusin e personalite juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar. Ajo eshte person juridik i se Drejtes Shqiptare dhe keshtu veprimtaria e saj rregullohet nga Legjislacioni Shqiptar, nga kjo Kontrate Themelimi dhe nga Statuti i nenshkruar rregulisht nga ortaket themelues.

Neni 5. Objekti i veprimtarise:

Shoqeria do te kryeje veprimtari botuese revistash, gazetash, librash, tregetim te tyre, ne menyre te vecante duke filluar me botimin e revistes se emertuar KLAN, import-eksport mallrash e materialesh qe i sherbejne aktivitetit prodhues, shperndares e tregetues te botimeve te mesiperme, aktivitet ne fushen e

Aleksander Frangaj

mediave elektronike ne baze te dispozitave ligjore qe do te rregullojne keto lloj veprimtarish.

Shoqeria rezervon te drejten te modifikoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe ne menyren e percaktuar ne kete statut.

Neni 6. Kapitali themeltar:

Kapitali themeltar i shoqerise caktohet ne shumen 100000 leke dhe nenshkruhet nga te tre ortaket dhe depozitohet prane nje noteri.

Kapitali themeltar ndahet ne 100 pjese te barabarta me vlere nominale 1000 leke secila.

Kontributet e ortakeve ne kapitalin themeltar jane perkatesisht:

1.	Ortaku Julien Roche	25 pjese(25%)
2.	Ortaku Marsel Skendo	25 pjese(25%) dhe
3.	Ortaku Aleksander Frangaj	50 pjese(50%)

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve qe merr miratimin e 3/4 te ortakeve.

Zvogelimi nen shumen e kapitalit themeltar detyron ortaket qe te marrin vendim edhe per shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter.

Zvogelimi i kapitalit pas rritjeve te tij, brenda kufijve te pranuara nga ligji, kushtezon edhe riorganizimin e pjeseve te kapitalit dhe masen e kontributeve te secilit ortak.

Ne rast zmadhimi te kapitalit, shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7. Transferimi i pjeseve:

7.01 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakeve. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rruge trashegimie.

7.02 Pjeset e kapitalit themeltar mund t'i transferohen nje personi te trete qe nuk ben pjese ne shoqeri vetem pasi te jete aplikuar opcioni I parablerjes nga ortaket e shoqerise.

Neni 8. Ndarja e fitimt

Fitimi i realizuar nga shoqeria, mbas heqjes se shpenzimeve, pagesave te ndryshme, taksave e tatimeve, ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me shkallen e pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 9. Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve.

Ortaket kane keto te drejta kryesore:

Aleksander Frangaj

- te ndihmojne shoqerine ne aktivitetin drejtues dhe organizativ ne perputhje me Statutin dhe Kontraten e Themelimit.
- te bejne propozime dhe t'ia paraqesin ato per shqyrtim Asamblese se Ortakeve.
- te kerkojne te dhena e raporte nga organet e shoqerise per ecurine financiare dhe ekonomike te saj.
- Te marrin pjese ne ndarjen e fitimeve te shoqerise.

Ortaket kane keto detyrime kryesore:

- te shlyejne pjesete e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise ne perputhje me kontraten e themelimit.
- te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve dhe te zbatojne vendimet e marra nga ajo ne perputhje me dispozitat e Statutit.
- te ndihmojne shoqerine ne drejtim te sigurimit te kushteve per funksionimin dhe aktivitetin e saj.
- te ruajne sekretin per te dhenat e shoqerise.

Neni 10. Administrimi i shoqerise:

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator, i cili emerohet per nje afat njevjecar. Emerimi behet me vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me dispozitat e Statutit.

Administrator i pare i shoqerise eshte Ortaku Aleksander Frangaj.

Administratori ushtron te drejtat dhe kryen detyrat qe percakton neni 50 i ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" si dhe Satuti bashkelidhur.

Neni 11. Asamblea e Ortakeve:

Asamblea e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise.

Ortaket marrin pjese ne Asamblene e Ortakeve te shoqerise e cila mblidhet ne mbledhje te zakonshme ose te jashtezakonshme per te marre vendime per ceshtjet me te rendesishme qe i perkasin shoqerise sic percaktohen ne Statutin bashkelidhur.

Mbledhjet e zakonshme behen te pakten nje here ne vit. Ortaket marrin pjese ne vendimet e Asamblese duke disponuar nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe zoteron sejcili.

Menyra e funksionimit, detyrat dhe te drejtat, procedurat dhe organizimi qe ka Asamblea percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

Neni 12. Te ndryshme

Mosmarreveshjet mes ortakeve qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

ORTAKET THEMELUES

Aleksander Frangaj

Marcel Skenduaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 1494 REP.
NR. 433 KOL.

V E R T E T I M

Sot, me date 11 shkurt 1997, para meje noteres Mimoza Sadushi u paraqit personalisht 1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja ''Beslidhja'', Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935; 2. Julien Roche, shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne Paris, Avenue ''Mozart'', me pasaporte nr.03/97; 3. Marsel Skendo, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne rrugen ''Fadil Rada'', Pallati 11, Ap.11, Tirane, me pasaporte nr.0165026 ''Per Shoqerite Tregtare''. Pasi u binda per identitetin e tij nepermjet verifikimit te dokumenteve personale te identifikimit, vertetoj nenshkrimin e tij ne perputhje me kerkesat e ligjit.

MIMOZA SADUSHI
NOTERE
sa: Pallatet e Lanès, 1
e Fax : 355 42 23866
TIRANË ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MIMOZA SADUSHI
NOTERE
TIRANE

STATUTI
I
SHOQERISE TREGTARE "MEDIA 6" Sh.p.k.

Ortaket themelues te shoqerise ''MEDIA 6'' sh.p.k.

1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja ''Beslidhja'', Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935

2. Julien Roche, shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne Paris, Avenue ''Mozart'', me pasaporte nr.03/97

3. Marsel Skendo, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne rrugen ''Fadil Rada'', Pallati 11, Ap.11, Tirane, me pasaporte nr.0165026

nenshkruajne statutin e shoqerise i cili rregullon funksionimin e shoqerise nepermjet dispozitave te meposhtme:

Neni 1. Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte "MEDIA 6" Sh.p.k., qe me poshte do te quhet "shoqeria".

Ky emertim duhet te pasqyrohet ne te gjithe dokumentacionin e brendshem te shoqerise si dhe ne korrespondencen me te tretet.

Emertimi i saj do te pasohet menjehere nga fjalet "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose shkurt Sh.p.k., nga numri i regjistrimit te saj, emri i administratorit dhe selia.

Neni 2. Forma juridike e shoqerise

Shoqeria tregtare "Media 6" Sh.p.k. eshte person juridik shqiptar i formes juridike me pergjegjesi te kufizuar dhe funksionon ne perputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar ne teresi e te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", te Kontrates se Themelimit dhe Statutit te saj, ne vecanti.

Neni 3. Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Tirane ne Rrugen "Myslim Shyri", Nr. 8/1.

Asamblea e Ortakeve, me shumice absolute votash, mund ta transferoje seline ne nje vend tjeter.

Neni 4. Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar per 10 vjet. Ky afat mund te shtyhet me tej ose te shkurtohet me vendim te ortakeve sipas dispozitave te ketij Statuti.

Neni 5. Statusi

Shoqeria fiton statusin e personit juridik nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit te Tiranes.

Ajo ne cdo rast pergjigjet vetem me pasurine e saj ndersa ortaket nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise dhe per humbjet qe mund t'i ndodhin asaj tej pjeseve te kapitalit qe ata kane shlyer ne kapitalin themeltar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 6. Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kryeje veprimtari botuese revistash, gazetash, librash, tregetim te tyre, ne menyre te vecante duke filluar me botimin e revistes se emertuar KLAN, import-eksport mallrash e materialesh qe i sherbejne aktivitetit prodhues, shperndares e tregetues te botimeve te mesiperme, aktivitet ne fushen e mediave elektronike ne baze te dispozitave ligjore qe do te rregullojne

Shoqeria rezervon te drejten te modifikoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe ne menyren e percaktuar ne kete statut.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 7. Kapitali fillestar

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000leke(njeqindmije) dhe ndahet ne 100(njeqind) pjese te barabarta me vlere nominale 1000leke secila.

Pjeset e kapitalit nenshkruhen dhe shlyhen nga ortaket ne raportet e meposhtme:

a)	Ortaku Julien Roche	25 pjese(25%)
b)	Ortaku Marsel Skendo	25 pjese(25%)
c)	Ortaku Aleksander Frangaj	50 pjese(50%)

Neni 8. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar

Zmadhimi i kapitalit fillestar do te behet me vendim te Asamblese se Ortakeve me ane te kontributeve ne para dhe/ose ne natyre.

Vleresimi i cdo kontributi ne natyre do te behet neprmjet nje raporti qe do te hartohet nen pergjegjesine e tij nga nje ekspert per kontributet i emeruar me vendim te gjykates sipas kerkeses se administartorit.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga Asamblea e Ortakeve qe merr vendim per kete nese do te votojne "pro" ortaket qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne

te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 9. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rast trashegimnie ose ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'i transferohen nje personi te trete qe nuk ben pjese ne shoqëri vetëm në kushtet dhe sipas procedurës së mëposhtme:

Ortaku që dëshiron të transferojë pjesë të kapitalit themeltar tek një person i tretë që nuk bën pjesë në shoqëri duhet më parë t'ia njoftojë projektin e transferimit në formë të shkruar si shoqërisë ashtu edhe sejcilit ortak vecas. Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë jo-pjesmarrës në shoqëri vetëm me miratimin e e shumicës së ortakëvë që përfaqësojne të paktën tre të katërtat e pjesëvë të kapitalit themeltar. Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin për transferimin, ortakët, brënda tre muajve nga data e refuzimit te shoqërisë, duhet që t'i blejne vete këto pjesë duke gëzuar të drejtën e parablerjes. Në rast se nuk e përdorin këtë të drejtë ortaket lejojne transferimin e pjesëve tek personi i tretë me të njëjtat kushte si ato të ofruara ortakëvë të shoqërisë. Vlera e pjesëvë të kapitalit themeltar që do të transfrohen, në rast mosrënieje dakord ndërmjet ortakëve, do të caktohet nga një ekspert i caktuar prej tyre. Kur ata nuk do të merren vesh ndërmjet tyre eksperti caktohet nga Gjykata.

ASAMBLEA E ORTAKEVE

Neni 10. Kompetencat

Asamblea e Ortakëve mund te jete e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Ajo merr vendimet më të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë dhe me politikën ekonomike, komerciale dhe organizative të saj.

1. Asamblea e zakonshme e ortakëve vendos:

a) për bilancin vjetor të shoqërisë;
b) për emërimin ose shkarkimin e administratorit;
c) për strukturën organizative te shoqërisë së revistës apo gazetës si dhe të numrit total të vendeve të punës në to;
d) për masën e shpërblimit të administratorit të shoqërisë, të drejtorit dhe te kryeredaktorit të revistës apo gazetës;
e) miratimin e buxhetit vjetor dhe projektet e shoqërisë per te ardhmen;
f) zgjedhjen e kryetarit të Asamblesë së Ortakëve;
g) për cdo vendim tjetër që ka lidhje me shoqërinë me perjashtim të atyre cështjeve që me këtë Statut, në bazë të ligjit, u janë lënë në kompetencë organeve të tjera të shoqërisë.

2. Asamblea e jashtëzakonshme vendos:

a) për ndryshimin Statutit;
b) për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
c) për prishjen e shoqërisë.

3. Ortaku Aleksander Frangaj caktohet edhe drejtor i revistes dhe do te jete kompetent për percaktimin e struktures profesionale te stafit te redaksise, emërimin ose shkarkimin kryeredaktorit të revistës ose gazetës;

Drejtori I raporton Asamblese per ecurine e revistes dhe i paraqet asaj per miratim Rregulloren e Funksionimit te Redaksise.

Neni 11. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve

Asamblea e zakonshme e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit mbas nje thirrjeje të bërë me shkrim nga Kryetari i Asamblesë që u dërgohet ortakëve të paktën 30 ditë përpara.

Kjo thirrje duhet të dërgohet në adresën e dhënë në Librin e Ortakëve.

Asamblea e Ortakëve është e vlefshme nga pikpamja konstitutive dhe merr vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë te pakten më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai disponon.

Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve.

Proces-verbali i mbledhjes së Asamblesë nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i saj të cilët caktohen për cdo mbledhje të Asamblesë.

Vendimet në Asamble merren dhe quhen të vlefshme nëse për to kanë votuar "pro" ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë me përjashtim të cështjeve të mëposhtëme për miratimin e të cilave duhet vota "pro" e të paktën tre të katërtave të pjesëve të kapitalit themeltar sic janë:

- ndryshimet në Statutin e shoqërisë;
- zvogëlimi i kapitalit themeltar;
- emërimi i drejtorit dhe kryeredakorit të revistës ao gazetës;
- shpërndarja ose prishja e shoqërisë.

Neni 12. Administratori

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator i vetëm që emërohet nga Asamblea e zakonshme e Ortakëve. Ai mund të mos jetë ortak në shoqëri. Kohëzgjatja e mandatit te administratorit është nje vit dhe mund te rinovohet ne mbarim te fatatit nje vjecar

Administratori mund të shkarkohet para mbarimit te mandatit me vendim te shumices absolute te Asamblese se Ortakeve.

Administrator per vitin e pare financiar emerohet ortaku Aleksander Frangaj.

Neni 13. Kompetencat e Administratorit

Administratori i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që me ligj u janë dhënë shprehimisht ortakëve.

Ai ka të drejta të plota për drejtimin operativ të shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që gëzon Asamblea e Ortakëve në bazë të nenit 9 të këtij Statuti.

Administratori përfaqëson shoqërinë në të gjitha veprimet juridike, financiare si dhe ka të drejtën të veprojë në emër të shoqërisë në organet e ndryshme si ato fiskale, doganore, bankare, gjyqësore etj.

Administratori mbulon edhe veprimtarine shperndarese te botimeve, marketingun etj.

VEPRIMTARIA EKONOMIKE E SHOQERISE

Neni 14. Ushtrimoret

Ushtrimoret fillojne normalisht më 1 Janar dhe mbarojne më 31 Dhjetor të cdo viti.

Perjashtimisht, ushtrimori i parë fillon në datën e themelimit të shoqërisë dhe mbaron me 31 Dhjetor 1997.

Neni 15. Marredheniet e punesimit

Marredheniet e punes me punemarresit jane kompetence e Adminstratorit, duke perfshire edhe te drejten per te zgjidhur kontratat e punes.

Sidoqofte Asamblea rezervon te drejten te anulloje vendimin e tij per zgjidhje te kontrates se punes kur konstaton se zgjidhja eshte bere pa shkaqe te arsyeshme

Neni 16. Libri i llogarisë

Shoqëria do të mbajë librat e llogarisë, do të nxjerrë bilancet si dhe do të përllogarisë fitime dhe humbjet në përputhje me legjislacionin përkatës ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë te vecantë të ligjit nr.7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin".

Neni 17. Rezerva e domosdoshme

Nga fitimi i realizuar vjetor caktohet një fond rezervë në masën 1/20 e tij që destinohet për formimin e një Fondi Rezerve të quajtur "Rezervë e domosdoshme".

PRISHJA E SHOQERISE

Neni 18. Prishja e shoqërisë

Shoqëria mund të prishet në rastet e mëposhtme:

- Kur mbaron afati i caktuar në aktet e themelimit të shoqërisë.
- Kur merret vendim nga Asamblea e Ortakëve sipas nenit 9 të këtij Statuti.
- kur ka humbje të gjysmës së kapitalit themeltar, sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 72 të ligjit nr. 7638, datë 19.01.1992 "Për shoqëritë tregtare".
- kur realizimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë behet I pamundur.

Neni 19. Likujdimi

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi themeluesit caktojnë një likujdator që do të paraqesë Raportin e Likujdimit në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.01.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Julien Roche

Neni 20. Mosmarreveshjet

Mosmarrëveshjet eventuale do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Aleksander Frangaj Ortaket themelues

M. Skendo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 1495 REP.
NR. 434 KOL.

V E R T E T I M

Sot, me date 11 shkurt 1997, para meje noteres Mimoza Sadushi u paraqit personalisht 1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja ''Beslidhja'', Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935; 2. Julien Roche, shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne Paris, Avenue ''Mozart'', me pasaporte nr.03/97; 3. Marsel Skendo, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne rrugen ''Fadil Rada'', Pallati 11, Ap.11, Tirane, me pasaporte nr.0165026 ''Per Shoqerite Tregtare''. Pasi u binda per identitetin e tij nepermjet verifikimit te dokumentevë personale te identifikimit, vertetoj nenshkrimin e tij ne perputhje me kerkesat e ligjit.

MIMOZA SADUSHI
NOTERE
sa: Pallatet e Lanës, 1
e Fax - - 355 42 23866
TIRANË ALBANIA

N O T E R E

STATUTI .
I
SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE
MEDIA 6 SH.A
KREU I – EMERTIMI – SELIA – KOHEZGJATJA

Neni 1 – Forma

1,1 Shoqeria MEDIA 6 SH.A [me poshte referuar si "Shoqeria"] eshte themeluar ne formen e shoqerise anonime pa oferte publike dhe rregullohet nga ky Statut dhe nga Akti i Themelimit.

1.2 Shoqeria vepron ne perputhje me dispozitat e ketij statuti dhe me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi

Neni 2 - Emertimi dhe Selia

2.1 Emertimi i Shoqerise eshte MEDIA 6 SH.A

2.1 Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, Rruga Dervish Hima, Ada Tower, kati II.

2.2 Shoqeria mund te hape filiale, agjensi dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte vendit, me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Neni 3 – Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e Shoqerise eshte 40 (dyzet) vjet duke filluar nga regjistrimi i Shoqerise ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane. Nje kohezgjatje e tille mund te zgjatet ne vijim me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

KREU II - OBJEKTI

Neni 4 – Objekti i Shoqerise

4.1 Objekti i Shoqerise eshte aktiviteti radioteleviziv privat. Ai perfshin prodhimin, transmetimin, dhe ritransmetimin e programeve dhe informaioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara,

shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.

4.2. Aktiviteti i Shoqerise do plotesohet duke respektur paanshmerisht te drejten per informacion, bindje politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jeten private te njeriut, si dhe te drejtat dhe lirite themelore te tij.

4.3 Shoqeria mund te financohet nepermjet reklames dhe sponsorizimeve ne perputhje me sa parashikon legjislacioni ne fuqi.

4.4 Sipas legjislacionit ne fuqi dhe per arritjen e objektit te Shoqerise dhe qellimeve te saj Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte qe lidhen me qellimin e mesiperm, te marre interesa jo aksionere ne Shoqeri apo persona te tjere juridik te cilet mund te kene edhe qellime te tjera por qe lidhen me aktivitetin televiziv. Ajo mund te jape garanci dhe/ose mund te hipotekoje ne favor te ndonje banke, insituti krediti dhe financiar.

4.5 Aktiviteti i Shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me aktet normative te Republikes se Shqiperise dhe ne menyre te vecante me ligjin nr. 7638, te dates 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregetare" dhe ligjin nr.8410, date 30 shtator 1998 "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise".

KREU III – AKSIONET – KAPITALI

Neni 5 – Kapitali i Shoqerise

5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte caktuar 12.000.000 [dymbedhjetemiljon] Lek i ndare ne 12.000 [dymbedhjetemije], aksione nominative dhe te regjistruara me nje vlere nominale prej 1.000 (njemije) Lek secila. Kapitali i Shoqerise formohet nga kontributet e meposhteme ne para dhe ne natyre te Ortakeve Themelues:

a- Z.Julien Roche, ka nenshkruar 4.000 (katermije) aksione, te barabarta me 4.000.000 [katermiljon], Lek.

b- Z.Marsel Skendo, ka nenshkruar 4.000 (katermije) aksione, te barabarta me 4.000.000 [katermiljon] Lek..

c- Z.Aleksander Frangaj, ka nenshkruar 4.000 (katermije) aksione, te barabarta me 4.000.000 [katermiljon] Lek.

5.3 Cdo aksion eshte i pandashem dhe siguron te drejten e nje vote.

5.4 Transferimi i pronesise mbi aksionet nje personi te trete, me perjashtim te rasteve te trashegimise, i nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te Aksionereve te tjere, te cilet mund te ushtrojne kete te drejte brenda 20 ditesh nga marrja e letres se derguar me poste rekomande ose me fax qe permban oferten e blerjes. Te gjitha njoftimet e parashikuara ne kete nen duhet t'i adresohen edhe Shoqerise.

5.5 Ne rastin e rritjes se kapitalit te Shoqerise, aksionet e reja i ofrohen Aksionereve ne proporcion me numrin e aksioneve te zoteruara prej tyre, ne baze te Nenit 155 dhe me pas te ligjit Nr. 7638, date 19 nentor 1992 "Mbi Shoqerite Tregetare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme.

5.6 Ne rast shkaterrimi ose humbje te certifikates Drejtoria mund te leshoje certifikata te reja Drejtoria mund te percaktoje afatet dhe kushtet qe i konsideron te nevojshme dhe mund te kerkoje demshperblimet e konsideruara te pershtateshme, per te mbrojtur Shoqerine nga ndonje padi e cila mund te ngrihet kunder saj lidhur me cfaredo lloj certifikate e cila pretendohet te kete humbur ose te jete shkaterruar.

KREU IV – ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Neni 6 – Asambleja e Aksionereve

6.1 Organi vendim-marres i Shoqerise eshte Asambleja e Aksionereve, e cila perbehet prej te gjithe Aksionereve te Shoqerise.Vendimet e ligjeshme te saj obligojne dhe aksioneret qe mungojne ose qe nuk kane qene dakort. Asambleja e aksionereve mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asambleja e Aksionereve mund te mblidhet ne Shqiperi dhe jashte Shqiperise. Njoftimi per thirrjen do te behet sipas percaktimit te nenit 133 te ligjit nr.7638, dt 19.nentor.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe do te tregoje vendin dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.

6.2 Asambleja e Aksionereve thirret nga Kryetari i Keshillit Mkiqyres ose nga Drejtori. Ajo mund te thirret gjithashtu ne perputhje me nenin 132 te Ligjit nr 7638, date 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregetare" me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme.

6.3 Thirrja e Asamblese se Aksionereve mund te behet dhe nga Aksioneret qe perfaqesojne te pakten 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit te Shoqerise.

6.4 Asambleja e Aksionereve do te konsiderohet e thirrur ne menyren e duhur edhe nese nuk jane respektuar formalitetet qe rregullojne nje thirrje te

tille, me kusht qe ne nje Asamble te tille te marrin pjese te gjithe Aksioneret, personalisht apo te perfaqesohen me prokure, te gjithe Drejtoret dhe te gjithe anetaret e Keshillit Mbikqyres.

6.5 Aksioneret te cilet jane te regjistruar qe prej te pakten 5 (pese) ditesh ne regjistrin e Aksionereve dhe aksioneret te cilet depozitojne aksionet e tyre ne baze te udhezimeve dhe afateve te percaktuara ne njoftimin e thirrjes mund te marrin pjese ne Asamblene e Aksionereve.

6.6 Asambleja e Aksionereve ne mbledhjen e saj te pare zgjedh nga anetaret e saj Presidentin e Asamblese.Te gjitha Asamblete e aksionereve drejtohen nga Presidenti i Asamblese se Aksionereve, ose nese ky person nuk ka mundesi te marre pjese, nga nje aksioner i emeruar nga Asambleja e Aksionereve. Asambleja e Aksionereve emeron nje sekretar te Asamblese i cili nuk mund te jete dhe aksioner.

6.7 Aksioneret mund te zgjedhin qe te perfaqesohen ne Asamblene e Aksionereve, me nje prokure te shkruar nga nje aksioner tjeter ose nga bashkshorti/ja e tij/saj.

6.8 Presidenti i Asamblese se Aksionereve hap dhe drejton mbledhjen e saj. Sekretari ne fillim te cdo mbledhjeje verifikon prokurat dhe rregullshmerine e tyre, numrin e pjesemarresve te pranishem, nese eshte arritur quorumi i caktuar, numeron votat dhe mban procesverbalin si dhe i raporton Asamblese nese ajo eshte mbledhur ne menyre te rregullt dhe per rregullshmerine e pjesemarrjes.

6.9 Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet ne fund te saj nga Presidenti dhe Sekretari.

Neni 7 – Asambleja e zakonshme

7.1 Asambleja e zakonshme duhet te mbahet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajsh nga fundi i vitit financiar dhe vendos per :

- Percaktimi dhe ndryshimi i programit te veprimtarise afatshkurter, afat mesem dhe afatgjate te Shoqerise.
- Miratimi ose mosmiratimi i bilancit vjetor financiar te Shoqerise.
- Kryerja e investimeve dhe financimeve per vitin financiar.
- Miratimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve te tij.
- Emerimi, pezullimi ose shkarkimi i anetarit te Keshillit Mbikqyres si dhe caktimi I mases se shperblimit te tij.
- Emerimi ose shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar te shoqerise.

- Perdorimi i fitimit neto dhe pjesen qe do ti shperndahet cdo aksioneri ne forme dividenti.

7.2 Ne perputhje me sa parashikohet nga neni 20 i ligjit 8410 date 30 shtator 1998, "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise ", dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, Asambleja e Zakonshme e Aksionereve eshte vlefshmerisht e mbledhur ne thirrjen e pare dhe te dyte kur eshte e pranishme apo e perfaqesuar me prokure, te pakten 2/3 e aksioneve.

7.3 Asambleja e zakonshme merr vendimin me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 8 – Asambleja a Jashtezakonshme

8.1 Asambleja e Jashtezakonshme vendos per :
- Modifikimin ose ndryshimin ne statutin e Shoqerise.
- Zmadhim ose zvogelim te kapitalit te Shoqerise.
- Marrjen e huave nga Shoqeria, dhenien e paradhenieve nga ato, berjen e dorezanes ose te garantoje detyrimet ndaj te treteve.
- Zgjedhjen e likuidatorit.
- Zgjatjen ose shkurtimin e kohezgjatjes se veprimtarise te Shoqerise dhe per shkrirjen bashkimin, ose prishjen e Shoqerise.
- Themelimin e Shoqerive te reja ose pjesmarrjen ne Shoqeri te tjera
- Shitja ose shkembimi i pasurive qe perbejne fondin, arkivor te Shoqerise.

8.2 Ne perputhje me sa parashikohet nga neni 20 i ligjit 8410 date 30 shtator 1998, "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise ", dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve eshte vlefshmerisht e mbledhur ne thirrjen e pare dhe te dyte kur eshte e pranishme apo e perfaqesuar me prokure, te pakten 2/3 e kapitalit.

8.3 Ne rast se ky quorum nuk arrihet qe ne thirrjen e pare, mbledhja e dyte e Asamblese mund te shtyhet per nje date te mevoneshme, por jo me vone se 2 muaj nga data e thirrjes se Asamblese se pare.

8.4 Asambleja e jashtezakonshme e Aksionereve vendos me nje shumice te votave prej 3/4 [tre te katertat] e votave qe u perkasin aksionereve te Shoqerise te pranishem apo te perfaqesuar. Ne thirrjen e dyte vendimi merret me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

KREU 5 – ADMINISTRIMI I SHOQERISE – KESHILLI MBIKQYRES

Neni 9 – Perberja dhe Emertimi i Anetareve te Keshillit Mbikqyres

9.1 Keshilli mikqyres perbehet nga nje numer prej 3 tre antaresh.

9.2 Ne baze te Neni 105 te ligjit nr. 7638, date 19 Nentor 1992, "Per Shoqerite Tregetare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, Anetaret e pare te Keshillit mikqyres jane :

1- Z. Julien Roche, qytetar francez, lindur ne Bourg En Bresse, me 1954, dhe banues ne Durres, me Pas. nr 91AE75972 (me adrese ne Shqiperi Blloku i Vilave Plazh Durres).
2- Z Marsel Skendaj, qytetar shqiptar, lindur ne Tepelene, me 06.11.1949 dhe banues ne Tirane, me Pas. nr 0165026 (me adrese ne Shqiperi Rr Dervish Hima , ADATower, kati 14, Tirane).
3- Znj. Alba Gina, qytetare shqiptare, lindur ne Lushnje, me 14.05.1975 dhe banuese ne Tirane, me Pas. nr 1262114 (me adrese ne Shqiperi Rr Dervish Hima, ADA Tower, kati 13, Tirane), e zgjedhur ne baze te nenit 109 te ligjit nr. 7698 dt. 19.nentor.1992, « Per Shoqerite Tregetare ».

9.3 Mandati i anetareve te Keshillit Mbikqyres eshte 3 (tre) vjet dhe ata mund te rizgjidhen. Antaret e emeruar nga Asambleja e Aksionereve dhe ata te zgjedhur nga Punemarresi mund te revokohen per cdo arsye nga Asambleja e Aksionereve. Anetaret e zgjedhur nga punemarresit mund te revokohen edhe per rastet e parashikuara ne ligj dhe nga ky statut.

9.4 Ne rast vdekjeje, shkarkimi apo doreheqje, vendet vakant ne Keshillin Mbikqyres mund te zevendesohen brenda 3 muajsh. Anetari i Keshillit mbikqyres, i emeruar per te zevendesuar nje anetar tjeter, do te qendroje ne post per te gjithe kohen e mbetur te mandatit te paraardhesit.

9.5 Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te marrin pjese ne me shume se 9 (nente) Keshilla Mbikqyres te tjere te shoqerive anonime , te cilat kane seline e tyre ne territorin e Republikes se Shqiperise.

9.6 Asambleja e Aksionereve mund te caktoje shperblim per anetaret e Keshillit Mbikqyres sic eshte parashikuar nga ligji.

Neni 10 – Kryetari dhe Zevendeskryetari I Keshillit Mbikqyres

10.1 Keshilli Mbikqyres emeron nje kryetar dhe nje Zevendeskryetar nga anetaret e tij te cilet jane caktuar te therrasin mbledhjet e Keshillit dhe drejtojne diskutimet.

10.2 Kryetari dhe Zevendeskryetari i keshillit mund te marrin shperblim shtese, te caktuar nga Keshilli.

10.3 Keshili Mbikqyres mund te emeroje here pas here nje sekretar qofte dhe jo nga anetaret e tij.

10.4 Ne rast mungese te Kryetarit, mbledhjet e Keshillit drejtohen nga Zevendeskryetari.

Neni 11 – Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres

11.1 Keshilli Mbikqyres mblidhet rregullisht te pakten nje here ne tre muaj dhe sa here qe konsiderohet e nevojshme. Thirrja behet nga kryetari ose ne mungese te tij, nga Zevendes Kryetari.

11.2 Kryetari duhet te therrase Keshillin Mbikqyres brenda pesembedhjete ditesh nga kerkesa e motivuar prej te pakten 1/3 (nje te tretes) se anetareve te Keshillit Mbikqyres. Nese kjo kerkese mbetet pa pergjigje, kerkuesi mund te therrase mbledhjen e keshillit, duke percaktuar rendin e saj te dites.

11.3 Thirrja behet te pakten 3 (tre) dite para mbledhjes, me ane te nje letre rekomande, telegrami, teleksi, telefaksi ose e-mail. Thirrja mund te jete e vlefshme edhe kur eshte gojore apo pa ndonje afat kohor nese te gjithe anetaret e Keshillit Mbikqyres do ta pranojne ate.

11.4 Cdo thirrje permban rendin e dites.

11.5 Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne cfaredo vendi tjeter te treguar ne thirrje.

11.6 Procesverbali mbahet nga sekretari dhe nenshkruhet nga ai dhe nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres. Procesverbalet mbahen ne nje rregjister te vecante.

11.7 Keshilli Mbikqyres nuk mund te marre vendime te vlefshme pa pranine e te pakten gjysmes se antareve te tij. Vendimet merren me shumice te

thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne raste votash te barabarta, vota e Kryetarit eshte vendimtare.

Neni 12 – Kompetencat e Keshillit Mbikqyres

12.1 Keshilli Mbikqyres emeron dhe shkarkon Drejtorin, dhe eshte pergjegjes per mbikqyrjen e politikave dhe aktiviteteve te Shoqerise.

12.2 Keshilli Mbikqyres ka pergjegjesine te siguroje qe aktivitetet dhe funksionimi i shoqerise jane ne perputhje me ligjin. Ai rishikon dhe mbikqyre cdo situate aktuale apo te mundshme konflikti interesash dhe ne perputhje me ligjin, merr prej antareve te Drejtorise te gjitha njoftimet e konflikteve aktuale apo te mundshme te interesave qe ata mund te kene me Shoqerine si dhe kontrollon zbatimin e tyre te drejte.

12.3 Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryeje te gjitha verifikimet dhe mbikqyrjet qe i quan te pershtateshme per permbushjen e te gjitha detyrave te tij.

12.4 Keshilli Mbikqyres i paraqet Asamblese se Aksionereve komentet e tij mbi raportin vjetor te nxjerre nga drejtoria ne perputhje me Nenin 130 te Ligjit nr. 7638, date 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e nevojshme.

12.5 Keshilli Mbikqyres kontrollon aktivitetin e Drejtorise, miraton kriteret e marrjes ne pune, vendet e punes dhe shperblimet e punonjesve te shoqerise dhe jep autorizimin per lidhjen e te gjitha marreveshjeve qe kerkojne autorizim ne baze te Ligjit.

KREU VI – ADMINISTRIMI – DREJTORIA – KESHILLI MBIKQYRES – BORDI DREJTUES

Neni 13 – Drejtoria

13.1 Shoqeria drejtohet nga nje Drejtori e perbere nga nje numer prej 1 (nje) Drejtor. Drejtori mund edhe te mos jete aksioner. Drejtori nuk mund te jete anetar i Keshillit Mbikqyres.

13.2 Drejtoret emerohen per nje afat prej 3 (tre) vitesh me te drejte rizgjedhje.

13.3 Drejtori eshte perfaqesues ligjor i Shoqerise. Me akt emerimi drejtor i Shoqerise eshte Z. Aleksander Frangaj.

13.4 Keshilli Mbikqyres cakton masen e shperblimit per Drejtorin ne momentin e emerimit te tij.

13.5 Drejtori mund te shkarkohet nga Keshilli Mbikqyres ne cdo kohe per arsye te perligjura ne baze te ligjit. Nr.7638, dt 19.nentor.1992 » Per Shoqerine Tregetare" neni 98.

13.6 Ne raste se posti i drejtorit mbetet bosh per shkak vdekjeje, doreheqje, shkarkimi, paaftesi ne pune te nje prej anetareve te tij apo cdo shkaku tjeter pasardhesi qe do te plotesoje vendin do te zgjidhet nga Keshilli Mbikqyres ne mbledhjen e pare qe ndjek lenien bosh te vendit. Drejtori i zgjedhur ne kete menyre do te qendroje ne detyre per te gjithe kohen e mbetur te mandatit te paraardhesit te tij.

Neni 14 – Mbledhja e Drejtorise

14.1 Drejtori therret mbledhjen e Drejtorise, nese ajo ekziston, duke percaktuar rendin e dites , ne cdo kohe qe e quan te nevojshme apo ne rast se ai merr nje kerkese me shkrim nga te pakten 1/3 (nje e treta) e anetareve te Drejtorise. Kerkesa duhet te permbaje listen e ceshtjeve apo temave qe duhen diskutuar. Ne raste se Drejtori refuzon te therrase mbledhjen brenda 5 (pese) diteve nga marrja e kerkeses, mbledhja mund te thirret nga kerkuesit. Drejtoria do te thirret me ane te nje letre rekomande, telegrami ose telefaksi, ose e-mail te derguar te pakten 3 (tre) dite para mbledhjes. Ne raste urgjence mbledhja mund te thirret nga telegrami, telefaksi, apo e-mail te derguar nje dite para dites se caktuar te mbledhjes. Ne raste se Drejtori mungon ose per ndonje arsye nuk ka mundesi te marre pjese ne mbledhje, te gjitha funksionet e percaktuara ne kete nen i transferohen Zevendes Drejtorit, nese ka, ose Drejtorit me te vjeter ne detyre. Drejtoria do te mblidhet ne menyre te vlefshme edhe nese nuk eshte bere njoftimi formal i thirrjes, me kusht qe te gjithe Drejtoret te jene te pranishem dhe te informuar mbi rendin e dites qe do te diskutohet.

14.2 Mbledhjet e Drejtorise do te mbahen te pakten nje here ne tre muaj, ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter, ne Shqiperi apo jashte, dhe mund te zhvillohen edhe me telekonference ose videokonference, ose me ane te mjeteve te ngjajshme elektronike, me kusht qe te gjithe pjesemarresit te

identifikohen dhe tu jepet mundesia te ndjekin diskutimet dhe te marrin pjese aktive ne to. Nese ekzistojne keto kushte Drejtoria quhet e mbledhur ne vendin ku ndodhen Drejtori dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te mbajne procesverbalin dhe ti firmosin ato.

14.3 Mbledhjet e Drejtorise quhen te mbledhura ne menyre te vlefshme kur jane te pranishem shumica e Drejtoreve nese ka. Vendimet e Drejtorise jane te vlefshme kur miratohen me voten pro te shumices se antareve te drejtorise te pranishem. Ne rast votash te barabarta, vota e Drejtorit eshte vendimtare.

Neni 15 – Kompetencat e Drejtorise

15.1 Drejtori ka te gjitha kompetencat ne lidhje me administrimin e shoqerise per arritjen e qellimit te Shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji apo Statuti ia rezervon organeve te tjera.

15.2 Drejtori do te jete pergjegjes per pergatitjen dhe ruajtjen e dokumentacionit financiar te duhur ne perputhje me Ligjin. Drejtori duhet t'i paraqes nje raport Keshillit Mbikqyres cdo tre muaj, dhe do te jete pergjegjes per paraqitjen e bilancit vjetor, brenda tre muajve nga data e mbylljes se vitit financiar, me qellim qe te verifikoje dhe kontrolloje ate.

Neni16 – Bordi Drejtues

16.1 Drejtoria mund te emeroje nje Bord Drejtues te cilit mund ti kerkoje mendim, i cili nuk ka fuqi detyruese mbi disa ceshtje te rendesise se vecante ne drejtimin e aktivitetit te Shoqerise.

16.2 Bordi Drejtues do te perbehet nga 7 (shtate) anetare te zgjedhur ndermjet personave me moral dhe prestigj te padiskutueshem. Nuk do te kete mosperputhje midis detyres se anetarit te Bordit Drejtues dhe nje funksioni tjeter ne Shoqeri.

16.3 Anetaret e Bordit Drejtues qendrojne ne detyre per 2 (dy) vjet dhe mund te rizgjidhen.

KREU VII – KONTABILITETI, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR

Neni17 – Ekspertet Kontabel

17.1 Kontrolli kontabel i brendshem i shoqerise kryhet nga dy eksperte kontabel te autorizuar, te emeruar per 1 (nje) vit finciar.

17.2 Eksperte kontabel emerohen nga Asambleja e Zakonshme.

17.3 Ne baze te Nenit 93 te ligjit nr. 7638, date 19 nentor 1992, "Per Shoqerite tregtare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, Eksperte kontabel te pare emerohen:
- Fahri Daria
- Jorgji Bollano

Neni 18 – Viti Financiar – Iventari – Bilanci

18.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

18.2 Drejtoria mban nje rregjister te rregullt te pasurise dhe te aktivitetit te tij ne perputhje me ligjin. Ne fund te vitit financiar, Drejtoria harton dhe bilancin vjetor per ate vit financiar.

Neni 19 – Rezultati i Vitit Financiar dhe Percaktimi i Fitimit.

19.1 Drejtoria harton bilancin vjetor ne perputhje me ligjin. 5% e fitimit neto qe rezulton nga bilanci i miratuar ne baze te dispozitave te Ligjit te mbahet per rezerven kryesore deri sa kjo rezerve te arrije 10% te kapitalit te shoqerise.

19.2 Fitmi i mbetur ose shperndahet ne baze te vendimeve te Asamblese se Aksionereve per shperndarjen e dividenteve apo zerave te tjere.

Neni 20 – Likujdimi dhe Mbyllja

20.1 Shoqeria quhet e mbyllur ne rastet e parashikuara ne Ligj. Ne rast mbyllje, Mbledhja e Jashtezakonshme e Aksionereve emeron nje apo me shume likuidatore, duke u dhene atyre kompetencat perkatese.

20.2 Shoqeria mund gjithashtu te shperndahet apo te bashkohet me nje tjeter me vendim te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Titulli VIII – Dispozita Perfundimtare

Neni 21 – Zgjidhja e mosmarveshjeve

21.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin, zbatimin apo zgjidhjen e ketij Statutit dhe te Aktit te Themelimit te Shoqerise dhe, si edhe ato qe mund te lindin midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet te interesuarve.

21.2 Ne raste se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarrveshjes, ajo mund ti besohet gjykates se Rrethit Tirane.

Julien Roche

Aleksander Frangaj

Marsel Skenda

KERKESE

Per regjistrim si person juridik ne Regjistrin Tregtar

Kerkues Administratori i Shoqerise, z. Aleksander Frangaj

Gjykates se rrethit TIRANE

Une, [illegible] Shoqerise ''MEDIA 6'' sh.p.k., ne baze te ligj.[illegible] nr. [illegible] e 19.11. 1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr. [illegible] e 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet [illegible] respektuar nga shoqerite tregtare", kerkoj nga kjo Gjy[illegible]istrimin e Shoqerise tregtare te emertuar "Media 6" Sh[illegible]

Shoqeria es[illegible]mes me pergjegjesi te kufizuar dhe eshte themeluar n[illegible]: 1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me [illegible] banues ne Lezhe, Lagjja ''Beslidhja'', Pallati 154 [illegible]rnjoftimi NF Nr.138935; 2. Julien Roche, shtetas fra[illegible]dur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne [illegible]venue ''Mozart'', me pasaporte nr.03/07[illegible]3. Marsel Skendo, [illegible]tas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne [illegible]rugen ''Fadil Rada'', Pallati 11, Ap.17, Tirane, me pasaporte nr [illegible]65026

Emertimi i shoqerise eshte "MEDIA 6" Sh.p.k.

Selia e Shoqerise eshte ne Rrugen ''Myslym Shyri'' N.8/1, Tirane.

Kohezgjata e veprimtarise se Shoqerise eshte 10 vjet.

Shoqeria do te kryeje veprimtari botuese revistash, gazetash, librash, tregetim te tyre, ne menyre te vecante duke filluar me botimin e revistes se emertuar KLAN, import-eksport mallrash e materialesh qe i sherbejne aktivitetit prodhues, shperndares e tregetues te botimeve te mesiperme, aktivitet ne fushen e mediave elektronike ne baze te dispozitave ligjore qe do te rregullojne

Kapitali themel[illegible] i shoqerise eshte 100000leke(njeqindmije) dhe eshte nensh[illegible]rregullisht nga ortaket prane nje noteri. Kapitali es[illegible]re ne 100 pjese te barabarta, me vlere nominale 1[illegible]ije)leke secila. Kontributet e te tre ortakeve n[illegible]in themeltar jane perkatesisht: Ortaku J.Roche 25 [illegible]Ortaku M.Skendo 25 pjese ndersa ortaku A.Frangaj 5[illegible]

Meqenese ort[illegible]elues kane respektuar te gjitha kerkesat e ligjit per [illegible]e shoqerise, une si administrator i saj kerkoj nga [illegible]ate regjistrimin e shoqerise si person juridik ne [illegible] Tregtar.

Me respekt,

Administratori i Shoqerise

Aleksander Frangaj

(72)

16941/1
568

zaj: Anila Capo.
28.03.2000

28 MAR. 2000

REPUBLIKA E SHQIPERISE

K E R K E S E

KERKUES: Shoqeria "MEDIA 6" Sh.p.k

Objekti: Kerkohet pasqyrimi ne rregjistrin tregtar i shteses se objektit te aktivitetit te Shoqerise dhe reflektimit te kesaj shtese ne nenin perkates te Statutit.

Per kompetence:

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Me vendimin Nr. 16941, date 12.02.1997 te Gjykates se Rrethit te Tiranes, Shoqeria "MEDIA 6" Sh.p.k eshte rregjistruar si person juridik me:

- Ortake: Aleksander FRANGAJ, Marsel SKENDO, Julien ROCHE
- Kapital themeltar: 100.000 Lek;
- Kohezgjatje e shoqerise: 10 vjet;
- Adminstrator: Zt. Aleksander FRANGAJ;
- elia: Tirane, Rr. "Myslym SHYRI",N.8/1

Co dhe prop. fallul
31.03.2000

Meqenese:

Me date 21.03. 2000 u mbajt Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "MEDIA 6" Sh.p.k ku u vendos: Shtesa e objektit te aktivitetit te Shoqerise me aktivitetin:"Prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografisedhe reflektimi i ketsaj shtese ne nenin perkates te Statutit te Shoqerise.

Kerkohet:

Te pasqyrohet sa me siper ne Rregjistrin Tregtar.

ADMINISTRATORI
Aleksander FRANGAJ

④

zyj: Altina Xhoxhaj
29.03.2000

16941/2

29 MAR 2000

PULLE TAKSE

KERKESE

KËRKUES: **Shoqëria Media 6 sh.p.k.** e përfaqësuar nga adminstratori i saj Z. Aleksandër Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues në Tiranë, me nr. letërnjoftimi NF 138935 madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar

OBJEKTI: Depozitimin e dokumentave për ndryshimin e formës së shoqërisë "Media 6" Shpk. dhe caktimin e ekspertit kontabël të autorizuar në bazë të ligjit 7638 datë 28/11/1992 "PER SHOQERITE TREGETARE", ligjit 7667 "Për rregjistrin tregetar" si dhe ligjit nr 8410 datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë"

për kompetencë

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

Shoqëria "Media 6" Shpk është rregjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tirane me nr. 16941, datë 12 Shkurt 1997. Administrator i kësaj shoqërie është Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 10 vjet dhe objekti i veprimtarisë është fusha e mediave. Ortakët e shoqërisë së mësipërme janë:

- Julien Roche zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Marsel Skende zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Aleksandër Frangaj zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Në datën 03.2000 u mbajt Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Media 6" Shpk. Në këtë mbledhje ishin prezentë të tre ortakët e kësaj shoqërie. Mbedhja u zhvillua nën drejtimin e Z. Aleksandër Frangaj. Aleksandër Frangaj pasi konstatoi pjesëmarrjen e të gjithë ortakëve të shoqërisë e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat kanë marrë më parë njoftim ortakët.

Pikat e parashikuara në rendin e ditës ishin:

1. Ndryshimi i formës së shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime;
2. Paraqitja e kërkesës pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar për të vlerësuar pasurinë e kësaj shoqërie që përbën dhe aktivin e saj;
3. Të tjera.

(14)

16 941/3

Zj. A. Xhoxhaj
04/5 MAG. 2000

PUBLIKA SHQIPËRISË
GJYKATËS SE RRETHIT TIRANË
NOTERE TIRANË
LEKË
R.SHQIPËRI

KERKESE

KËRKUES: **Shoqëria Media 6 sh.p.k.** e përfaqësuar nga adminstratori i saj Z. Aleksandër Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues në Tiranë, me nr. letërnjoftimi NF 138935 madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar përfaqësuar me prokurë prej Av. Erinda Ballanca

OBJEKTI: Depozitimin e vendimit të Asamblesë së ortakëve datë 2.5.2000.

për kompetencë

Te depozitoret me
10. 5. 2000

GJYKATËS SE RRETHIT
TIRANE

Shoqëria "Media 6" Shpk është rregjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tirane me nr. 16941, datë 12 Shkurt 1997. Administrator i kësaj shoqërie është Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 10 vjet dhe objekti i veprimtarisë është fusha e mediave. Ortakët e shoqërisë së mësipërme janë:

- Julien Roche zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Marsel Skende zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Aleksandër Frangaj zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Me **vendim të gjyqtarit të vetëm Altina Xhoxhaj, nr. 16941/2, datë 5.4.2000**, është miratuar emërimi i ekspertit për kontributet Z. Ilirjan Hoxha. Më datë 2.5.2000 mbajtur asambleja e ortakëve të shoqërisë me pjesëmarrejn e të tërë ortakëve në të cilën është diskutuar rendi i ditës si më poshtë::

1 Miratimi i shdërrimit të formës së shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime;
2 Miratimin e raportit të ekspertit për kontributet;
3. Rritjen e kapitalit dhe emetimin e aksioneve te reja;
4. Miratimin e statutit të ri të shoqërisë.caktuar eksperti për

Pas një diskutimi të hollësishëm të pikave të rendit të ditës, Asambleja me unanimitet ka vendosur:

1. Shdërrimin e shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ën shoqëri Anonime;
2. Rritjen e kapitalit në 12,000,000 dymbëdhjetë milionë lekë duke i shtuar kapitalit aktual prej 100,000 shumën prej 11,900,000 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqindmijë) lekë;

3. Emetimi i 11,9000 aksionev e të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila të cilat u nënshkruan prej ortakeve dhe si rezultat i blerjes së aksioneve të reja ndryshoi dhe struktura e ortakërisë si më poshtë:

Z. Julien Roche do të nëshkruajë 3975 aksione me një vlerë prej 3,975,000 lekë;
Z. Marsel Skende do të nëshkruajë 3975 aksione me një vlerë prej 3,975,000 lekë;
Z. Aleksander Frangaj do te nenshkruaje 3950 aksione me nje vlere prej 3,950,000 lekë.

4. Miratimi i statutit të ri të shoqërisë.mas marrejs së vendime të mësipërme shoqëia ngarkoi Z. Frangaj të kryente të tëra porcedurat e nevojshme.

Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakoshme të Ortakëve të shoqërisë Media 6 sh.p.k. datë 2.5.2000, raportin e ekspertit për kontributet, prokurën në favor të E. Ballanca, dhe statutin e ri të shoqërisë.

KËRKUES

Media 6 Sh.A..
Përfaqësuar m prokurë prej Erlinda Ballanca

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 3213..... Rep.

VËRTETIM

Sot më datë 27.03.1999, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Liri Gjoliku, u paraqit personalisht Znj. Erinda Ballanca, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, më 29.10.1973, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e përfaqësues me prokurë prej Z. A. Frangaj. e cila më deklaoi se këtë kërkesë e ka hartuar jashtë zyrës së noterisë, por me vullnetin e tij të lirë, kërkesë të cilën e nënshkroi para meje dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE
NOTERE
LIRI GJOLIKU
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
LIRI GJOLIKU
NOTERE
TIRANË

Media 6, Rr Dervish Hima, Nr 1, Tel:+355 4 251923/4/5 Fax:+355 4 251926,

Tirane me, 13 Dhjetor 2005

KERKESE

Drejtuar: Gjykates se Rrethit Tirane

Te nderuar Zoterinj,

Lutemi te na sigurohet marrja e nje kopje te praktikes se depozitimit ne regjistrin tregtar te:

1. Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te Shoqerise "Media 6" Sh.p.k date 25.04.2000,
2. Aktin e Ekspertimit te Z. Ilirian Hoxha per rritjen e kapitalit dhe
3. Statuti i ndryshuar i Shoqerise

Vendimi per regjistrimin e kesaj praktike eshte marre me date 10.05.2000 nga gjyqtarja Altina Xhoxhaj me Nr. 16941/3 dhe eshte urdheruar zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet me Nr. Rendor 2 ne kollonen 4, 5.

Ju faleminderit,

Aleksander FRANGAJ
Drejtor i Pergjithshem

SHOQERIA ANONIME MEDIA 6 ALBANIA

Media 6, Rr Dervish Hima, Nr 1, Tel:+355 4 251923/4/5 Fax:+355 4 251926,

Tirane me, 16 Dhjetor 2005

KERKESE

Drejtuar: **Gjykates se Rrethit Tirane**
Zyres se Regjistrit Tregtar

Te nderuar Zoterinj,

Lutemi te beni te mundur terheqjen nga ana jone te nje kopje te praktikes se Shoqerise "Media 6" prane Regjistrit tuaj.

Nr. i regjistrimit eshte: 16941

Ju faleminderit,

Aleksander FRANGAJ
Drejtor i Pergjithshem

SHOQËRIA ANONIME MEDIA 6 TIRANË ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 1496 REP.
NR. 435 KOL.

V E R T E T I M

Sot, me date 11 shkurt 1997, para meje noteres Mimoza Sadushi u paraqit personalisht z.Aleksander Frangaj Sot, me date shkurt 1997, para meje noteres Mimoza Sadushi u paraqit personalisht Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja ''Beslidhja'', Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935;'', i cili si administrator i sapoemeruar i Shoqerise ''MEDIA 6'' sh.p.k. me deklaroi se kete kerkese per tiu drejtuar gjykates e hartoi ne perputhje me kompetencat qe i jep ligji ''Per Shoqerite Tregtare''. Pasi u binda per identitetin e tij nepermjet verifikimit te dokumenteve personale te identifikimit, vertetoj nenshkrimin e tij ne perputhje me kerkesat e ligjit.

N O T E R E

MIMOZA SADUSHI
NOTERE
Adresa: Pallatet e Lanes, 1
Tel & Fax - 355 42 23866
TIRANE - ALBANIA

PULLE TAKSE

16941/4

(15)

KËRKESË

KËRKUES: **Shoqëria Media 6 Sh.A.** e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm i saj Z. Aleksandër Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues në Tiranë, me nr. letërnjoftimi NF 138935 madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

OBJEKTI: Depozitimin e vendimeve të Asamblesë së Aksionerëve të datave 23.5.2000 dhe 31.5.2000.

për kompétencë

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

Shoqëria "Media 6" Sh.A. është rregjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tirane me nr. 16941, datë 12 Shkurt 1997. Ajo e ka shndërruar fromën e saj nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime me vendim të gjyqtarit të vetëm datë 16941/3 datë 20.5.2000. Drejtor i përgjithshëm është Z. Frangaj, aktiviteti i saj është në fushën e mediave televizive dhe ka në kohëzgjatje prej 40 vjet. Kapitali i shoqërisë është 12,000,000 lekë dhe zotërohet në mënyrë të barabartë prej Julien Roche, Marsel Skënde, dhe Aleksandër Frangaj me nga 1/3 secili.

Më datë 23.5.2000 është zhvilluar asambleja e jashtëzakonshme e aksionerëve të shoqërisë me këtë rend dite:

1. Rritja e kapitalit te shoqerise mbi bazen e investimeve dhe kontributeve të bëra nga të tre aksionerët.
2. Caktimi nga ana e aksionereve të ekspertit për kontributet Z. Ilirjan Hoxha për vlerësimin e kapitalit të shoqërisë, të vlerës së rritur të tij dhe përqindjen e kontributit te secilit aksioner në këtë kapital.

Në mbledhje merrnin pjesë të tre aksionerët dhe në të me unanimet u vendos:

1. të rritet kapitali i shoqërisë duke përfshirë në të të tëra pajisjet dhe makineritë televizive të blera në kuadrin e fushatës së investimeve;
2. të caktojnë ekspertin Ilirjan Hoxha i cili është ekspert kontabël i autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë të aksionerëve, duke i caktuar si detyra sa më poshtë:
   - Përgatitja e raportit përkatës ku të jetë përcaktuar sa është vlera e kapitalit të rritur të shoqërisë;
   - Caktimi i kontributit të secilit aksioner në kapitalin e shoqërisë;

Më datë 31.5.2000 është zhvilluar një mbledhje tjetër e asamblesë së aksioenerëve të shoqërisë me këtë rend dite:

1. Miratim i raportit të ekspertit për rritjen e kapitalit të shoqërisë dhe përcaktimi i kontributit të secilit aksioner në këtë kapital;

2. Emetimi i aksioneve të reja, nënshkrimi dhe pagimi i tyre;
3. Ndryshimi i paragrafit të parë të nenit 5 të Statutit të Shoqërisë i cili bën fjalë për kapitalin e shoqërisë;

Në mbledhjen e asamblesë merrnin pjesë të tre aksionerët dhe në të me unanimitet u vendos:

1. Miratimi i ekspertit për kontributet dhe rritja e kapitalit nga 12,000,000 lek në 180,000,000 (njëqind e tetëdhjetëmilionë) lekë.
2. Emetimin e 168,000 (njëqindegjashtëdhjetëetetëmijë) aksioneve të reja të cilat u nënshkruan nga aksionerët si më poshtë:
   - Z. Julien Roche nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë;
   - Z. Marsel Skënde nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë;
   - Z. Aleksandër Frangaj nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë
3. Ndryshimin e paragrafit të parë të nenit 5 të Statutit si më poshtë vijon:

"5.1. Kapitalit themeltar i Shoqërisë është caktuar 180,000,000 (njëqind e tetëdhjetëmilionë) lekë i ndarë në 180,000 (njëqindetetëdhjetëmijë) aksione nominative dhe të regjistruara me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lek secila. Kapitali i Shoqërisë formohet nga kontributet mëposhtme në para dhe në natyrë të Aksionerëve Themelues:

a. Z. Julien Roche, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek;
b. Z. Marsel Skënde, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek;
c. Z. Aleksandër Frangaj, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek."

Pas marrjes së vendime të mësipërme asambleja ngarkoi Z. Frangaj të kryente të tëra porcedurat e nevojshme për depozitimin e vendimeve pra zyrës së Rehgjistrit të Shoqërive Tregtare.

Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakoshme të Aksionerëve të shoqërisë datë 23.5.2000, vendimin e asamblesë së aksionerëve datë 31.5.2000 dhe raportin e ekspertit për kontributet.

KËRKUES

Aleksandër Frangaj

Republika e Shqipërisë
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 3727..... Rep.

VËRTETIM

Sot më datë 1.6.2000, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Liri Gjoliku, u paraqit personalisht Z. Aleksandër Frangaj, qytetar shqiptar, lindur në Lezhë, më 4.10.1968, me Pas. Nr. 0011396Tiranë, më 29.10.1973, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë "Media 6" Sh.A. i cili më deklaroi se këtë kërkesë e ka hartuar jashtë zyrës së noterisë, por me vullnetin e tij të lirë, kërkesë të cilën e nënshkroi para meje dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE
Liri Gjoliku

Z. M. Doçja
06.07.2006
06 KORRIK 2006

16941/5

KËRKESË

GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË
SEKSIONIT TREGTAR

KËRKUESI: Shoqëria Media 6 sh.a, person juridik i regjistruar me vendimin nr.16941, me date12.2.1997, e përfaqësuar nga Z. Aleksander Frangaj në cilësinë e Drejtorit të shoqërisë;

OBJEKTI: Depozitimi ne Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate, të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë Anonime Media 6 Sh.A si dhe të Kontratave të transferimit të Aksioneve.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar" dhe Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare"

Shoqeria Media 6 sh.a eshte nje shoqeri anonime e rregjistruar si person juridik me vendim nr.16941, datë 12.2.1997. Me pas jane bere nje sre ndryshimesh ne aktet e shoqerise.

Me date11.05.2006, u mbajt Asambleja e Jashtëzakonshme e Shoqërisë Media 6 sh.a në selinë e shoqërisë e ku ka qënë të pranishëm të gjithë aksionerët që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë:

- Z. Aleksandër Frangaj zotërues i 1/3 të kapitalit aksioner të shoqërisë;
- Z. Marsel Skëndo zotërues i 1/3 të kapitalit aksioner të shoqërisë;
- Z. Julien Roche zotërues i 1/3 të kapitalit aksioner të shoqërisë.

Gjithashtu në mbledhjen e Asamblesë ishin ftuar si të pranishëm Znj. Alba Gina dhe Z. Ervin Gjikola.

Asambleja e aksionereve vendosi me unanimitet si më poshtë vijon:

1. Miratimi i transferimit të aksioneve që aksioneri Z. Marsel Skëndaj zotëron në kapitalin e shoqërisë Media 6 Sh.A tek personat e mëposhtëm:

   - Z. Aleksandër Frangaj, 6,000 (gjashtë mijë) aksione;
   - Znj. Alba Gina, 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) aksione;
   - Z. Ervin Gjikola, 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) aksione.

2. Miratimi i transferimit të aksioneve që aksioneri Z. Julien Roche zotëron në kapitalin e shoqërisë Media 6 Sh.A tek personat e mëposhtëm

   - Z. Aleksandër Frangaj, 6000 (gjashtë mijë) aksione;
   - Znj. Alba Gina, 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) aksione;
   - Z. Ervin Gjikola, 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) aksione.

Si rrjedhojë e transferimeve të mësipërme në Statut përbërja e kapitalit të Shoqërisë do të rezultojë si më poshtë:

- Aksioner Aleksandër Frangaj, zotërues i 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) aksioneve te barabarta me 40% te asksioneve te shoqerise;
- Aksioner i ri Znj. Alba Gina zotërues i 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) aksione te barabarta me 40% te aksioneve te shoqerise;
- Aksioner i ri Z. Ervin Gjikola, zoterues i 36.000 (tridhjete e gjashtë mijë) aksioneve, te barabarta me 20% te aksioneve te shoqerise.

Në vijim u lidhën të gjitha kontratat e transferimit të aksioneve.

Meqënëse Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Z. Marsel Skëndo dhe Z. Julien Roche kanë dhënë dorëheqjen, personat e mëposhtëm emërohen anëtarë të Këshillit Mbikqyrës me një mandat 3 vjecar:

- Znj. Alba Gina, e bija e Agimit dhe Afërditës, lindur më 14.4.1977, në Lushnjë, banuese në Tiranë, rr. Dervish Hima, nr. 1, pas. nr. Z1019362;
- Z. Sotiraq Bicka, i biri i Kocos, lindur më 31.1.1973, në Korcë, banues në Tiranë, rr. Rreshat Petrela, pall. 12 kate pranë arkivës së shtetit, pas. nr. 0012178;
- Z. Pal Toma, i biri i Prendit, lindur më 5.4.1959, në Kallmet, Lezhë, banues në Tiranë, Rr. Komuna e Parisit, nr. 77, pas. nr 324543.

Keshilli mbikqyres mne mbledhjen e tij te pare morri vendimin per emerimin ne cilesine e kryetares se keshillit mbikqyres Z. Alba Gina.

Duke qene se vendimet e mesiperme duhet te regjistrohen ne regjistrin tregtar te gjykates e Shkalles se Pare Tirane, ne baze të Nenit 19 të Ligjit Nr. 77632, datë 4.11.1992, "Per Pjesen e Pare te Kodit Tregtar dhe neni 33 i Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", i kërkojmë Gjykatës së Rrethit Tiranë të depozitoje në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate dokumetat si më poshtë vijon:

1. Vendimi i Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë Anonime Media 6 Sh.A datë 11.5.2006
2. Kontratë për Transferimin e Aksioneve ndërmjet Z. Marsel Skëndo dhe Z. Aleksandër Frangaj, më datë 11.05.2006, të vërtetuar rregullisht nga noteri.
3. Kontratë për Transferimin e Aksioneve ndërmjet Z. Marsel Skëndo dhe Znj. Alba Gina, më datë 11.05.2006, të vërtetuar rregullisht nga noteri.
4. Kontratë për Transferimin e Aksioneve ndërmjet Z. Marsel Skëndo dhe Z. Ervin Gjikola, më datë 11.05.2006, të vërtetuar rregullisht nga noteri.
5. Kontratë për Transferimin e Aksioneve ndërmjet Z. Julien Roche dhe Z. Aleksandër Frangaj, të vërtetuar rregullisht nga noteri.
6. Kontratë për Transferimin e Aksioneve ndërmjet Z. Julien Roche dhe Znj Alba Gina, me datë 11.05.2006, të vërtetuar rregullisht nga noteri.
7. Kontratë për Transferimin e Aksioneve ndërmjet Z. Julien Roche dhe Z. Ervin Gjikola, të vërtetuar rregullisht nga noteri.
8. Vendimin e keshillit mbikqyres per emerimin e Znj. Alba Gina ne cilesine e kryetares se Keshillit Mbikqyres.

MEDIA 6 SH.A
Aleksander Frangaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr. 1609 **Rep.**
Nr. _____ **Kol.**

PULLE TAKSE 100 LEKE

VËRTETIM

Sot, më datë 13.6.2006, në Zyrën e Noterisë, Tiranë, para meje Noteres Lindita Lleshi u paraqit personalisht:

Z. Aleksander Frangaj, i biri i Vasilit dhe Gjystes, lindur ne Lezhe me 04.10.1968, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, kati 9, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. 0013708, i cili paraqitet në cilësinë e drejtorit te shoqerise Media 6 sh.a.;

i njohur personalsiht prej meje, identitetin e të cilit e kam te verifikuar nga pasaporta e tij si me lart, i cili me deklaroi se kerkesen e mesipeme e ka hartuar jashte zyres se noteres, me vullnet te lire, kerkese te cilen e nënshkruan përpara meje noteres, dhe unë e vërtetoj atë sipas kërkesave të ligjit.

NOTERE

Lindit Lleshi

Dyer se Re. Regjistri
Te thirrur Shtyn Rejit
19.12.2006

GJYKATA ... Tiranë
NR. 7289 Prot.
Date 19/12/2006

REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA
E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

V E N D I M

PËR MARRJEN E DOKUMENTAVE

Në Tiranë, më 18.12.2006

Unë Olsian Çela, prokuror, pasi studiova aktet e procedimit penal nr.4372 te vitit 2006

K O N S T A T O V A

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr.4372 për veprat penale të "korrupsionit aktiv" dhe "korrupsionit pasiv" të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të gjyqtarit të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/a të Kodit Penal, "dhënia e një vendimi të padrejtë" e parashikuar nga neni 315 i Kodit Penal, "shpërdorimi i detyrës" i parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Për nevoja të hetimit, është e nevojshme të merret në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një kopje e të gjithë dokumentacionit që lidhet me regjistrimin e shoqërisë tregtare "Ora" sh.p.k si dhe vendime të tjera të gjyqtares, e cila ka marrë këtë vendim, për çështje të tjera të ngjashme. Gjithashtu është e nevojshme të merret një kopje e dokumentacionit që disponohet në këtë gjykatë mbi regjistrimin e personit juridik Tv Klan dhe të gjitha lëvizjet në ortakërinë dhe kapitalin e këtij subjekti deri në momentin aktual.

Për këto arsye, në mbeshtetje të nenit 191 të Kodit të Procedurës Penale

V E N D O S A

1-marrjen e kopjeve të dokumentave të cituara më sipër në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga oficerët e policisë gjyqësore Kledian Llaho dhe Ervin Brahaj të cilët të mbajnë edhe procesverbalin përkatës.
2-kopjet e dokumentave të njësohen me vulën e organit që i disponon.
3-kopja e vendimit t'u komunikohet të interesuarve.

16941
Media 6 dite.

PROKURORI

OLSIAN ÇELA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

PROCESVERBAL

PER MARRJEN E DOKUMENTAVE

Ne Tirane , viti 2006, muaji Dhjetor, dt 19.

Une **Kledian LLAHO**, me detyre Oficer i Policise Gjyqesore, pasi u njoha me vendimin e Prokurorit Olsian Çela date 18/12/2006 "Per marrjen e dokumentave" si dhe ne mbeshtetje te neneve 191 pikat 1 dhe 3, dhe 303.2/e te K.Pr.Penale, mbaj kete procesverbal per te dokumentuar marrjen e dokumentave ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane te dokumentacionit qe lidhet me regjistrimin e shoqerise tregetare "Ora" sh.p.k , vendime te tjera te gjyqtares e cila ka marre kete vendim per çeshtje te ngjashme si dhe nje kopje e dokumentacionit te regjistrimit si person juridik i Tv Klan dhe te gjitha levizjet ne ortakerine dhe kapitalin e ketij subjekti deri ne momentin aktual.

Konkretisht ,pasi iu dorezua nje kopje e vendimit personave pergjegjes ne zyren e regjistrit tregetar ne Gjykaten e rrethit gjyqesor Tirane, proçedohet me marrjen e dokumentave si me poshte ;

1- Kërkesë ga "ORA" sh.p.k përfaqësuar ga Enrinda F. Ballanca datë 23.11.2006 (jë fletë).
2- Vërtetim i notere Meri Çela datë 22.11.2006 nr 2791 rep. (jë fletë)
3- Mandat i kapitalit Themeltar nr serie 0177430 në emri të shoqërisë "ORA" sh.p.k. (jë fletë)
4- Akt themelimi i shoqërisë "ORA" sh.p.k datë 22.11.2006 (dy fletë)

5- Vërtetim i noteres Meri çela datë 22-11-2006 nr 2755 r.
dhe nr 619 kol. (jë fletë).

6- Statuti i shoqërisë "ORA" sh.p.k datë 22-11-2006 nën sh
ja ortak i vetëm Ilda Prifti. (4 fletë)

7- Vërtetim i noteres Meri çela datë 22-11-2006 nr 2794 r
dhe nr 618 kol. (jë fletë).

8- Vendim për regjistrimin e pusonit gjuridik nr 36652 datë
01-12-2006 i gjyqtares Enkela Bajo. (dy faqe). - - -

9- Praktikë e regjistrimit të shoqërisë "Elidon-06" sh.p.k për
gëzuar ja shtetasi Rexhep Dauti si ortak i vetëm. Vendi
për regjistrimin e kisoj shoqërie mban numrin 36662 dhe
datë 01/12/2006; Eshtë marë ja gjyqtare Enkela Bajo. Kjo
praktikë përmban 11(njembëdhjetë) fletë.

10- Praktika e regjistrimit të shoqërisë "JERRY L.T.D" sh.p.k
përfaqësuar ja Osman Xheni si ortak i vetëm. Vendimi p
regjistrimin e kisoj shoqërie mban numrin 36666 dhe datë
04/12/2006; eshtë marë ja gjyqtare Enkela Bajo. Kjo
praktikë përmban 17(shtatëmbëdhjetë) fletë.

11- Praktika e regjistrimit si hashku me ndryshimet përhatëse
ri kohë të shoqërisë "Media 6"; Vendimi për regjistri-
min e kisoj shoqërie mban numrin 16941 datë
12.02.1997 dhe eshtë marë ja gjyqtare Marjana Dedi.
Kjo praktikë përmban 153(njegintepesëdhjetetre) fletë. - - -

Mbyellet me nr 11(njembëdhjetë).
Procesverbali pasi lexohet, gjendet i mjaftë, dhe
firmoset pa vërejtje.

Për Zyrën e Regjistrit Tregëtar

Besa Marsecc

OF.POL. GJYQ.

Kladian ZLAHO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. REP.
NR. 2 . KOL.

AKT DEPOZITIMI

Une, Mimoza Sadushi, notere e dhomes se Notereve Tirane, me ane te ketij akti vertetoj se ortaku dhe Administratori themelues i shoqerise ne formim e siper "MEDIA 6" sh.p.k. , z. Aleksander Frangaj, depozitoi ne emer te ortakeve te saj prane zyres sime shumen 100000(njeqindmije) leke si kapital themeltar per krijimin e shoqerise.

Ky depozitim u be ne perputhje me nenin 40 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

NOTERE

MIMOZA S...
NOTERE
sa: Pallatet e Lanës, 1
e Fax - - 355 42 23966
TIRANË : ALBANIA

SHOQERIA TREGTARE
"MEDIA 6" SH.P.K

PROCEC VERBAL I MBLEDHJES SE JAZHTEZAKONSHME TE ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot, me date 21.03. 2000 u mbajt Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "MEDIA 6" Sh.p.k me kete rend dite:

1. Shtese ne objektin e aktivitetit te Shoqerise;
2. Te ndryshme.

****

Ortaku dhe Admisitratori i shoqerise Z. Aleksander Frangaj konstatoi se ne kete mbledhje perfaqesohet i tere kapitali social i shoqerise dhe deklaroi mbledhjen te thirur ne menyre te vlefshme e te rregullt duke parashtruar:

1. Propozimin per te shtuar ne objektin e aktivitetit te Shoqerise: "Prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografise"

Pas nje diskutimi te hollesishem te rendit te dites me votim te tere kapitalit social u vendos:

TE APROVOHET:

Shtesa e objektit te aktivitetit te Shoqerise:"Prodhim dhe distribuim filmi ne fushen e kinematografise"

2. Propozimin per reflektimin e kesaj shtese ne nenin perkates te Statutit te Shoqerise.

Pas nje diskutimi te hollesishem te rendit te dites me votim te tere kapitalit social u vendos:

TE APROVOHET:

Reflektimi i shteses se aprovuar, ne piken 1 te rendit te dites, ne nenin perkates te Statutit te Shoqerise.

Duke mos patur diskutime te tjera mbledhja u mbyll rregullisht.

ORTAKET

Aleksander FRANGAJ **Marsel SKENDO** **Julien ROCHE**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr..1184....Rep
Nr...319.....Kol

VERTETIM

Sot me date 24.03.2000 u paraqiten perpara meje Noterese se Dhomes se Notereve Tirane, ..Rnko Soko...., ***1. Z. Aleksander Frangaj***, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Tirane, Shqiperi, me Nr. Pasaporte:NF 138935, ***2. Z. Julien Roche*** shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2.07.1954, banues ne Avenue "Mozart", Paris, France, me pasaporte Nr. 03/97 dhe ***3. Z. Marsel Skendo,*** shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6.11.1949, banues ne Rr. " Fadil Rada", Pallati 11, Ap. 11,Tirane, me pasaporte Nr. 0165026, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakeve dhe te Shoqerise "Media 6" Sh.p.k te cilet me deklaruan se sa mesiper eshte nje vendim e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, date 21.03.2000, redaktuar jashte kesaj zyre, te cilen ata e firmosin rregullisht e me vullnet te lire dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

RNKO SAKO
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE

PULLE TAKSE
100 LEKE
RISHQIPERISE

1. NDRYSHIMI I FORMËS SË SHOQËRISË NGA SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NË SHOQËRI ANONIME;

Z. Aleksandër Frangaj vuri në dijeni ortakët e tjerë se me daljen e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë". Shoqëria "Media 6" e cila ka si objekt të saj të veprimtarisë ekskluzivisht atë të mediave duhej të ndryshonte formën e saj në bazë të kërkesave të nenit 20 të këtij ligji. Pra kjo shoqëri duhej të ndryshonte formën e saj nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.

Pas një diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimitet kanë vendosur:

Ndryshimin e formës së shoqërisë "Media 6" nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.

2 PARAQITJA E KËRKESËS PRANË GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË PËR CAKTIMIN E NJË EKSPERTI KONTABËL TË AUTORIZUAR PËR TË VLERËSUAR PASURINË E MEDIA 6 SH.P.K.

Z. Frangaj morri fjalën dhe u shpjegoi ortakëve se në bazë të nenit 77 të ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqëritë tregetare" kur një shoqëri e një forme tjetër shndërrohet në shoqëri anonime me kërkesë të drejtuesve të kësaj shoqërie i kërkohet gjykatës caktimi i një eksperti kontabël të autorizuar i cili do të vlerësojë nën përgjegjësinë e tij, pasurinë e kësaj shoqërie e cila do të përbëjë edhe aktivin e saj. Për këtë arsye pas një diskutimi të shkurtër ortakën në mënyrë unanime kanë vendosur:

"Ti drejtohen gjykatës me kërkesë për caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar i cili do të përgatisë raportin përkates për gjendjen e shoqërisë pasurinë e saj, dhe kontributin e ortakeve në këtë shoqëri, pas rritjes së kapitalit, duke respektuar kërkesat e nenit 168, 169 të ligjit "Për shoqëritë tregetare".

Pas marrjes së vendimeve të mësipërme ortakët vendosën që të bëhet depozitimi i ketij vendimi dhe i kërkesës pranë Zyrës së Regjistrit Tregtar. Për këto arsye në bazë të kompetencave që më janë ngarkuar nga Asambleja e Ortakëve dhe ligji i kërkoj Gjykatës së Rrethit Tiranë të depozitohet vendimi i mësipër dhe të caktohet eksperti kontabël.

Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakoshme të Ortakëve të shoqërisë Media 6 sh.p.k. datë ...03.2000.

KËRKUES

Media 6 sh.p.k.
Përfaqësuar prej Aleksandër Frangaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 1689 Rep.

VËRTETIM

Sot më datë 27.03.1999, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Liri Gjoliku, u paraqit personalisht Z. Alksandër Frangaj, qytetar shqiptar, lindur në Lezhë, më 4.10.1968, me Pas. Nr. AF.138825., madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova pasi verifikova dokumentin përkatës të indentifikimit në cilësinë e administratorit të shoqërisë Media 6 sh.p.k. i cili më deklaoi se këtë kërkesë e ka hartuar jashtë zyrës së noterisë, por me vullnetin e tij të lirë, kërkesë të cilën e nënshkroi para meje dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE

NOTERE
LIRI GJOLIKU
TIRANË

PULLE TAKSE

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE I SHOQERISE "MEDIA 6" SHPK

Sot më datë 28.03.2000 u mblodh në Tiranë, në Rr. Dervish Hima, ADA Tower, kati i dytë, asambleja e ortakëve të Shoqërisë "Media 6" sh.p.k.

"Media 6" Shpk është rregjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tirane me nr. 16941 date 12.Shkurt 1997. Administrator i kësaj shoqërie është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 10 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave. Ortakët e shoqërisë së mësipërme janë:

- Julien Roche zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Marsel Skende zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Aleksandër Frangaj zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Mer drejtimin e mbledhjes Z. Aleksandër Frangaj i cili konstaton se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë dhe e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat kanë marre me parë njoftim ortakët:

1. Ndryshimi i formës së shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime;
2. Paraqitja e kërkesës pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar për të vlerësuar pasurinë e kësaj shoqërie që përbën dhe aktivin e saj.
3. Të tjera.

1. NDRYSHIMI I FORMËS SË SHOQËRISË NGA SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NË SHOQËRI ANONIME;

Z. Aleksander Frangaj vuri në dijeni ortakët e tjerë se me daljen e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë". Shoqëria "Media 6" e cila ka si objekt të saj të veprimtarisë ekskluzivisht atë të mediave duhej të ndryshonte formën e saj në bazë të kërkesave të nenit 20 të këtij ligji. Pra kjo shoqëri duhej të ndryshonte formën e saj nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.

Pas një diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimitet vendosën:

Ndryshimin e formës së shoqërisë "Media 6" nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.

2 PARAQITJA E KËRKESËS PRANË GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË PËR CAKTIMIN E NJË EKSPERTI KONTABËL TË AUTORIZUAR PËR TË VLERËSUAR PASURINË E MEDIA 6 SH.P.K.

Z. Frangaj morri fjalën dhe u shpjegoi ortakëve se në bazë të nenit 77 të ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqëritë tregetare" kur një shoqëri e një forme tjetër shndërrohet në shoqëri anonime me kërkesë të drejtuesve të kësaj shoqërie i kërkohet gjykatës caktimi i një eksperti kontabël të autorizuar i cili do të vlerësojë nën përgjegjësinë e tij, pasurinë e kësaj shoqërie e cila do të përbëjë edhe aktivin e saj. Për këtë arsye pas një diskutimi të shkurtër ortakën në mënyrë unanime vendosën:

Ti drejtohen gjykatës me kërkesë për caktimin e Z. Ilirjana Hoxha në cilësinë eksperti kontabël i cili do të përgatisë raportin përkatës për gjendjen e shoqërisë pasurinë e saj, dhe kontributin e ortakeve në këtë shoqëri, për rritjes së kapitalit, duke respektuar kërkesat e nenit 168, 169 të ligjit "Për shoqëritë tregetare".

Pas marrjes së vendimeve të mësipërme ortakët ranë dakort që të bëhet depozitimi i këtij vendimi pranë Zyrës së Rregjistrit Tregetar.

Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, mbledhja u mbyll.

ORTAKËT

Julien Roche

Marsel Skëndo

Aleksandër Frangaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. ...1733... Rep.
Nr. ..... Kol

VËRTETIM

Sot më datë 30.03.1999, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Liri Gjoliku, u paraqit personalisht Z. Aleksandër Frangaj, qytetar shqiptar, lindur në Lezhë, më 4.10.1968, me Pas. Nr. 0011396, Z. Marsel Skëndo, qytetar shqiptar, lindur në Tepelenë, më 06.11.1999, Pas. Nr. 0165026, dhe Z. Julien Roche, qytetar francez, lindur në Bour En Bresse, më 1954 Pas. Nr. 91AE75972, në cilësinë e tyre si ortakë të Shoqërisë Media 6 sh.p.k., të tre madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova pasi verifikova dokumentat përkatës të indentifikimit të cilët më deklaruan se sa më sipër është vendimi i asamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë dhe ata e kanë nënshkruar atë me vullnein e tij të lirë, para meje dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE
LIRI GJOLIKU
TIRANE

KONSULENCE JURIDIKE

KONTABEL I MIRATUAR

Ilirjan HOXHA Address: Private - Q.Studenti, God.13, Tirane Office - Rr. "Mine Peza" Nr.84/1, Tirane Tel. +355 42 74871

REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJOLIKU NOTERE TIRANË

RAPORT

MBI

VLERESIMIN E KAPITALIT DHE RITJEN E TIJ

Une , Ilirjan Hoxha, "Kontabel i Miratuar", me nr. 599 license, i caktuar ekspert per vleresimin kontabel te kapitalit dhe percaktimin e shteses se tij, qe do te behet ne shoqerine "MEDIA 6" sh.p.k., ne vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "MEDIA 6" sh.p.k. te dates 28.03.2000, paraqes si me poshte :

Nga shqyrtimi i bilancit te vitit 1998 dhe bilancit te vitit 1999, miratuar nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise dhe zyra e tatimeve e taksave dega Tirane, si dhe nga raporti i Ekspertit te Autorizuar, rezulton :

1. Shoqeria "MEDIA 6" sh.p.k. sipas vendimit nr.16941, date 12.02.1997 te gjykates se rrethit Tirane, ka nje kapital prej 100'000 leke i ndare :

Julien ROCHE	25 %	ose	25 kuota	ose	25'000 leke
Marsel SKENDAJ	25 %	ose	25 kuota	ose	25'000 leke
Aleksander FRANGAJ	50 %	ose	50 kuota	ose	50'000 leke
T o t a l i	100 %	ose	100 kuota	ose	100'000 leke

Pervec kesaj, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se ne fund te vitit 1999 shoqeria ka nje fitim prej 710'937 leke (te vitit ushtrimor dhe te mbartur), rezerve ligjore prej 10'000 leke, si dhe nje detyrim ndaj ortakeve prej 11'634'157 leke., detyrim qe konsiston ne investimet e kryera ne shoqeri nga ortaket.

Ne kushtet e transformimit te shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime, Asamblea e shoqerise "MEDIA 6" sh.p.k. duhet te beje **shtese** kapitali **jo me pak** se 1'900'000 leke dhe **jo me shume** se 12'355'094 leke

Pra ne total kemi nje kapital **jo me pak** se 2'000'000 leke dhe **jo me shume** se 12'455'094 leke, qe ne kushtet e transformimit ne sh.a., do te jete i ndare ne aksione me vlere nominale prej 1000 leke sejcili, duke emetuar keshtu **jo me pak** se 2'000 aksione dhe **jo me shume** se 12'355 aksione. Shtesa do te perballohet (shlyhet) nepermjet

a. kapitalizimit te fitimit te vitit te kaluar dhe atij ushtrimor, si dhe rezerves ligjore, ne total per 720'937 leke.
b. pakesimit te detyrimeve te shoqerise ndaj ortakeve per minimale 1'179'063 leke deri per maksimale 11'634'157 leke.

Nisur nga kufizimet ligjore, mundesite praktike dhe idete e shprehura prej ortakeve po japim disa variante te sasise se aksioneve te emetuara dhe % te posedimit te tyre :

1. Varianti minimal

Julien ROCHE	33 %	ose	660 aksione	ose	660'000 leke
Marsel SKENDAJ	33 %	ose	660 aksione	ose	660'000 leke
Aleksander FRANGAJ	34 %	ose	680 aksione	ose	680'000 leke

T o t a l i	100 % ose	2'000 aksione ose	2'000'000 leke

ne kete variant paksimi i detyrimeve te shoqerise ndaj ortakeve do te jete per 1'179'063 leke.

2. Varianti optimal

Julien ROCHE	33 % ose	1'650 aksione ose	1'650'000 leke
Marsel SKENDAJ	33 % ose	1'650 aksione ose	1'650'000 leke
Aleksander FRANGAJ	34 % ose	1'700 aksione ose	1'700'000 leke
T o t a l i	100 % ose	5'000 aksione ose	5'000'000 leke

ne kete variant pakesimi i detyrimeve te shoqerise ndaj ortakeve do te jete per 4'179'063 leke.

3. Varianti maksimal

Julien ROCHE	33 % ose	4'110 aksione ose	4'110'000 leke
Marsel SKENDAJ	33 % ose	4'110 aksione ose	4'110'000 leke
Aleksander FRANGAJ	34 % ose	4'235 aksione ose	4'235'000 leke
T o t a l i	100 % ose	12'455 aksione ose	12'455'000 leke

ne kete variant pakesimi i detyrimeve te shoqerise ndaj ortakeve do te jete per 11'634'157 leke.

Per sa i perket % e posedimit te aksioneve pas shteses te kapitalit, te shprehura me siper, eshte sugjerim nga ana e ime, pasi ato jane kopetence e vete Asamblese se Aksionereve.

Struktura e aktiveve do te jete e njejte me ate te paraqitur ne bilancin e vitit 1999, ndersa sruktura e pasiveve do te pesoje ndryshimet sipas variantit te shteses se kapitalit qe do te preferohet nga aksioneret (ortaket),

- pra rezerva ligjore per 10'000 leke si dhe fitimi i dy viteve ('98 , '99) per 710'937 leke me vendim te aksionereve do te kaloje ne kapital per shlyerjen e aksioneve te emetuara
- detyrimi ndaj ortakeve do te pakesohet per nje nga tre variantet e paraqitura ose cilido variant qe mund te kene aksioneret, duke bere te mundur shlyerjen e pjeses tjeter te aksioneve te emetuara.

Baze vendimit te aksionereve do te kryhen dhe veprimet kontabile perkatese.

EKSPERTI

Ilirjan HOXHA

Tirane me _____ 2000

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. REP.

VERTETIM

Sot me date 28.04. 2000, para meje noterit publik Lirl Gjoliku, me seli ne _____, u paraqit personalisht z. ILIRJAN HOXHA, i biri i Aqifit, i dtl. 1965, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane, i njohur prej meje, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me deklaroi se sa me siper e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan regullisht para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI PUBLIK

PULLE TAKSE

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE I SHOQËRISË "MEDIA 6" SHPK

Sot më datë 25.04.2000 u mblodh në Tiranë, në Rr. Dervish Hima, ADA Tower, kati i dytë, asambleja e ortakëve të Shoqërisë "Media 6" sh.p.k.

"Media 6" Shpk është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane me nr. 16941 date 12 Shkurt 1997. Administrator i kësaj shoqërie është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 10 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave. Ortakët e shoqërisë së mësipërme janë:

- Julien Roche zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Marsel Skëndaj zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Aleksandër Frangaj zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Merr drejtimin e mbledhjes Z. Aleksandër Frangaj i cili konstaton se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë dhe e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat kanë marre me parë njoftim ortakët:

1. Deklarimin e shdërrimit të formës së Shoqërisë;
2. Miratim i raportit të ekspertit për kontributet në shoqëri për shdërrimin e saj nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime;
3. Emetimi i aksioneve të reja, nënshkrimi dhe pagimi i tyre
4. Diskutimi dhe miratimi i statutit të ri të shoqërisë;

1. DEKLARIMI I SHDËRRIMIT TË FORMËS SË SHOQËRISË

Z. Aleksanndër Frangaj deklaroi se sic edhe ishin ne dijeni ortakët me daljen e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë". Shoqëria "Media 6" e cila ka si objekt të saj të veprimtarisë ekskluzivisht atë të mediave duhej të ndryshonte formën e saj në bazë të kërkesave të nenit 20 të këtij ligji. Në bazë të vendimit të asamblesë së datës 28.3.2000 ishte vendosur edhe eksperti per kontributet në shoqëri. Ai u kërkoi ortakëve të deklaronin shdërrimin e shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.

2. MIRATIM I RAPORTIT TË EKSPERTIT PËR KONTRIBUTET NË SHOQËRI PËR SHDËRRIMIN E SAJ NGA SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NË SHOQËRI ANONIME;

Z. Aleksander Frangaj vuri në dijeni ortakët e tjerë se në vijim të mbledhjes së asamblesë së ortakëve datë 28.3.2000 shoqëria ka proceduar me fazën e parë të shdërrimit të saj në shoqëri anonime. Me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, datë 5.4.2000 nr. 16941/2 është miratuar caktimi i ekspertit për kontributet. Në vijim eksperti ka përpiluar dhe

depozituar pranë shoqërisë aktin e ekspertimit i cili i është vënë në dispozicion të pranishmëve në asamble që në datën 21.04.2000. Në këtë raport eksperti ka paraqitur tre variante për transformimin në shoqëri anonime dhe rritjen e kapitalit të shoqërisë: variantin minimal, atë optimal dhe atë maksimal. Z. Frangaj vuri në dijeni se eksperti ka përcaktuarin kufirin minimal dhe maksimal dhe se është në të drejtën e ortakëve të caktojnë breda këtyre kufijve se sa do të jetë kapitali i shoqërisë.

Pas një diskutimi të hollësishëm të pranishmit me unanimitet vendosën:

Rritjen e kapitalit të shoqërisë në 12,000,000 dymbëdhjetë milionë lekë duke i shtuar kapitalit aktual prej 100,000 shumën prej 11,900,000 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqindmijë) lekë.

3. EMETIMI I AKSIONEVE TË REJA, NËNSHKRIMI DHE PAGIMI I TYRE.

Z. Frangaj i propozoi Asamblesë që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 11,9000 aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila dhe i ftoi ata të deklaronin numrin e aksioneve që do të nënshkuanin paguanin secili.

Pas në diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimet vendosën që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 11,9000 aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila. Dhe deklaruan se do të nënshkruanin përkatësisht këto aksione:

Z. Julien Roche do të nëshkruajë 3975 aksione me një vlerë prej 3,975,000 lekë;
Z. Marsel Skënde do të nëshkruajë 3975 aksione me një vlerë prej 3,975,000 lekë;
Z. Aleksander Frangaj do te nenshkruaje 3950 aksione me nje vlere prej 3,950,000 lekë.

Pagesa e aksioneve u be menjehere duke ulur proporcionalisht detyrimet e shoqërisë ndaj otakeve dhe më hollësisht:
Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Julien Roche u ulën me 3,975,000 lekë;
Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Marsel Skendaj u ulën me 3,975,000 lekë;
Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Aleksandër Frangaj u ulën me 3,950,000 lekë.

Që nga ky moment struktura e shoqërisë është si më poshtë

- Julien Roche zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë);
- Marsel Skëndaj zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë);
- Aleksandër Frangaj zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë).

4. DISKUTIMI DHE MIRATIMI I STATUTIT TË RI TË SHOQËRISË

Z. Frangaj shpjegoi se për shkak të ndryshimit të formës së shoqërisë duhej të kryeshin një sërë ndryshimesh në statutin e saj për pa bërë atë konform me ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqëritë tregetare"dhe ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për Radion dhe televizionin në Republikën e Shqipërisë. Kështu duhej të ndryshoheshin objekti, kapitali, oganet drejtuese, mënyra e funksionimit dhe marrjes së vendimeve të shoqërisë, si dhe kontrolli ekonomik i saj. Për këtë arsye është hartuar një version i statutit të shoqërisë në të cilin janë pasqyruar të tëra ndryshimet e kërkuara nga ligji dhe propozime të tjera të ortakëve. Variantin përfundimtar të statutit Z. Frangaj e lexoi me zë të lartë në asamble.

Pas një diskutimi të hollësishëm dhe të gjatë ortakët vendosën me unanimitet miratimin e statutit të ri të shoqërisë në formën që i bashkëngjitet këtij dokumenti. Z Frangaj u ngarkua të kryente të tëra procedurat e nevojshme pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për shdërrimin e formës së shoqërisë dhe depozitimin e statutit të ri.

Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, mbledhja u mbyll.

ORTAKËT

Julien Roche	Marsel Skëndaj	Aleksandër Frangaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 336 ..... Rep.
Nr. ..... Kol

VËRTETIM

Sot më datë 08/08/2000, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Liri Gjoliku, u paraqit personalisht Z. Aleksandër Frangaj, qytetar shqiptar, lindur në Lezhë, më 4.10.1968, me Pas. Nr. 0011396, Z. Marsel Skëndaj, qytetar shqiptar, lindur në Tepelenë, më 06.11.1999, Pas. Nr. 0165026, dhe Z. Julien Roche, qytetar francez, lindur në Bour En Bresse, më 1954 Pas. Nr. 91AE75972, në cilësinë e tyre si ortakë të Shoqërisë Media 6 sh.p.k., të tre madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova pasi verifikova dokumentat përkatës të indentifikimit të cilët më deklaruan se sa më sipër është vendimi i asamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë dhe ata e kanë nënshkruar atë me vullnein e tij të lirë, para meje dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE

Liri Gjoliku

VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE AKSIONEREVE TË SHOQERISË

"MEDIA 6" SH.A.

Sot më datë 25.5.2000 u mblodh në Tiranë, në Rr. Dervish Hima, ADA Tower, kati i dytë, asambleja e jashtëzakonshme e aksionereve të Shoqërisë "Media 6" Sh.A.

"Media 6" Sh.A. është rregjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tiranë me nr. 16941 datë 12 Shkurt 1997. Drejtor i shoqërisë është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 40 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave televizive. Shoqëria ka si aksionerë tre persona të cilët zotërojnë aksionet si më poshtë:

- Julien Roche zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë;
- Marsel Skëndaj zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë;
- Aleksandër Frangaj zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë

Drejtimi e mbledhjes e mori Z. Aleksandër Frangaj i cili konstaton se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë aksioneret e shoqërisë dhe e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat aksioneret kanë marre me parë dijeni :

1. Rritja e kapitalit te shoqerise mbi bazen e investimeve dhe kontributeve të bëra nga të tre ortaket.

2 Caktimi nga ana e aksionereve të ekspertit për kontributet Z. Ilirjan Hoxha për vlerësimin e kapitalit të shoqërisë, të vlerës së rritur të tij dhe përqindjen e kontributit te secilit ortak në këtë kapital.

1 RRITJA E KAPITALIT TE SHOQERISE

Z. Frangaj i parashtroi Asamblesë ne baze te vendimit te fundit te Gjyqtarit te vetem me nr. 16941 date 10.5.2000 se kapitali i kësaj shoqërie rezulton 12,000,000 dymbëdhjetë milionë lekë i vënë në mënyrë të barabartë nga të tre aksionerët. Në vijim të tre aksionerët kanë bërë investime të mëtejshme dhe kanë kontribuar për të shtuar dhe përmirësuar gjendjen teknike dhe pajisjet e telvizionit. Në këto kushte ai i propozon Asamblesë të përfshihen edhe këto kontribute të shoqërisë në kapitalin e saj.

Pas një diskutimi të hollësishëm, Asambleja me unanimitet vendosi:

Të rrisë kapitalin e shoqërisë duke përfshirë në të të tëra pajisjet dhe makineritë televizive të blera.

2 CAKTIMI I EKSPERTIT PËR KONTRIBUTET

Duke qenë se për vlerësimin e këtij kapitali është e domosdoshme caktimi i një eksperti për kontributet, aksionerët në mënyrë unanime vendosin dhe janë dakort që të caktojnë ekspertin Ilirjan Hoxha i cili është ekspert kontabël i autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë të ortakëve, duke i caktuar si detyra sa më poshtë:

a. Përgatitja e raportit përkatës ku të jetë përcaktuar sa është vlera e kapitalit të rritur të shoqërisë;
b. Caktimi i kontributit të secilit ortak në kapitalin e shoqërisë;

Aksioneret vendosën t'i vënë në dispozicion ekspertit të gjithë dokumentacionin ekonomik të domosdoshëm për të përcaktuar vlerën e kontributeve në natyrë.

Pas marrjes së vendimeve të mësipërme ortakët ranë dakort që të bëhet depozitimi i këtij vendimi pranë Zyrës së Rregjistrit të Shoqërive Tregtare.

Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, mbledhja u mbyll.

AKSIONERET

Julien Roche

Marsel Skëndo

Aleksandër Frangaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. ...364.... Rep.
Nr. ..... Kol

VËRTETIM

Sot më datë 25.05.2000, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Liri Gjoliku, u paraqit personalisht Z. Aleksandër Frangaj, qytetar shqiptar, lindur në Lezhë, më 4.10.1968, me Pas. Nr. 0011396, Z. Marsel Skëndo, qytetar shqiptar, lindur në Tepelenë, më 06.11.1999, Pas. Nr. 0165026, dhe Z. Julien Roche, qytetar francez, lindur në Bour En Bresse, më 1954 Pas. Nr. 91AE75972, në cilësinë e tyre si aksionere të Shoqërisë Media 6 sh.a të tre madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova pasi verifikova dokumentat përkatës të indentifikimit të cilët më deklaruan se sa më sipër është vendimi i asamblesë së jashtëzakonshme të aksionereve dhe ata e kanë nënshkruar atë me vullnetin e tij të lirë, para meje dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE
LIRI GJOLIKU
TIRANË
100 LEKE
R.SHQIPERISE

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE I SHOQËRISË "MEDIA 6" SHPK

Sot më datë 31.5.2000 u mblodh në Tiranë, në Rr. Dervish Hima, ADA Tower, kati i dytë, asambleja e jashtëzakonshme e aksionereve të Shoqërisë "Media 6" Sh.A.

"Media 6" Sh.A. është rregjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tiranë me nr. 16941 datë 12 Shkurt 1997. Drejtor i shoqërisë është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 40 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave televizive. Shoqëria ka si aksionerë tre persona të cilët zotërojnë aksionet si më poshtë:

- Julien Roche zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë;
- Marsel Skëndaj zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë;
- Aleksandër Frangaj zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë.

Drejtimi e mbledhjes e mori Z. Aleksandër Frangaj i cili konstaton se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë aksioneret e shoqërisë dhe e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat aksioneret kanë marre me parë dijeni.

1 Miratim i raportit të ekspertit për rritjen e kapitalit te shoqerise dhe percaktimi i kontributit te seciliit ortak ne kete kapital;
2. Emetimi i aksioneve të reja, nënshkrimi dhe pagimi i tyre;
3. Ndryshimi i paragrafit të parë të nenit 5 të Statutit të Shoqëisë i cili ben fjale per kapitalin e shoqerise;

1 MIRATIM I RAPORTIT TË EKSPERTIT PËR RRITJEN E KAPITALIT TË SHOQËRISË NËPËRMJET KONTRIBUTEVE NË NATYRË

Z. Aleksander Frangaj vuri në dijeni ortakët e tjerë se në vijim të mbledhjes së Asamblesë së Jashtezakonshme te Aksionereve datë 25.05.2000 eksperti i caktuar nga aksioneret Z. Ilirjan Hoxha ka përgatitur dhe ka vënë në dispozicion aktin e ekspertimit në të cilin ka përcaktuar vlerën e kapitalit të rritur si dhe kontributin e secilit ortak në këtë kapital. Ky akt u është bërë i njohur aksionereve disa ditë më parë. Z. Frangaj fton aksionistët të diskutojnë dhe shprehin mendimin e tyre në lidhje me raportin e ekspertit dhe vlerën në të cilën do të rritet kapitali.

Pas një diskutimi të hollësishëm, Aksionerët me unanimitet vendosën:
Miratimin e raportit të ekspertit për kontributet dhe rritjen e kapitalit nga 12,000,000 lek në 180,000,000 (njëqind e tetëdhjetëmilionë) lekë.

3. EMETIMI I AKSIONEVE TË REJA, NËNSHKRIMI DHE PAGIMI I TYRE.

Z. Frangaj i propozoi Asamblesë që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 168,000 (njëqindegjashtëdhjetëetetë mijë) aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila dhe i ftoi ata të deklaronin dhe nënshkuanin secili numrin aksionve qe u takonin te paguara prej tyre .

Pas në diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimet vendosën që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 168,000 (njëqingjashtëdhjetëmijë) aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila. Dhe deklaruan se nënshkruanin përkatësisht këto aksione:

- Z. Julien Roche nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë;
- Z. Marsel Skënde nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë;
- Z. Aleksandër Frangaj nënshkruan 56,000 (tridhjetëegjashtëmijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtëmilionë) lekë.

Aksionet u nënshkruhet dhe u kontribuan në natyrë nga aksioneret

Që nga ky moment struktura e shoqërisë është si më poshtë

- Julien Roche zotëron 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) lekë;
- Marsel Skëndaj zotëron 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë)) lekë;
- Aleksandër Frangaj zotëron 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) lekë.

3 NDRYSHIMI I PARAGRAFIT TË PARË TË NENIT 5 TE STATUTIT

Aksioneret vendosin ne menyre unanime ndryshimin e paragrafit të parë të nenit 5 të Statutit si më poshtë vijon:

"5.1. Kapitalit themeltar i Shoqërisë është caktuar 180,000,000 (njëqind e tetëdhejtëmilionë) lekë i ndarë në 180,000 (njëqindetetëdhjetëmijë) aksione nominative dhe të regjistruara me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lek secila. Kapitali i Shoqërisë formohet nga kontributet mëposhtme në para dhe në natyrë të Ortakëve Themelues:

a. Z. Julien Roche, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek;
b. Z. Marsel Skënde, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek;

c. *Z. Aleksandër Frangaj, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetëmijë) aksione, të 60,000,000 (gjashtëdhjetëmilionë) Lek."*

Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, mbledhja u mbyll.

Aksioneret vendosen depozitimin e këtij vendimi në Zyrën e Rregjistrit të Shoqërive Tregtare.

AKSIONERET

Julien Roche | Marsel Skëndaj | Aleksandër Frangaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. ..376.5.... Rep.
Nr. ..... Kol

VËRTETIM

Sot më datë 31/05/2000, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Liri Gjoliku, u paraqit personalisht Z. Aleksandër Frangaj, qytetar shqiptar, lindur në Lezhë, më 4.10.1968, me Pas. Nr. 0011396, Z. Marsel Skëndaj, qytetar shqiptar, lindur në Tepelenë, më 06.11.1999, Pas. Nr. 0165026, dhe Z. Julien Roche, qytetar francez, lindur në Bour En Bresse, më 1954 Pas. Nr. 91AE75972, në cilësinë e tyre si ortakë të Shoqërisë Media 6 sh.p.k., të tre madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova pasi verifikova dokumentat përkatës të indentifikimit të cilët më deklaruan se sa më sipër është vendimi i asamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë dhe ata e kanë nënshkruar atë me vullnein e tij të lirë, para meje dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE

Liri Gjoliku

PULLE TAKSE
100 LEKE

KONSULENCE JURIDIKE KONTABEL I MIRATUAR

Ilirjan HOXHA Address: Private - , Rr. "Bodi", Kodra e Shen Pjetrit, nr 2, Tirane
Office - Rr. "Mine Peza" Nr.84/1, Tirane Tel. +355 42 74871

RAPORT

MBI

VLERESIMIN E KAPITALIT DHE RITJEN E TIJ

Une , Ilirjan Hoxha, "Kontabel i Miratuar", me nr. 599 license, i caktuar ekspert, per vleresimin kontabel te shteses se kapitalit qe do te behet ne shoqerine "MEDIA 6" sh.a., ne vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise "MEDIA 6" sh.a. nr. —, date 25.5.2000, paraqes si me poshte :

Nga bilanci i vitit 1999, miratuar nga Asambleja dhe zyra e tatimeve e taksave dega Tirane, si dhe nga raporti i Ekspertit te Autorizuar se shoqeria "MEDIA 6" sh.a. ka pase nje kapital 100'000 leke.

Me pas me vendim te Asablese te Aksionereve dhe miratim te gjykates me vendimin nr.16941/3, eshte bere shtese kapitali duke e cuar kete te fundit ne 12'455'000 leke leke ndare :

1. Julien ROCHE	33,33 %	ose	4'000 aksione	ose	4'000'000 leke
2. Marsel SKENDAJ	33,34 %	ose	4'000 aksione	ose	4'000'000 leke
3. Aleksander FRANGAJ	33,33 %	ose	4'000 aksione	ose	4'000'000 leke
Totali	100 %	ose	12'000 aksione	ose	12'000'000 leke

Ne kushtet kur shoqeria ka kryer investime te medha dhe se eshte e domosdoshme pasqyrimi i tyre ne kapital, e jo si nje detyrim ndaj ortakeve ose te treteve, aksioneret kane vendosur te kryejne shtesen e kapitalit.

Ne baze te faturave te paraqitura nga shoqeria ,eshte perpiluar nje pasqyre permbledhese e tyre nga ana ime (bashkelidhur aktit) , nga ku rezulton nje kapital i perbere teresisht nga pajisje ne vlefte totale 1'224'250 USD ose i konvertuar ne leke me kursin e kembimit ne datat e faturave ne vlefte 171'616'013 leke.

Meqenese kapitali eshte teresisht pajisje llogaritja e amortizimit baze pikes 3.7.2/c dhe 3.7.2/d te udhezimit nr.3, date 13.04.2000 "Per tatimin mbi te ardhurat" te Ministrise se Financave, llogaritja e amortizimit te tyre eshte bere ne grup dhe me norme amortizimi vjetor 25 % ne vit.

Keshtu qe kapitali qe do te shtohet ka nje vlere kontabile 168'040'679 leke.

Vlera nominale e aksioneve nuk ndryshon por shtohet numri i tyre. Ortaket bejne shlyerjen e aksioneve sipas % :

1. Julien ROCHE	33.33 %	ose	56'000 aksione	ose	56'000'000 leke
2. Marsel SKENDAJ	33.34 %	ose	56'000 aksione	ose	56'000'000 leke
3. Aleksander FRANGAJ	33.33 %	ose	56'000 aksione	ose	56'000'000 leke
T o t a l i	100 %	ose	168'000 aksione	ose	168'00'000 leke

Pra perfundimisht kapitali i shoqerise do te jete 12'000'000 leke + 168'000'000 leke = 180'000'000 leke i ndare ne aksione me vlefte nominale 1'000 leke/aksioni qe i perket :

1. Julien ROCHE	33,33 %	ose	60'000 aksione	ose	60'000'000 leke

2. Marsel SKENDAJ	33,34 %	ose	60'000 aksione	ose	60'000'000 leke
3. Aleksander FRANGAJ	33,33 %	ose	60'000 aksione	ose	60'000'000 leke
T o t a l i	100 %	ose	180'000 aksione	ose	180'000'000 leke

Per sa i perket % e posedimit te aksioneve pas shteses se kapitalit, te shprehura me siper, eshte sugjerim nga ana e ime, pasi ato jane kopetence e vete Asamblese se Aksionereve.

E K S P E R T I

Ilirjan HOXHA

Tirane me 30. 5 .2000

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 3693 **REP.**
V E R T E T I M

Sot me date 30. 5 2000, para meje noterit publik Ilir Gjoliku, me seli ne TIRANE, u paraqit personalisht z. ILIRJAN HOXHA, i biri i Aqifit, i dtl. 1965, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane, i njohur prej meje, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me deklaroi se sa me siper e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan regullisht para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

N O T E R I P U B L I K

PULLE TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE GJOLIKU NOTERE TIRANE

ILIR GJOLIKU
TIRANE



ADA AIR

ADA TOWER
TIRANA, ALBANIA
tel +355 42 56111 fax +355 42 26245

Invoice No. 03 / extra 28.01.00

INVOICE

Customer

Name TV KLAN
Address ADA TOWER, Rr.Dervish Hima
City TIRANA State ALBANIA
Phone

Date 28/01/00
Order No.
Rep
FOB

Qty	Description	Unit Price	TOTAL
1	**Shitje paisjesh televizive sipas listes bashkengjitur:**	$ 1,107,750	$ 1,107,750

TOTAL $ 1,107,750

DEPARTAMENTI I FINANCES

ADA HOLDING (ADA AIR)
ADA TOWER, DERVISH HIMA
TIRANA, ALBANIA

PAISJE TE BLERA NGA ADA AIR

STUDIO QENDRORE	SASIA	VLERA NE USD
1. Kamera studio SONY DXC D 30PK	cope 1	30,000
2. Kamera studio SONY DXC 3000 AP	cope 3	45,000
3. Stativa per kamera studio me rrota	cope 4	7,000
4. Monitore kontrolli	cope 3	400
5. Shperndares audio video SONY SRP 200DA	cope 2	600
6. Video projektor SHARP XV-Z1U	cope 1	8,000

REGJIA QENDRORE	
1. Mixer video transmetimi 8 hyrje Grass Valley grou	10,000
2. Mixer audio Mackie 16 x 8	6,000
3. 8 monitor kontrolli 14" Sony.	4,000
4. Magnetoscope Betacam SP Player PVW-2600 P	18,000
5. Magnetoscope Betacam SP Player PVW-2600 P	18,000
6. Magnetoscope Betacam SP Recorder UVW 1400 P	8,000
7. Magnetoscope SVHS recorder SVO 5800 P	5,000
8. 5 shperndares audio video SONY SRP 200 DA	1,500
9. Sincro gjenerator TEKTRONIX SPG 271	3,000
10. 5 televizore kontrolli 14" Sharp.	2,000
11. Televizor kontrolli sinjal Dajti 14" Hitachi.	400
12. 2 monitor 20" Sony.	2,000
13. 1 CD player Sony.	400
14. 1 Cassette Deck Teach.	350
15. 2 marres satelitor Digital Nokia.	2,000
16. 1 marres satelitor Canal Satelit.	1,000
17. 1 marres satelitor Stream.	1,000
18. 1 Oshilograf + vectroscope tektronix 528A.	3,000
19. Matrix 8x8.	2,000
20. Remonte control camera 3 cope.	6,000
21. Interfonia = 1 pale kufje me mikrofon.	4,000
22. Frame synchronizer KM -F150.	3,500
23. SVITCHER TLS Broadcast	2,500
24. Video Typeriter For A VTW - 600.	2,000
25. Logo generator KLAN, ELCA GT6.	2,500
26. Logo generator 4 logo emisionesh, ELCA GT6	2,500
27. Video time generator VT2.	2,500
28. PC (Vectra+Monitor Hp+Karte grafike & **Audio-Video+Matrox Marvell)**	3,500
29. Mikrofone Sony electretcondeser ECM-77B, 4 cope	2,000
30. Mikrofone monacorecm -3005, 3 cope.	1,500
31. Mikrofone SHURE SMI, cope 1.	700
32. Mikrofone SENNHEISER dore dynamic - 1 cope.	800

ADA HOLDING (ADA AIR)
ADA TOWER, DERVISH HIMA
TIRANA, ALBANIA

STUDIO LEVIZESE PER TRANSMETIME TELEVIZIVE DIREKTE DHE REGJISTRIME (MOBILVAN)

1	Mixer video transmetimi WJ-MX 50		5,000
2	Mixer audio Spirit LX7 16 x 4		4,000
3	Magnetoscope Betacam SP UVW 1800P		9,000
4	Monitore SONY 10" cope 8 PVM 9040 ME		18,000
5	Monitore SONY 14" cope 3 PVM 14N5E		6,000
6	Oshilograf + Vektorscope EV 4061		3,000
7	Shperndares audio video SONY SRP - 200 DA,	cope 12	3,600
8	Kamera SONY Betacam SP UVW	cope 1	20,000
9	Kamera SONY Betacam SP PVW	cope 1	30,000
10	Kamera SONY Betacam SP BVW	cope 1	35,000
11	Kamera SONY digital DV	cope 1	3,000
12	Procesor zeri LEXICON MPX 100		2,000
13	Kompresor limiter dbx 166XL		2,500
14	CD Player Sherwood DDCD 9600		1,000
15	Kasete deck SONY TC-WE 725		500
16	Kompjuter Vectra, karte grafike Matrox mystique G200 + Karte video FPS60		6,000
17	Interfonia e komunikimit me kameramanet ne distance CONFORD AUDIO MS 731		7,000
18	Altoparlante DAS CN 1918,	cope 2	1,000
19	Altoparlante SONY SMS - 1P,	cope 1	1,200
20	Minidisc Sharp MD-R14		700
21	Switcher ELCA CS8S,	cope 2	2,000
22	Titolatriçe Panasonic WJ-K850E		1,500
23	Mikrofona SHURE me kondesator	6 cope	2,400
24	Mikrofona SONY dinamik F-720/2,	5 cope	2,000
25	Mikrofon NAUMAN dinamik 487A P48		2,000
26	Mikrofon me transmetues TOPTECH VHM-3093		1,000
27	Mikrofona me transmetues SENHAIZER B2T A120 210F,	cope 2	2,000
28	Mikrofon SENHAIZER dinamik PROFIL POWER		900
29	Mikrofon SENHAIZER MICH-416 P48		2,500
30	Mikrofon Philips me kondesator SBC-ME-400		1,700
31	Mikrofona SHURE me transmetues 111- 3R,	cope 2	1,200
32	Mikrofona ROJTEC me transmetues MX-03	cope 3	1,500
33	Stativa mikrofoni	19 cope	1,900
34	Televizor SONY KV-14T1D		500
35	Stabilizator tensioni REKSAN 10KW		10,000
36	Kondicioner HUNDAY		1,000
37	Transformator ndares 10KV		5,000
38	Radiorele dhenese portabel		10,000
39	Kablo video dhe audio 50 deri ne 150 meter per 6 kamera dhe 16 mikrofona njeheresh		15,000
40	Pajisje dhe vegla per riparim difektesh		5,000

ADA HOLDING (ADA AIR
ADA TOWER, BERVISH HIM
TIRANA, ALBANIA

STUDIO MONTAZHI BETACAM SP Nr 1

1. Magnetoskop beta Recorder PVW - 2800 P	23,000
2. Magnetoskop Beta Player PVW - 2650 P	20,000
3. Magnetoskop Beta Player PVW - 2650 P	20,000
4. Magnetoskop SVHS Player SVP - 5600 P	5,000
5. Kontroll Elektronik i montazhit 1 cope Sony	10,000
6. Programues montazhi BVE 900	7,000
7. I 2 cope.	1,500
8. Oshilograf Tektronix 528 A	3,000
9. Vectorscope 1421 Pal	2,500
10.Monitor i elektronikut	700
11.Mixer figure WJ-MX 50 Panasonic.	6,000
12.Titolatriçe VTW-240 P + monitor kontrolli.	3,000
13.Audio mixer 8 channel MXP - 29	6,000
14.CD player CDP-XE 800.	800
15.Cassete deck TC-WE 725	600
16.Autopariant SMS-1P	700
20. Remont kontroll figure UNIT BVR-50P cope 2	5,000

STUDIO MONTAZHI BETACAM SP Nr.2

1. Magnetoscope Beta recorder PVW - 2800 P	23,000
2. Magnetoscope Beta Player PVW - 2600 P.	18,000
3. Magnetoscope SVHS Player SVP - 5600 P.	5,000
4. Programues montazhi RM - 450 CE.	4,000
5. Mixer video FXE 100P	8,000
6. CD Player DV - 560	800
7. Mixer audio Spirit Folio Fader 100	5,000
8. Oshilograf EV 4061.	3,000
9. Monitor.	500
10.Autoparlant SMS - 1P	400
11.Titolatriçe VTW -240P + monitor	2,000

Lista e transmetuesve

1. Dajti	1000W	KANALI 28	50000
2.Gllava	500W	KANALI 22	35000
3.Sopoti	500W	KANALI 25	35000
4.Taraboshi (Shkoder)	250W	KANALI 27	25000
5.Zvernec (Vlora)	250W	KANALI 32	25000
6.Preze	250W	KANALI 22	25000
7.Korca	150W	KANALI 32	18000
8.Çicavice (Kosove)	150W	KANALI 32	18000

ADA HOLDING (ADA AIR
ADA TOWER, DERVISH HI
TIRANA, ALBANIA

Lista e perseritesave televizive aktualisht ne transmetim

1. Prishtine	250W	KANALI 29	20,000
2. Petresh (Elbasan)	150W	KANALI 25	18,000
3. Gjirokaster (Kerculle)	150W	KANALI 34	18,000
4. Lushnje	50W	KANALI 54	10,000
5. Skrapar	50W	KANALI 27	10,000
6. Permet	25W	KANALI 34	8,000
7. Libohova	25W	KANALI 48	8,000
8. Ballaban	10W	KANALI E6 i Bashkise	

Lista e radioreleve

1. Tirane - Dajt	8400 MHz	15,000
2. Tirane - Dajt	2100 MHz	13,000
3. Dajt - Çervenake	1400 MHZ	13,000
4. Çervenake - Korce	1650 MHz	13,000
5. Dajt - Gllave	2460 MHz	13,000
6. Gllave - Zvernec	2100 MHz	13,000
7. Tirane - Preze	1850 MHz	13,000
8. Tirane - Kruje	2350 MHZ	13,000
9. Kruje - Tarabosh	1820 MHz	13,000
10. Tarabosh - Mide	2550 MHZ	13,000
11. Mide - Çicavec	1300 MHz	18,000
12. Teater - Klan	1280 MHz	10,000

GRAND TOTAL **1,107,750 USD**

ADA HOLDING (ADA AIR)
ADA TOWER, DERVISH HIMA
TIRANA, ALBANIA

ALBACOM
MINE PEZA STR 2/8
TIRANA, ALBANIA
tel +355 42 56111 fax +355 42 26245

Invoice No. 01 / extra 10.03.00

INVOICE

Customer

Name TV KLAN
Address ADA TOWER, Rr. Dervish Hima
City TIRANA State ALBANIA
Phone

Date 10/03/00
Order No.
Rep
FOB

Qty	Description	Unit Price	TOTAL
1	**Shitje paisjesh televizive sipas listes bashkengjitur**	$ 62,500	$ 62,500

TOTAL **$ 62,500**

DEPARTAMENTI I FINANCES

ALBA... TIRANË

PAISJE TE BLERA NGA ALBACOM

REGJIA QENDRORE	VLERA
1. Telephone hibrikde Sony fex.	1,000
2. Sistemi kabllor qendror i transmetimit	20,000

REGJIA E STUDIOS Nr. 2	
1. Amplifikator M 1000 cope 2	1,000
2. Kabllo dhe aksesore te ndryshem audio video	3,000

STUDIO LEVIZESE PER TRANSMETIME TELEVIZIVE DIREKTE DHE REGJISTRIME (MOBILVAN)	
1 Amplifikator sinjali Inter M REF 2075	1,500
2 Parabola per linkun dhenes 2 cope	10,000
3 Koka linku 2 cope	2,000
4 Stativa per 4 cope	1,000
5 Kabllo video dhe audio 50 deri ne 150 meter	8,000
6 Per 6 kamera dhe 16 mikrofona njeheresh	15,000

TOTALI	62,500 USD

ALBA... Sh p k
TIRANE ALBANIA

ADAELEKT

RR HOXHA TAHSIN, NR 4
TIRANA, ALBANIA
+355 42 47821 fax +355 42 26245

Fatura No. 09 / extra 21.10.00

FATURE

Klienti

Emri TV KLAN
ADA TOWER, RR.Dervish Hima, TIRANA ALBANIA

Date 21/10/99

Sasia	PERSHKRIMI I MALLRAVE	Çmimi	TOTAL
1	**Shitje paisjesh televizive sipas listes bashkengjitur**	$ 54,000	$ 54,000

TOTAL **$ 54,000**

DEPARTAMENTI I FINANCES

sh.p.k. exp imp
"ADAELEKT"
TIRANE ALBANIA

PAISJE TE BLERA NGA ADAELEKT

STUDIO QENDRORE		VLERA NE USD
1 Prozhektore 1000 W,	cope 10	4,000
2 Prozhektore 600 W,	cope 7	3,000
3 Prozhektore KOVA 1000 W,	cope 10	5,000
4 Stativa prozhektori	cope 4	500
REGJIA QENDRORE		
1 1 valixhe veglash (kaçavida,Havi,indikator,koka kabllosh,etj.).		1,000
REGJIA E STUDIOS Nr. 2		
1 Prozhektore 1000 W	cope 12	4,000
2 Prozhektore 800 W	cope 14	7,000
3 Prozhektore 500 W	cope 4	2,500
4 Prozhektore 250 W kova	cope 12	3,500
5 Pistolete ndriçimi	cope 1	1,500
STUDIO LEVIZESE PER TRANSMETIME TELEVIZIVE DIREKTE DHE REGJISTRIME (MOBILVAN)		
1 Ndriçuesa	cope 10	7,000
GRUP ELEKTROGJEN		15,000
GRAND TOTAL		**54,000 USD**

Sh p k exp imp
"ADAELEKT"
TIRANË ALBANIA

NOTERE GJOLIKU TIRANE

Media 6, Rr Dervish Hima, Nr 1, Tel:+355 4 251923/4/5 Fax:+355 4 251926

Date 27.6.2006

Nr. prot. 285

Autorizim

Autorizohet Av. Erinda Ballanca, te ndjeke te gjitha procedurat per depozitimin prane regjistrit tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te vendimeve te asamblese se aksionereve te shoqerise Media 6 sh.a si dhe te akteve te tjera qe duhet te depozitohen prane ketij regjistri ne kuptim te Ligjit Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", ligjit 7638, date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare", dhe ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare.

Aleksander Frangaj
Drejtor I Pergjithshem

SHOQËRIA ANONIME MEDIA 6 TIRANË ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 2942 Rep.
Nr. 1138 Kol.

KONTRATE PER SHKEMBIMIN E AKSIONEVE DHE KUOTAVE

Sot me date 11.05.2006, perpara meje Noteres, Mimoza Sadushi, me zyre noterie ne Rr. Vaso Pasha, Tirane, lidhet kjo Kontrate per Shitblerje Aksionesh (ketej e tutje referuar "Kontrata"),

ndermjet

- **Z. JULIEN ROCHE**, shtetas francez, lindur me 02.07.1954, ne Bourg-en-Bresse, France, i biri i Marius dhe Marie-Therese, banues ne adresen: Fshati Turistik, Golem, Kavaje, mbajtes i pasaportes nr. 05RE405504
- **Z. MARSEL SKENDAJ**, i biri i Zagollit dhe i Lushes, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene, me 06.11.1999, banues ne Tirane, Rr. Dervish Hima, nr. 1, kati 10 mbajtes i pasaportes nr. 0165026; *dhe*
- **Z. ALEKSANDER FRANGAJ,** i biri i Vasilit i Gjystes, qytetar shqiptar, lindur ne Lezhe, me 4.10.1968, banues ne Tirane me adrese ne Rr. Dervish Hima nr. 1, kati 9, pasaporte nr. 0011369.

KUSHTET PARAPRAKE

- Z. Marsel Skendaj, Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche jane aksioneret qe zoterojne teresisht kapitalin e MEDIA 7 SHA (me poshte e quajtur "Media 7"), qe eshte nje shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 25707, date 30.04.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne adresen Rr. Dervish Hima nr. 1, me kapital themeltar 2,000,000 (dymilion) leke, i ndare ne 2,000 (dymije) aksione nominative me vlere nominale 1,000 (njemije) leke secili, i nenshkruar dhe i shlyer teresisht nga aksioneret ne raportet: (i) aksioneri Marsel Skende, 770 (shtateqind e shtatedhjete) aksione; (ii) aksioneri Julien Roche, 770 (shtateqind e shtatedhjete) aksione; dhe (iii) aksioneri Aleksander Frangaj, 460 (katerqind e gjashtedhjete) aksione.

- Z. Marsel Skendaj, Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche jane ortaket qe zoterojne teresisht kapitalin e MEDIA 5 SHPK (me poshte e quajtur "Media 5"), qe eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr.

23669, date 26.04.2000 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne adresen Blvd Deshmoret e Kombit, 2 kullat binjake, kulla e pare, kati 10, Tirane, me kapital themeltar 100,000 (njeqindmije) leke, i ndare ne 100 (njeqind) pjese, me vlere nominale 1000 (njemije) leke secila, i nenshkruar dhe i shlyer teresisht nga ortaket ne raportet: (i) ortaku Marsel Skened, 41.5 (dyzetenje pike pese) pjese; (ii) ortaku Julien Roche, 41.5 (dyzetenje pike pese) pjese; dhe (iii) ortaku Aleksander Frangaj, 17 (shtatembedhjete) pjese;

lira nga pengu dhe/ose barra siguruese ne favor te te treteve; (iii) Shitesi gezon te gjitha te drejtat dhe ka te gjitha autorizimet e nevojshme qe te realizoje transaksionin e pershkruar ne kete Kontrate, duke permbushur te gjithe detyrimet e marra persiper ne kete Kontrate; (iv) kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem ndaj Shitesit; (v) perveç pretendimit te ngritur nga Z. Aleksander Frangaj me padine e paraqitur ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane kunder te padituríve Marsel Skendaj, Julien Roche dhe shoqeria Media 6 Sh.a., Shitesi nuk eshte ne dijeni te kete ndonje pretendim te te treteve ne lidhje me Aksionet e Shitesit.

4.2 Bleresi deklaron dhe garanton Shitesit se: (i) Bleresi nuk ka asnje pengim ligjor qe te lidhe kete Kontrate dhe eshte i afte te permbushe te gjitha detyrimet qe rrjedhin per Bleresin prej kesaj Kontrate; (ii) Bleresi merr persiper qe pasi te behet pronar i aksioneve objekt i kesaj Kontrate, te mos votoje ne Asamblene e Aksionereve te Shoqerise ne çfaredo lloj menyre qe do te sillte uljen e vleres aktuale te aksioneve objekt i kesaj Kontrate; (iii) kjo Kontrate perben detyrim te ligjshem dhe te ekzekutueshem ndaj Bleresit dhe çdo pasuesi te tij ne perputhje me kushtet e parashikuara ne te; (iv) te gjitha fondet qe Bleresi do te perdore per pagimin e Çmimit te Shitjes dhe çdo shume tjeter te pagueshme kundrejt Shitesit sipas kesaj Kontrate, vijne nga burime te ligjshme; (v) Bleresi eshte njohur me gjendjen financiare dhe statutin e Shoqerise dhe nuk ka asnje pretendim te tashem dhe/ose te ardhshem ndaj Shitesit ne lidhje me Çmimin e Shitjes dhe nese ne te ardhmen do te rezultoje ndonje ndryshim negativ me natyre financiare apo i çfaredo natyre tjeter ne gjendjen e Shoqerise qe e ka origjinen perpara dates apo ne daten e kesaj Kontrate, Bleresi nuk do te kerkoje nga Shitesi kthimin e Çmimit te Shitjes apo te ndonje pjese te tij, ose ndonje pergjegjesi tjeter te çfaredo natyre, por pretendimet e tij eventuale do t'ia kundrejtoje Z. Aleksander Frangaj ne cilesine e aksionerit dhe Drejtorit te Shoqerise.

TE NDRYSHME
NENI 5

5.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kontrate apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate .

5.2 Çdo mosmarrveshje qe mund te linde midis paleve te kesaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Kontrate, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimet e se ciles jane te ankimueshme sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.

5.3 Kjo Kontrate pergatitet dhe nenshkruhet ne kater kopje ne gjuhen shqipe dhe ky akt perben te gjithe marreveshjen e arritur midis paleve, premtimet, deklarimet, garancite ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate. Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet nga secila pale ose perfaqesues te autorizuar rregullisht nga secila pale.

Une Noteri, e lexoj tekstin e ketij akti me ze te larte dhe te kuptueshem paleve, Z. Marsel Skendaj dhe Z. Ervin Gjikola, te cilet pasi me deklaruan se e kuptuan tekstin e ketij akti i cili eshte ne perputhje te plote me theniet dhe vullnetin e tyre, e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time, dhe une Noteri vertetoj sa me siper sipas ligjit ne fuqi.

SHITESI

Z. Marsel Skendaj

BLERESI

Z. Ervin Gjikola.

NOTER

Mimoza Sadushi

VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE AKSIONEREVE TE SHOQERISE ANONIME MEDIA 6 SH.A.

Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise Media 6 sh.a., person juridik i regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendim nr. 16941, date 12.2.1997, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, u mbajt sot me date 11.5.2006 ne seline e shoqerise.

Ne mbledhje ishin te pranishem te gjitha aksioneret qe perfaqesojne 100% si me poshte vijon:

- Aleksander Frangaj zoterues i 1/3 te kapitalit aksioner te shoqerise, i pranishem personalisht;
- Marsel Skendaj zoterues i 1/3 te kapitalit aksioner te shoqerise, i pranishem personalisht;
- Julien Roche zoterues i 1/3 te kapitalit aksioner te shoqerise, i pranishem personalisht.

Gjithashtu ne mbledhjen e Asamblese ishin te ftuar dhe te pranishem Znj. Alba Gina dhe Z. Ervin Gjikola

Ne mbledhje u diskutua rendi i meposhtem i dites:

1. Autorizimi i Drejtorit te shoqerise Z. Aleksander Frangaj qe te nenshkruaje ne emer te Shoqerise: (i) Memorndumin e Mirekuptimit me permbajtjen sipas draftit bashkengjitur ketij vendimi te asamblese, dhe (ii) Kontraten per Blerjen e Kohes Publicitare me Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche.

2. Autorizimi i Drejtorit te shoqerise Z. Aleksander Frangaj qe te nenshkruaje ne emer te Shoqersie kontraten per transferimin e te gjithe aksioneve qe shoqeria zoteron ne kapitalin e shoqerie Satelite Plus Sh.A. tek Z. Aleksander Frangaj, Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche.

3. Miratimi i transferimit te te gjitha aksioneve nga aksioneret Marsel Skendaj dhe Julien Roche tek aksioneri Aleksander Frangaj dhe tek dy aksioneret e rinj Znj. Alba Gina dhe Z. Ervin Gjikola.

4. Emerimi i anetareve te rinj te Keshillit Mbikqyres te shoqerise.

Pasi u shqyrtuan dhe diskutuan te gjitha pikat e rendit te dites si dhe drafti i Memorandumit te Mirekuptimit bashkengjitur ketij vendimi, Asambleja mori me unanimetet ka marre vendimet e meposhtme:

Pika e pare

Autorizohet Drejtori i shoqerise Z. Aleksander Frangaj qe te nenshkruaje ne emer te Shoqerise: (i) Memorandumin e Mirekuptimit me permbajtjen sipas draftit bashkengjitur ketij vendimi te asamblese, dhe (ii) Kontraten per Blerjen e Kohes Publicitare me Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche, per vleren e pergjithshme 1.500.000 (nje milione e peseqind mije) Euro.

Pika e dyte

Miratohet transferimi i te gjitha aksioneve qe shoqeria Media 6 Sh.A. zoteron ne kapitalin ne shoqerine Satelite Plus Sh.A +, tek Z. Aleksander Frangaj ne masen 1/9 e aksioneve te barbarte me 22.2 (njezet e dy pike dy.) aksione, tek Z. Marsel Skendaj ne masen 1/9 e aksioneve te barbarte me 22.2 (njezet e dy pike dy) aksione dhe tek Z. Julien Roche ne masen 1/9 e aksioneve te barbarte me 22.2 (njezet e dy pike dy) aksione, kundrejt çmimit te barabarte me vleren nominale te aksioneve qe transferohen. Si rrjedhoje e ketij transaksioni shoqeria Media 6 nuk do te zoterojme asnje aksion ne kapitalin e shoqerise Satelite Plus Sh.A.

Me qellim realizimin e transferimit te aksioneve si me siper, autorizohet Drejtori i shoqeries Media 6, Z. Aleksander Frangaj qe te nenshkruaje kontratat perkatese te transferimit te pronesise mbi aksionet ne fjale, si dhe çdo dokument tjeter te nevojshem per realizimin e transaksionit.

Pika e trete

Miratohet transferimi i aksioneve qe aksioneri Marsel Skendaj zoteron ne kapitalin e shoqeries Media 6 Sh.A, tek personat e meposhtem ne raportet vijuese:

(i) Z. Aleksander Frangaj, 6.000 (gjashte mije) aksione;
(ii) Znj. Alba Gina, 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksione;
(iii) Z. Ervin Gjikola, 18.000 (tetembedhjete mije) aksione.

Miratohet transferimi i aksioneve qe aksioneri Julien Roche zoteron ne kapitalin e shoqeries Media 6 Sh.A, tek personat e meposhtem ne raportet vijuese:

(iv) Z. Aleksander Frangaj, 6.000 (gjashte mije) aksione;
(v) Znj. Alba Gina, 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksione;
(vi) Z. Ervin Gjikola, 18.000 (tetembedhjete mije) aksione.

Si rrjedhoje e transferimeve te mesiperme perberja e kapitalit te shoqerie do te rezultoje si me poshte:

- Aksioneri Aleksander Frangaj, zoterues i 72.000 (shtetedhjete e dy mije) aksioneve
- Aksioneri i ri Znj. Alba Gina zoterues i 72.000 (shtetedhjete e dy mije) aksioneve

- Aksioneri i ri Z. Ervin Gjikola, aksioner i 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksioneve.

Pika e katert

Meqenese anetaret e Keshillit Mbikqyres te shoqerise, Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche, kane dhene doreheqjen, personat e meposhtem emerohen anetare te keshillit Mbikqyres nje mandat 3 vjeçar:

Znj. Alba Gina, e bija e Agimit dhe Aferdites, lindur me 14.4.1977, ne Lushnje, banuese ne Tirane, Rr. Dervish Hima, nr. 1, pas. nr. Z1019362
Z. Sotiraq Bicka, i biri i Koços, lindur me 31.1.1973, ne Korçe, banues ne Tirane, Rr. Rreshat Petrela, pall. 12 kate prane arkives se shtetit, pas. nr. 0012178;
Z. Pal Toma, i biri i Prendit, lindur me 5.4.1959, ne Kallmet, Lezhe, banues ne Tirane, Rr. Komuna e Parisit, nr. 77, pas. nr. 324543.

Sa me siper jane vendimet e asamblese se aksionereve te shoqerise Media 6 sh.a.

AKSIONERET:

ALEKSANDER FRANGAJ

MARSEL SKENDAJ

JULIEN ROCHE

TE FTUARIT:

ALBA GINA

Z. ERVIN GJIKOLA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 2035 REP
1131

PULLE TAKSE

V E R T E T I M

Sot ne daten 11.05.2006(dymije e gjashte) perpara meje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane me adrese Rr. " Vaso Pasha" P. 13, u paraqiten personalisht:

Z.Marsel Skendaj, i biri I Zagollit, lindur ne Tepelene, me date 06.11.1999, banues ne Tirane, Rr " Dervish Hima" nr 1, me nr pasaporte 0165026.
Z. JULIEN ROCHA, shtetas francez, lindur me 02.07.1954 ne France, banues ne fshatin turistik Golem, Kavaje, madhor me zotesi juridike per te vepruar , me nr pasaporte 05RE405504.
Z.ALEKSANDER FRANGAJ , I biri I Vasilit, lindur ne Lezhe banues ne Tirane Rr " Dervish Hima" nr 1, kati 9, madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr pasaporte 0013708.

Te cilet deklaruan se kane hartuar jashte kesaj zyre vendimin e mesiperm , I cili shpreh vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe pasi e nenshkruan ate perpara meje une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ

MEMORANDUM MIREKUPTIMI

Ne Tirane, sot me date 11 Maj 2006 (dy mije e gjashte), nenshkruhet ky Memorandum Mirekuptimi midis paleve: (i) MEDIA 6 SHA (me poshte e quajtur "Media 6"), shoqeri anonime e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 16941, date 12.2.1997 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, e perfaqesuar nga Z. Aleksander Frangaj ne cilesine e Drejtorit; (ii) MARSEL SKENDAJ, shtetas shqiptar, lindur me 06.11.1949, ne Tepelene, i biri i Zagollit dhe Lushes, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, kati 10, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. 0165026; (iii) Z. ALEKSANDER FRANGAJ, shtetas shqiptar, i biri i Vasilit dhe Gjystes, lindur ne Lezhe me 04.10.1968, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, kati 9, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. 0013708; (iv) JULIEN ROCHE, shtetas francez, lindur me 02.07.1954, ne Bourg-en-Bresse, France, i biri i Marius dhe Marie-Therese, banues ne adresen: Fshati Turistik, Golem, Kavaje, mbajtes i pasaportes nr. 05RE405504; (v) Znj. ALBA GINA, shtetase shqiptare, e bija e Agimit dhe Aferdites. lindur ne Lushnje, me 14.04.1976, banuese ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, mbajtese e pasaportes nr. Z 1019362; dhe (vi) Z. Ervin Gjikola, shtetas shqiptar, i biri i Qemalit, lindur ne Tirane me 4.11.1974, banues ne Tirane ne adresen: Rr. Dibres 275/1, mbajtes i pasaportes nr. 1390254.

HYRJE

(A) Z. Marsel Skendaj, Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche jane aksioneret qe zoterojne teresisht kapitalin e Media 6, e cila eshte nje shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, qe ushtron aktivitetin e saj ne fushen e transmetimeve televizive, aktiviteti eksluziv i te ciles eshte Televizioni Klan, me kapital themeltar 180.000.000 (njeqind e tetedhjete milione) leke, i ndare ne 180.000 (njeqind e tetedhjete mije) aksione nominative me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secili, teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga aksioneret ne raportet: (i) aksioneri Marsel Skendaj, 60.000 (gjashtedhjete mije) aksione; (ii) aksioneri Aleksander Frangaj, 60.000 (gjashtedhjete mije) aksione; dhe (iii) aksioneri Julien Roche, 60.000 (gjashtedhjete mije) aksione.

(B) Media 6 zoteron 66,6 (gjashtedhjete e gjashte presje gjashte) aksione ne kapitalin e SATELIT PLUS SHA (me poshte i quajtur "SAT +"), qe eshte nje shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 32169, date 22.09.2004 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, e cila ushtron aktivitetin e saj ne fushen e transmetimeve televizive, aktivitet ekskluziv i te ciles eshte buqeta satelitore Sat +, me seli ne adresen: Rr. Dervish Hima, nr. 1, me kapital themeltar 2.000.000 (dy milione) leke, i ndare ne 200 (dyqind) aksione nominative me vlere nominale 10.000 (dhjete mije) leke secili, i nenshkruar dhe i shlyer teresisht nga aksioneret ne raportet: (i) aksioneri TVA Sh.A 66,6 (gjashtedhjete e gjashte presje gjashte) aksione; (ii) aksioneri 66,6 (gjashtedhjete e gjashte presje gjashte) aksione; dhe (iii) aksioneri Media 6, [66,6] (gjashtedhjete e gjashte presje gjashte) aksione.

(C) Z. Marsel Skendaj, Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche jane aksioneret qe zoterojne teresisht kapitalin e MEDIA 7 SHA (me poshte e quajtur "Media 7"), qe eshte nje shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne

Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 25707, date 30.04.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne adresen: Rr. Dervish Hima, nr. 1, Tirane, me kapital themeltar 2.000.000 (dymilion) leke, i ndare ne 2.000 (dymije) aksione nominative me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secili, i nenshkruar dhe i shlyer teresisht nga aksioneret ne raportet: (i) aksioneri Marsel Skendaj 770 (shtateqind e shtatedhjete) aksione; (ii) aksioneri Julien Roche, 770 (shtateqind e shtatedhjete) aksione; dhe (iii) aksioneri Aleksander Frangaj, 460 (katerqind e gjashtedhjete) aksione.

(D) Z. Marsel Skendaj, Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche jane ortaket qe zoterojne teresisht kapitalin e MEDIA 5 SHPK (me poshte e quajtur "Media 5"), qe eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 23669, date 26.04.2000 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne adresen: "Kullat Binjake", kulla nr. 1, kati 10, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Tirane, me kapital themeltar 100.000 (njeqindmije) leke, i ndare ne 100 (njeqind) pjese, me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secila, i nenshkruar dhe i shlyer teresisht nga ortaket ne raportet: (i) ortaku Marsel Skenedaj, 41,5 (dyzetenje presje pese) pjese; (ii) ortaku Julien Roche, 41,5 (dyzetenje presje pese) pjese; dhe (iii) ortaku Aleksander Frangaj, 17 (shtatembedhjete).

(E) Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche kane rene dakort te tranaferojne tek Z. Aleksander Frangaj nga 6.000 (gjashtemije) ose gjithesej 12.000 (dymbedhjete mije) aksione nga aksionet qe ata zoterojne ne kapitalin e Media 6, ne kembim te aksioneve qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e Media 7, pjeseve qe zoteron ne kapitalin e Media 5 dhe te aksioneve qe do te zoteroje ne kapitalin e SAT + sipas paragrafit (F) me poshte. Si rrjedhoje e ketij transaksioni Z. Aleksander Frangaj do te behet pronar i 72.000 (shtatedhjete e dy mije) aksioneve ne kapitalin e Media 6, kurse Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche do te mbeten pronare te 54.000 (pesedhjete e kater mije) aksioneve secili.

(F) Media 6 ka rene dakort te dale nga shoqeria SAT + duke u shitur Z. Marsel Skendaj, Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche dhe keta kane rene dakort te blejne nga Media 6, nga 22,2 (njezet e dy presje dy) aksione secili, ose gjithesej 66,6 (gjashtedhjete e gjashte), prej aksioneve qe Media 6 zoteron ne kapitalin e SAT +. Nga ana tjeter Z. Aleksandar Frangaj do te transferoje tek Z. Marsel Skandaj dhe Z. Julien Roche nga 7,8 (shtate presje tete) aksione te kapitalit te SAT + secilit, prej aksioneve qe Z. Aleksander Frangaj do te kete blere nga Media 6. Si rrjedhoje e ketij transaksioni Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche do te behen pronare te 30 (tridhjete) aksioneve secili ne kapitalin e SAT +, kurse Z. Aleksandar Frangaj do te jete pronar i 6,6 (gjashte presje gjashte) aksioneve, ndersa Media 6 nuk do te zoteroje me asnje aksion ne kapitalin e SAT +.

(G) Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche kane rene dakort te dalin nga Media 6 duke u shitur Znj. Alba Gina dhe Z. Ervin Gjikola te gjithe paketen e aksioneve qe ata zoterojne ne kapitalin e Media 6, dhe Znj. Alba Gina e Z. Ervin Gjikola kane rene dakort te blejne paketen e aksioneve ne fjale ne raportet e meposhtme:

(a) Znj. Alba Gina do te bleje nga 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksione nga secili prej shitesve ose ne total 72.000 (shtatedhjete e dy mije) aksione;

(b) Z. Ervin Gjikola do te bleje nga 18.000 (tetembedhjete mije) aksione nga secili prej shitesve ose ne total 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksione.

(H) Z. Aleksander Fragaj ka rene dakort te dale nga shoqeria Media 7, duke transferuar tek Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche respektivisht secilit nga 11,5 (njembedhjete presje pese) aksione qe zoteron ne kapitalin e Media 7, te cilat ne total perbejne te gjitha aksionet qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e Media 7, ne kembim te nje pjese te aksioneve te kapitalit te Media 6 qe Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche do te transferojne tek Z. Aleksander Frangaj (paragrafi E me siper). Nga ana tjeter, Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche jane dakort te pranojne transferimin e aksioneve te siperpermendura.

(I) Z. Aleksander Fragaj ka rene dakort te dale nga shoqeria Media 5, duke transferuar tek Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche respektivisht secilit nga 8,5 (tete presje pese) pjese qe zoteron ne kapitalin e Media 5, te cilat ne total perbejne te gjitha pjeset qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e Media 5, ne kembim te nje pjese te aksioneve te kapitalit te Media 6 qe Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche do te transferojne tek Z. Aleksander Frangaj (paragrafi E me siper). Nga ana tjeter, Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche jane dakort te pranojne transferimin e pjeseve te siperpermendura.

(J) Media 6 ka rene dakort te lidhe me Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche kontrata per furnizimin me hapsire publicitare ne Televizionin Kombetar Klan per transmetimin e spoteve, per nje periudhe 3 vjeçare per produktet e ADA AIR - ADA HOLDING Shpk. dhe per shoqerite e tjera tregtare kapitali i te cilave zoterohen te pkaten 51% nga Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche dhe 4 vjeçare per produktet e Olim Shpk dhe Deka Shpk. per nje vlere te pergjithshme 1.500.000 (njemilion e peseqind mije) Euro.

(K) Ky Memorandum Mirekuptimi (me poshte i quahtur "Memorandumi") percakton kushtet kryesore per realizimin e transaksioneve te pershkurara ne paragrafet e mesiperm.

DUKE IU REFERUAR SA ME SIPER, palet respektive bien dakort per sa vijon:

NENI 1

1.1 Media 6 eshte dakort t'i shese Z. Marsel Skendaj dhe Z. Marsel Skendaj eshte dakort te bleje nga Media 6, 22,2 (njezet e dy presje dy) aksione prej aksioneve qe Media 6 zoteron ne kapitalin e SAT +, kundrejt çmimit te pergjithshem 222.222 (dyqind e njezetedymije e dyqind e njezet e dy) leke.

1.2 Media 6 eshte dakort t'i shese Z. Julien Roche dhe Z. Julien Roche eshte dakort te bleje nga Media 6, 22,2 (njezet e dy presje dy) aksione prej aksioneve qe Media 6 zoteron ne kapitalin e SAT +, kundrejt çmimit te pergjithshem 222.222 (dyqind e njezetedymije e dyqind e njezet e dy) leke.

1.3 Media 6 eshte dakort t'i shese Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Aleksander Frangaj eshte dakort te bleje nga Media 6, 22,2 (njezet e dy presje dy) aksione prej aksioneve qe Media 6 zoteron ne kapitalin e SAT +, kundrejt çmimit te pergjithshem 222.222 (dyqind e njezetedymije e dyqind e njezet e dy) leke.

1.4 Z. Aleksander Frangaj eshte dakort qe, sipas paragrafeve 2.1.(a) dhe 2.2.(a), te transferoje tek Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche nga 7,8 (shtate presje tete) aksione secilit nga aksionet qe do te bleje Z. Aleksander Frangaj ne kapitalin e shoqerise SAT+ sipas paragrafit 1.3 me siper.

NENI 2

2.1 Z. Marsel Skendaj do te transferoje tek Z. Aleksander Frangaj pronesine mbi 6.000 (gjashtemije) aksione nga aksionet qe Z. Marsel Skendaj zoteron ne kapitalin e Media 6, ne kembim te:

(a) pronesise mbi 7,8 (shtate presje tete) aksione te zoteruara nga Z. Aleksander Frangaj ne kapitalin themeltar te SAT +, te cilat Z. Aleksander Frangaj i ka blere nga Media 6 sipas nenit 1.3 te ketij Memorandumi;

(b) pronesise mbi 230 (dyqind e tridhjete) aksione te zoteruara nga Z. Aleksander Frangaj ne kapitalin themeltar te Media 7;

(c) pronesise mbi 8,5 (tete presje pese) pjese te zoteruara nga Z. Aleksander Frangaj ne kapitalin themeltar Media 5.

2.1.1 Palet bien dakort qe ne baze te kontrates se transferimit te aksioneve, pronesia mbi aksionet do te transferohet me nenshkrimin e kontrates se shkembimit te aksioneve dhe depozitimin e saj ne Regjistrin Tregtar.

2.1.2 Me qellim realizimin e transaksioneve te pershkruara me siper ne paragrafin 2.1 te ketij neni, palet respektive do te lidhin kontratat perkatese per transferimin e aksioneve e te pjesevé te kapitalit. Keto kontrata do te percaktojne ne menyre te detajuar kushtet dhe afatet per realizimin e transaksioneve ne fjale, duke mbajtur parasysh kushtet kryesore per te cilat palet respektive kane rene dakort ne kete Memorandum.

2.2 Z. Julien Roche do te transferoje tek Z. Aleksander Frangaj pronesine mbi 6.000 (gjashtemije) aksione nga aksionet qe Z. Julien Roche zoteron ne kapitalin e Media 6, ne kembim te:

(a) pronesise mbi 7,8 (shtate presje tete) aksione te zoteruara nga Z. Aleksander Frangaj ne kapitalin themeltar te SAT +, te cilat Z. Aleksander Frangaj i ka blere nga Media 6 sipas nenit 1.3 te ketij Memorandumi;

(b) pronesise mbi 230 (dyqind e tridhjete) aksione te zoteruara nga Z. Aleksander Frangaj ne kapitalin themeltar te Media 7;

(c) pronesise mbi 8,5 (tete presje pese) pjese te zoteruara nga Z. Aleksander Frangaj ne kapitalin themeltar Media 5.

2.2.1 Palet bien dakort qe ne baze te kontrates se transferimit te aksioneve, pronesia mbi aksionet do te transferohet me nenshkrimin e kontrates se shkembimit te aksioneve dhe depozitimin e saj ne Regjistrin Tregtar.

2.2.2 Me qellim realizimin e transaksioneve te pershkruara me siper ne paragrafin 2.2 te ketij neni, palet respektive do te lidhin kontratat perkatese per transferimin e aksioneve e te pjeseve te kapitalit. Keto kontrata do te percaktojne ne menyre te

detajuar kushtet dhe afatet per realizimin e transaksioneve ne fjale, duke mbajtur parasysh kushtet kryesore per te cilat palet respektive kane rene dakort ne kete Memorandum.

NENI 3

3.1 Z. Aleksander Frangaj eshte dakort qe, sipas paragrafeve 2.1(b) dhe 2.2(b), te transferoje tek Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche pronesine mbi 230 (dyqind e tridhjete) aksione secilit nga aksionet qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e shoqerise Media 7, te cilat perbejne te gjitha aksionet qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e Media 7.

3.2 Z. Aleksander Frangaj eshte dakort qe, sipas paragrafeve 2.1(c) dhe 2.2(c), te transferoje tek Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche pronesine mbi 8,5 (tete presje pese) pjese secilit nga pjeset qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e shoqerise Media 5, te cilat perbejne te gjitha pjeset qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e Media 5.

NENI 4

Si rrjedhoje e realizimit te transaksioneve te pershkruara ne nenet 1, 2 dhe 3 te ketij Memorandumi, do te rezultoje situata e meposhte:

(a) Z. Aleksander Frangaj do te behet pronar i 72.000 (shtatedhjete e dy mije) aksioneve ne kapitalin e Media 6, kurse Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche mbeten pronare te 54,000 (pesedhjete e kater mije) aksioneve secili ne kapitalin e shoqerie Media 6;

(b) Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche do te behen pronare te 30 (tridhjete) aksioneve secili ne kapitalin e SAT +, kurse Z. Aleksander Frangaj behet pronar i 6.6 (gjashte presje gjashte) aksioneve ne kapitalin e SAT +, ndersa Media 6 do te dale nga shoqeria SAT +, duke mos zoteruar me asnje aksion ne kapitalin e SAT +;

(c) Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche do te behen pronare te 1.000 (njemije) aksioneve secili ne kapitalin e Media 7, kurse Z. Aleksander Frangaj largohet nga kjo shoqeri duke mos zoteruar me asnje aksion ne kapitalin e saj;

(d) Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche do te behen pronare te 50 (pesedhjete) pjeseve secili ne kapitalin e Media 5, kurse Z. Aleksander Frangaj largohet nga kjo shoqeri duke mos zoteruar me asnje pjese ne kapitalin e saj.

NENI 5

5.1 Z. Marsel Skendaj eshte dakort t'i shese Znj. Alba Gina dhe Znj. Alba Gina eshte dakort te bleje nga Z. Marsel Skendaj, 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksione prej aksioneve qe Z. Marsel Skendaj zoteron ne kapitalin e Media 6, kundrejt çmimit te pergjithshem 1.200.000 (nje milion e dyqind mije) Euro.

5.1.1 Znj. Alba Gina do t'i paguaje Z. Marsel Skendaj çmimin e percaktuar ne paragrafin 5.1 te ketij neni 5, me keste per afatin 23 (njezet e tre) muaj qe fillon

nga data e nenshkrimit kontrates perkatese per shitjen e aksioneve qe do te lidhet midis Z. Marsel Skendaj dhe Znj. Alba Gina, si me poshte vijon:

(a) 22 (njezete e dy) keste mujore ne shumen 20.000 (njezet mije) Euro;

(b) 1 (nje) kest mujor ne shumen 10.000 (dhjete mije) Euro;

(c) kestin ne shumen 750.000 (shtetqind e pesedhjete mije) Euro, Znj. Alba Gina do t'ia paguaje Media 6 ne emer te Z. Marsel Skendaj ne perputhje me kushtet dhe afatet qe do te percaktohen ne kontraten per furnizimin me hapsire publicitare ne Televizionin Kombetar Klan per transmetimin e spoteve qe do te lidhet mids Z. Marsel Skendaj dhe Media 6 sipas nenit 9.1 te ketij Memorandumi..

5.1.2 Me qellim qe te siguroje shlyerjen e plote dhe brenda afatit te çmimit te shitjes te percaktuar ne paragrafin 5.1 me siper, Znj. Alba Gina do te rendoje me barre siguruese, ne favor te Z. Marsel Skendaj, aksionet e kapitalit te shoqerise Media 6 qe do te bleje nga Z. Marsel Skendaj sipas paragrafit 5.1 te ketij neni 5.

5.1.3 Me qellim sigurimin e shlyerjes se plote dhe brenda afatit te çmimit te shitjes te percaktuar ne paragrafin 5.1 me siper nga Znj. Alba Gina, palet bien dakort qe Z. Aleksander Frangaj te rendoje me barre siguruese ne favor te Z. Marsel Skendaj, 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksione qe zoteron ne kapitalin e shoqerise Media 6 dhe 3,33 (tre presje tridhjete e tre) aksionet qe do te zoteroje ne kapitalin e SAT + (neni 1.3 me siper), si dhe mbi dividentet dhe te drejtat qe do perfitoje Z. Aleksander Frangaj nga zoterimi i 3,33 (tre presje tridhjete e tre) aksioneve ne fjale në kapitalin e SAT +. Gjithashtu, perveç dhenies se barreve siguruese te siperpërmendura, Z. Aleksander Frangaj do te behet dorezanes i Znj. Alba Gina kundrejt Z. Marsel Skendaj per pagimin e plote dhe brenda afatit te te gjithe çmimit te shitjes se percaktuar ne paragrafin 5.1 te ketij neni.

5.1.4 Palet bien dakort qe pronesia mbi aksionet do te transferohet ne momentin e nenshkrimit te kontrates se transferimit te aksioneve, nenshkrimit te marreveshjes per rendimin me barre siguruese te aksioneve te Znj. Alba Gina dhe Z. Aleksander Frangaj, si dhe nenshkrimit te kontrates se dorezanise nga Z. Aleksander Frangaj. Me qellim realizimin e transaksioneve te pershkruara me siper ne nenparagrafet 5.1.1, 5.1.2 dhe 5.1.3. te ketij neni, palet respektive do te lidhin kontraten perkatese per shitjen dhe transferimin e aksioneve, si dhe marreveshjet per rendimin me barre siguruese te aksioneve dhe nenshkrimin e kontrates se dorezanine. Keto kontrata do te percaktojne ne menyre te detajuar kushtet dhe afatet per realizimin e transaksioneve ne fjale, duke mbajtur parasysh kushtet kryesore per te cilat palet respektive kane rene dakort ne kete Memorandum.

5.2 Z. Julien Roche eshte dakort t'i shese Znj. Alba Gina dhe Znj. Alba Gina eshte dakort te bleje nga Z. Julien Roche, 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksione prej aksioneve qe Z. Julien Roche zoteron ne kapitalin e Media 6, kundrejt çmimit te pergjithshem 1.200.000 (nje milion e dyqind mije) Euro.

5.2.1 Znj. Alba Gina do t'i paguaje Z. Julien Roche çmimin e percaktuar ne paragrafin 5.2 te ketij neni 5, me keste per afatin 23 (njezet e tre) muaj qe fillon nga data e nenshkrimit kontrates perkatese per shitjen e aksioneve qe do te lidhet midis Z. Julien Roche dhe Znj. Alba Gina, si me poshte vijon:

(a) 22 (njezete e dy) keste mujore ne shumen 20.000 (njezet mije) Euro;

(b) 1 (nje) kest mujor ne shumen 10.000 (dhjete mije) Euro;

(c) kestin ne shumen 750.000 (shtetqind e pesedhjete mije) Euro, Znj. Alba Gina do t'ia paguaje Media 6 ne emer te Z. Julien Roche ne perputhje me kushtet dhe afatet qe do te percaktohen ne kontraten per furnizimin me hapsire publicitare ne Televizionin Kombetar Klan per transmetimin e spoteve qe do te lidhet mids Z. Julien Roche dhe Media 6 sipas nenit 9.1 te ketij Memorandumi.

5.2.2 Me qellim qe te siguroje shlyerjen e plote dhe brenda afatit te çmimit te shitjes te percaktuar ne paragrafin 5.2 me siper, Znj. Alba Gina do te rendoje me barre siguruese ne favor te Z. Julien Roche aksionet e kapitalit te shoqerise Media 6 qe do te bleje nga Z. Julien Roche sipas paragrafit 5.2 te ketij neni 5.

5.2.3 Me qellim sigurimin e shlyerjes se plote dhe brenda afatit te çmimit te shitjes te percaktuar ne paragrafin 5.1 me siper nga Znj. Alba Gina, palet bien dakort qe Z. Aleksander Frangaj te rendoje me barre siguruese ne favor te Z. Julien Roche, 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksione qe zoteron ne kapitalin e shoqerise Media 6 dhe 3,33 (tre presje tridhjete e tre) aksionet qe do te zoteroje ne kapitalin e SAT + (neni 1.3 me siper), si dhe mbi dividentet dhe te drejtat qe do perfitoje Z. Aleksander Frangaj nga zoterimi i 3,33 (tre presje tridhjete e tre) aksioneve ne fjale ne kapitalin e SAT +. Gjithashtu, perveç dhenies se barreve siguruese te siperperemndura, Z. Aleksander Frangaj do te behet dorezanes i Znj. Alba Gina kundrejt Z. Julien Roche per pagimin e plote dhe brenda afatit te te gjithe çmimit te shitjes se percaktuar ne paragrafin 5.2 te ketij neni.

5.2.4 Palet bien dakort se ne baze te kontrates te transferimit te aksioneve, pronesia mbi aksionet do te transferohet ne momentin e nenshkrimit te kontrates se transferimit te aksioneve, nenshkrimit te marreveshjes siguruese mbi aksionet nga Znj. Alba Gina dhe Z. Aleksander Frangaj, si dhe nenshkrimit te kontrates se dorezanise nga Z. Aleksander Frangaj. Me qellim realizimin e transaksioneve te pershkruara me siper ne nenparagrafet 5.2.1, 5.2.2 dhe 5.2.3. te ketij neni, palet respektive do te lidhin kontratat perkatese per shitjen dhe transferimin e aksioneve, marreveshjet per rendimin me barre siguruese te aksioneve dhe nenshkrimin e kontrates se dorezanine. Keto kontrata do te percaktojne ne menyre te detajuar kushtet dhe afatet per realizimin e transaksioneve ne fjale, duke mbajtur parasysh kushtet kryesore per te cilat palet respektive kane rene dakort ne kete Memorandum.

NENI 6

6.1 Z. Marsel Skendaj eshte dakort t'i shese Z. Ervin Gjikola dhe Z. Ervin Gjikola eshte dakort te bleje nga Z. Marsel Skendaj, 18.000 (tetembedhjete mije) aksione prej aksioneve

qe Z. Marsel Skendaj zoteron ne kapitalin e Media 6, kundrejt çmimit te pergjithshem 300.000 (treqind mije) Euro. Z. Ervin Gjikola do t'i paguaje Z. Marsel Skendaj çmimin ne fjale ne momentin e nenshkrimit te kontrates se transferimit te aksioneve qe palet do te lidhin per kete qellim. Pronesia mbi aksionet do te transferohet nga Z. Marsel Skendaj tek Z. Ervin Gjikola ne momentin e pageses efektive te çmimit te shitjes. Me qellim realizimin e transaksionit te pershkruar me siper, palet respektive do te lidhin kontraten perkatese per transferimin e aksioneve. Kjo kontrate do te percaktoje ne menyre te detajuar kushtet dhe afatet per realizimin e transaksionit, duke mbajtur parasysh kushtet kryesore per te cilat palet respektive kane rene dakort ne kete Memorandum.

6.2 Z. Julien Roche eshte dakort t'i shese Z. Ervin Gjikola dhe Z. Ervin Gjikola eshte dakort te bleje nga Z. Julien Roche, 18.000 (tetembedhjete mije) aksione prej aksioneve qe Z. Julien Roche zoteron ne kapitalin e Media 6, kundrejt çmimit te pergjithshem 300.000 (treqind mije) Euro. Z. Ervin Gjikola do t'i paguaje Z. Julien Roche çmimin ne fjale ne momentin e nenshkrimit te kontrates se transferimit te aksioneve qe palet do te lidhin per kete qellim. Pronesia mbi aksionet do te transferohet nga Z. Julien Roche tek Z. Ervin Gjikola ne momentin e pageses efektive te çmimit te shitjes. Me qellim realizimin e transaksionit te pershkruar me siper, palet respektive do te lidhin kontraten perkatese per transferimin e aksioneve. Kjo kontrate do te percaktoje ne menyre te detajuar kushtet dhe afatet per realizimin e transaksionit, duke mbajtur parasysh kushtet kryesore per te cilat palet respektive kane rene dakort ne kete Memorandum.

NENI 7

Si rrjedhoje e realizimit te transaksioneve te pershkruara ne nenet 5 dhe 6 te ketij Memorandumi, do te rezultoje situata e meposhte:

(a) Znj. Alba Gina do te behet pronare e 72.000 (shtatedhjete e dy mije) aksioneve ne kapitalin e Media 6;
(b) Z. Ervin Gjikola do te behet pronar i 36.000 (tridhjete e gjashte mije) aksioneve ne kapitalin e Media 6;
(c) Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche dalin nga shoqeria Media 6 duke mos zoteruar me asnje aksion ne kapitalin e saj.

NENI 8

8.1 Te gjitha palet bien dakort qe te ruajne te pandryshuar perqindjen qe perfaqesojne ne kapitalin e shoqerive Media 6, Sat +, Media 7 dhe Media 5 ne daten e nenshkrimit te ketij Memorandumi, aksionet dhe/ose pjeset qe jane objekt i transaksioneve te pershkruara ne kete Memorandum. Nese per çfaredo lloj arsye pas dates se ketij Memorandumi, numrit te aksioneve dhe/ose pjeseve objekt i ketij Memorandumi i korrespondon nje perqindje me te ulet apo me te larte e kapitalit te ndonjeres apo te gjitha shoqerive te siperperemndura, transaksioni do te realizohet per nje numer pjesesh dhe/ose aksionesh, me te ulet apo me te larte, sipas rastit, me qellim qe te ruhet e pandryshuar perqindja ne kapital e cila ka qene synimi i paleve nepermjet realizimit te transaksioneve sipas ketij Memorandumi. Detyrimi i parashikuar ne kete paragraf nuk eshte i vlefshem per aksionet qe Z. Ervin Gjikola blen nga Z. Marel Skendaj dhe Z. Julien Roche sipas nenit 6 te ketij Memorandumi.

8.2 Z. Ervin Gjikola dhe Znj. Alba Gina deklarojne se jane njohur me me gjendjen financiare dhe statutin e Shoqerise dhe nuk kane asnje pretendim te tashem dhe/ose te ardhshem ndaj Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche ne lidhje me çmimin e shitjes se aksioneve respektive sipas neneve 5 dhe 6 te ketij Memorandumi. Z. Ervin Gjikola, Znj. Alba Gina, Z. Aleksander Frangaj, Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche bien dakort me njeri-tjetrin qe, nese ne te ardhmen rezulton ndonje ndryshim negativ me natyre financiare apo i çfaredo natyre tjeter ne gjendjen e Shoqerise qe e ka origjinen perpara dates apo ne daten e kesaj ketij Memorandumi, Z. Ervin Gjikola dhe/ose Znj. Alba Gina nuk do te kerkoje nga Z. Marsel Skendaj dhe/ose Z. Julien Roche kthimin e çmimit te shitjes te treguar ne nenet 5 dhe 6 te ketij Memorandumi, apo te ndonje pjese te çmimit te shitjes, ose ndonje pergjegjesi tjeter te çfaredo natyre, por pretendimet e tyre eventuale do t'ia kundrejtoje Z. Aleksander Frangaj ne cilesine e aksionerit dhe Drejtorit te shoqerie Media 6.

NENI 9

9.1 Media 6 ka rene dakort te lidhe me Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche kontrata per furnizimin me hapsire publicitare ne Televizionin Kombetar Klan per transmetimin e spoteve, per nje periudhe 3 vjeçare per produktet e ADA AIR - ADA HOLDING Shpk. dhe per shoqerite e tjera tregtare kapitali i te cilave zoterohen te pkaten 51% nga Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche dhe 4 vjeçare per produktet e Olim Shpk dhe Deka Shpk. per nje vlere te pergjithshme 1.500.000 (njemilion e peseqind mije) Euro. Me qellim percaktimi e detajeve, Media 6 dhe Z. Marsel Skendaj e Z. Julien Roche do te lidhin kontraten perkatese.

9.2 Media 6 ka rene dakort dhe merr persiper detyrimin qe vazhdoje te lejoje ADA AIR-ADA HOLDING SHPK., (ADA HOLDING) e cila eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, me seli ne adresen: Rr. Dervish Hima, nr. 1, Ada Tower, Tirane, kapitali i te ciles eshte teresisht i zoteruar nga Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche, qe te shfrytezoje pa pagese sinjalin e TV Klan dhe prodhimet e tij ne platformen MIA ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, derisa te realizoje fitim nga aktiviteti i kesaj platforme. Kjo e drejte i jepet ADA HOLDING me qellim qe te njihet tek publiku e te ngrihet audienca e programeve te televizionit kombetar Klan jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Shpenzimet nese, ka do te perballohen krejtesisht nga ADA HOLDING. Me qellimin verifikimin e te dhenave financiare ne lidhje me aktivitetin e MIA, ADA HOLDING do t'i paraqese periodikisht, nje here ne 4 (kater) muaj Media 6 te dhena mbi situaten financiare te ketij aktiviteti. Me verifikimin e realizimit te fitimit ne masen e percaktuar ne kete paragraf, Media 6 dhe ADA HOLDING do te negociojne lidhjen e nje kontrate per te percaktuar shperblimin qe ADA HOLDING duhet t'i paguaje Media 6 per shfrytezimin e metejshem te sinjalit dhe prodhmimeve te TV Klan. Media 6 merr persiper te mos nderprese sinjalin qe shfrytezohet nga ADA HOLDING per platformen MIA deri ne momentin qe do te lidhet kontrata e siperperemndur me verifikimin e kushtit te realizimit te fitimit, te percaktuar me siper. Gjithsesi palet duhet te arrjne ne nje marreveshje brenda nje afati 3 mujor nga momenti i realizimit te kushtit te siperpermendur, ne te kundert Media 6 nuk do te lejoje me shfrytezimin e programeve te saj per MIA. Media 6 nuk eshte pergjegjese per te drejtat e transmetimit apo ritransmetmit te programeve te cilat nuk jane te prodhuara nga Media 6, por te blera prej saj vetem per

territorin e Republikes se Shiperise. Kjo e drejte nuk do te mund te tjetersohet apo te transferohet tek te tretet pa miratimin paraprak me shkrim te Media 6. Pavaresisht nga sa me siper e drejta e ADA HOLDING per te shfytezuar pa pagese prodhimet e Media 6 do te perfundoje nese te drejat per platformen MIA do t'i kalojne ndonje personi te trete, apo do te ndryshoje struktura e ortakerise se ADA HOLDING.

NENI 10

10.1 Ky Memorandum Mirekuptimi do te zbatohet dhe interpretohet sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise. Çdo mosmarreveshje qe mund te lindë mes paleve ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij Memorandumi, qe nuk zgjidhet me pajtim nga palet, do te dergohet per zgjidhje para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimi i te ciles eshte i ankimueshem sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.

10.2 Dispozitat e ketij Memorandumi do jane konfidenciale dhe nuk do t'i behen te ditura asnje personi pa miratimin paraprak me shkrim te paleve te tjera. Asnjera nga palet e ketij Memorandumi, perveç rasteve kur legjislacioni i Republikes se Shqiperise e kerkon, nuk do te beje publike kete Memorandum pa miratimin paraprak me shkrim te paleve te tjera. Detyrimi per te mbajtur konfidencial kete Memorandum do te mbetet ne fuqi gjate gjithe kohezgjatjes se ketij Memorandumi, me realizimin e te gjitha transaksioneve te pershkruara ne te.

10.3 Dispozitat e ketij Memorandumi qe lidhen me nje apo me shume transaksione te veçanta mund te ndryshohen vetem me pelqimin me shkrim te paleve respektive qe jane perfshire ne transaksionin ne fjale, dispozita ose dispozitat e te cilit jane objekt ndryshimi. Ky Memorandum perben te gjithe marreveshjen e paleve. Nese ndonje nga instrumentat e nevojshem per realizimin e transaksioneve te pershkruara ne kete Memorandum nuk do te konsiderohet i pershtatshem apo shpallet i pavlefshem, palet marrin persiper te ndermarrin te gjitha hapat e nevojshme dhe te neneshkruajne dokumetnat e nevojshem per te realizuar transaksionin objekt i instrumentit te shpallur i pavlefshem, sipas kushteve te percaktuara ne kete Memorandum. Ne rast se ndonjera prej paleve, drejteperdrejte apo ne menyre te terthorte, do te pengoje nenshkrimin e dokumetnave te nevojshem per realizimin e transaksioneve te pershkruara ne kete Memorandum apo ne zevendesimin e atyre instrumenteve qe do te konsiderohen te nevojshem, do te t'i paguaje pales apo paleve te cenuara denshperblim qe do te caktohet sipas dispozitave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise. Nese demi qe kane pesuar palet e cenuara eshte me i madh se shuma e kushtit penal, ato kane te drejte te demshperblehen edhe pe diferencen.

10.4 Z. Aleskamder Frangaj deklaron se me nenshkrimin e ketij Memorandumi heq dore nga e drejta e padise se ngritur prej tij perpara Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane kunder Z. Marsel Skendaj, Z. Julien Roche dhe Media 6.

Ky Memorandum hartohet ne gjuhen shqipe ne 7 (shtate) ekzemplare me vlere te njejte secila dhe nenshkruhet rregullisht nga palet.

MEDIA 6 SHA
Perfaqesuar nga:

Z. Aleksander Frangaj
Drejtor

SHOQËRIA ANONIME MEDIA 6 TIRANË ALBANIA

Znj. Alba Gina

Z. Ervin Gjikola

Z. Aleksander Frangaj

Z. Marsel Skendaj

Z. Julien Roche

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 2540 REP
1136

VERTETIM

Sot ne daten 11.05.2006(dymije e gjashte) perpara meje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane me adrese Rr. " Vaso Pasha" P. 13, u paraqiten personalisht:

Z.Marsel Skendaj, i biri I Zagollit, lindur ne Tepelene, me date 06.11.1999, banues ne Tirane, Rr " Dervish Hima" nr 1, me nr pasaporte 0165026.
Z. JULIEN ROCHE, shtetas francez, lindur me 02.07.1954 ne France, banues ne fshatin turistik Golem, Kavaje, madhor me zotesi juridike per te vepruar , me nr pasaporte 05RE405504.
Z.ALEKSANDER FRANGAJ , I biri I Vasilit, lindur ne Lezhe banues ne Tirane Rr " Dervish Hima" nr 1, kati 9, madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr pasaporte 0013708.
Znj ALBA GINA, e bija e Agimit, lindur me 14.04.1976 ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi juridike per te vepruar , me pasaporte Z 1019362,
Z ERVIN GJIKOLA, I biri I Qemalit, lindur me 4.11.1974 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar , me pasaporte 13900254
Te cilet deklaruan se kane hartuar jashte kesaj zyre memorandumin e mirekuptimit, I cili shpreh vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe pasi e nenshkruan ate perpara meje une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ

VENDIM I KESHILLIT MBIKQYRES TE SHOQERISE MEDIA 6 SH.A.

Sot me date 12.5.2006, ne seline e shoqerise Media 6 sh.a, person jurdik shqiptar, regjistruar ne regjistrin e shoqerive tregtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me vendim nr. 16941, date 12.2.1997, u mblodh keshilli mbikqyres i shoqerise Media 6 sh.a. me pjesmarrjen e anetareve te tij te rinj te zgjedhur ne mbledhjen e asamblese se dates 11.5.2006:

- Alba Gines, banuese në Tiranë, rr. Dervish Hima, nr. 1, pas. nr. Z1019362;
- Sotiraq Bickes, , banues në Tiranë, rr. Rreshat Petrela, pall. 12 kate pranë arkivës së shtetit, pas. nr. 0012178;
- Pal Tomes, banues në Tiranë, Rr. Komuna e Parisit, nr. 77, pas. nr 324543.

Keshilli, me voten pro te anetareve Pal Toma dhe Sotiraq Bicka vendosi zgjedhjen e Alba Gines, ne detyren e kryetares se keshillit mbikqyres te shoqerise Media 6 sh.a. Alba Gina duke qene se votimi kishte lidhje te drejtperdrejte me emerimin e saj ne kete detyre nuk mori pjese ne votim, por pranoi detyren.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres

Alba Gina _____

Pal Toma _____

Sotiraq Bicka _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr. 4850 **Rep.**
1862

VËRTETIM

Sot, më datë 13/02/2006, në Zyrën e Noterisë, Tiranë, para meje Noteres Mimoza Sadushaj u paraqitën personalisht:

Alba Gina, banuese ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, mbajtese e pasaportes nr. Z 1019362 në cilësinë e aksioenrit te shoqerise Media 6 sh.a.;

Pal Toma, banues në Tiranë, Rr. Komuna e Parisit, nr. 77, pas. nr 324543; dhe

Sotiraq Bicka, , banues në Tiranë, rr. Rreshat Petrela, pall. 12 kate pranë arkivës së shtetit, pas. nr. 0012178

Ne cilesine e anetareve te keshillit mbikqyres te shoqerise Media 6 sh.a. te zgjedhur ne mbledhjen e dates 11.5.2006, për identitetin e të cilëve u binda pasi verifikova pasaportat e tyre të cilët më deklaruan se vendimi i mesiperm eshte vendimi i mbledhjes se keshillit mbikqyres te shoqerise, vendim te cilin e kane nenshkruar jashte zyres se noteres, me vullnetin e tyre te lire asamblese se aksionerev te shoqerise Media 6 sh.a.i marre me vullnetin e tyre të lirë, vendim të cilën e nënshkruan përpara meje, dhe unë e vërtetoj atë sipas kërkesave të ligjit.

NOTERE

NOTERE
Mimoza Sadushaj
TIRANE